REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY

| Pranuar | 08/03 | | 2022 |
| --- | --- | --- | --- |
| Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera |
| 01- | 052/01- | 10735 | |


REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS



# RAPORTI I PUNËS
# JANAR-DHJETOR 2021
# I
# KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

DRENAS
2022

## PËRMBAJTJA


1. ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS .......... 3

1.1. ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN .......... 3

1.2. ZYRA E AUDITORIT TË BRENDSHËM .......... 3

1.3. ZYRA E PERSONELIT .......... 4

2.1. ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE (ZKIE) .......... 6

2.2. ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM .......... 7

2.3. ZYRA PËR BARAZI GJINORE .......... 8

3. RAPORTET SIPAS DREJTORIVE .......... 16

3.1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME .......... 16

3.2. DREJTORIA E ARSIMIT .......... 20

3.3. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT .......... 32

3.4. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL (DBPZHR) .......... 39

3.5. DREJTORIA E INSPEKCIONIT .......... 43

3.6. DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA .......... 49

3.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE .......... 51

3.8. DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT .......... 75

3.9. DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË .......... 93

3.10. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË .......... 106

3.11. INFRASTRUKTURA PUBLIKE .......... 118

3.12. DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK .......... 123

# 1. ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

Në periudhën raportuese janar-dhjetor 2021 të kryetarit, janë regjistrua përmes intranetit të brendshëm (arkivit aktiv) 2376 lëndë të ndryshme dhe të gjitha janë procesuar me kohë, 344 prej tyre janë dorëzuar në arkivin e Komunës, ndërsa janë kthyer përgjigje të gjithë atyre që kanë adresuar kërkesat përmes intranetit. Janë nxjerr 293 vendime të ndryshme, ku ato që kanë pasur karakterin e përgjithshëm, janë publikuar edhe në ueb faqen e Komunës. Zyra e kryetarit ka organizuar dy (2) takime me publikun, sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, për të diskutuar aktivitetet e gjashtëmujorit të parë të vitit raportues dhe gjashtëmujorit të dytë të vitit raportues. Po ashtu janë mbajtur dymbëdhjetë (12) dëgjime buxhetore, gjashtë (6) për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2022-2024 për kërkesat fillestare me qytetarët e Komunës së Drenasi dhe gjashtë (6) të tjera për investime kapitale. Po ashtu janë mbajtur edhe 6 mbledhje të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), janë mbajtur edhe 47 mbledhje të Bordit të Drejtorëve, ku janë diskutuar pika të ndryshme dhe për të gjitha është mbajtur proces mbi diskutimet dhe konkluzionet e nxjerra nga mbledhjet, ku secili drejtor ne baza javore ka raportuar për aktivitetet, punët dhe angazhimet si dhe janë diskutuar tema të ndryshme. Të gjitha njoftimet, komunikatat, ftesat dhe dokumentet janë të publikuara në ueb faqen zyrtare të Komunës dhe në rrjetin social Facebook.

## 1.1. ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN

Zyra për Komunikim me Publikun, gjatë periudhës janar-dhjetor 2021, ka përcjellë aktivitetet ditore, javore dhe mujore të Komunës. Përmes linkut http://kk.rks-gov.net/gllogoc/, ueb faqes zyrtare të Komunës, ZKP ka publikuar të gjitha aktivitetet e mbajtura dhe ka publikuar të gjitha vendimet, rregulloret, raportet, projektet, njoftimet, konkurset, njoftimet e zyrës së prokurimit si; kontratat e nënshkruara, njoftimet për anulim, njoftimet për dhënien e kontratave, njoftimet për kontratë, njoftimet për nënshkrimin e kontratave dhe shkresa të tjera në interes të gjithë qytetarëve të Komunës. Ka mbajtur kontakte të rregullta me media, ku i ka përcjellë njoftime e lajme ditore për aktivitetet e zhvilluara në Komunë, ftesa, reagime etj., ku gjithsejtë ka lëshuar mbi 500 komunikata të karakterit të ndryshëm informues në ueb faqen zyrtare dhe në rrjetin social Facebook. Ka përcjell agjendën e Kryetarit dhe ka caktuar takime në bashkëpunim me Kryetarin me delegacione të ndryshme nga niveli qendror dhe ai lokal, si dhe më delegacione të ndryshme ndërkombëtare. Në kuadër të kësaj zyre, janë pranuar dhe shqyrtuar edhe kërkesat për qasje në dokumente publike dhe gjatë periudhës raportuese, janë pranuar 25 kërkesa për qasje dhe të gjitha kanë qenë të qasshme sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. Ju ka përgjigjur të gjitha OJQ-ve për plotësimin e formularëve të pyetjeve të dërguara dhe kontakti i përhershëm me Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal si dhe me nivele të tjera qeveritare. Po ashtu ka mbajtur kontakte të rregullta me media dhe i ka kthyer përgjigje të gjitha atyre që janë interesuar për çështjet e Komunës së Drenasit dhe ka dhënë intervista të ndryshme për televizione e portale. Zyra për Komunikim me Publikun kryen edhe punë të tjera sipas përshkrimit të detyrave të secilit punonjës.

## 1.2. ZYRA E AUDITORIT TË BRENDSHËM

Njësia e Auditimit të Brendshëm të Komunës së Drenasit, në Dhjetor të vitit 2020 ka aprovuar Planin e Punës për angazhimin e kapaciteteve audituese gjatë vitit 2021. Ky Plan i punës ishte i mbështetur në Planin Strategjik të kësaj Njësie për vitet 2021-2023. Njësia e Auditimit të Brendshëm është e përbërë prej dy auditorëve; Drejtorin e Njësisë dhe një Auditor. Me Planin e Punës së Njësisë për

vitin 2021 ishin të parapara të kryheshin shtatë auditime të brendshme. Auditimet ishin të planifikuara të kryheshin në fushat si:

- Menaxhimi me kontratat e prokurimit;
- Menaxhimi me pasuritë e Komunës;
- Të hyrat nga Taksat në biznes;
- Menaxhimi me personel në sektorin e arsimit;
- Të hyrat nga participimi në Çerdhe;
- Shpenzimet/pagesat gjatë vitit 2021;dhe
- Proceset e prokurimeve gjatë vitit 2021.

  Të gjitha auditimet e parapara me Plan të punës janë realizuar në tërësi e madje gjatë vitit 2021 është kryer edhe një auditim me kërkesë të veçantë. Pas kryerjes së auditimit, të gjitha raportet janë finalizuar dhe janë aprovuar në mbledhjet e Komitetit të Auditimit.

Auditimet e kryera kanë pasur për qëllim qe të arrihen objektivat kryesore si:

- Arritja e një pajtueshmërie të plotë me kornizën ligjore
- Ruajtja dhe menaxhimi i mirë me pasuritë e komunës;
- Shfrytëzimi më ekonomik i pasurisë komunale dhe rritja e vlerës së kësaj pasurie;
- Shfrytëzimi më ekonomik i resurseve humane në dispozicion të komunës;
- Shtimi i sigurisë dhe integritetit të të dhënave të pasqyruara;
- Rritja e vlerës së burimeve humane dhe material; dhe
- Krijimi i një qeverisje të mirë të bazuar në rrezik

Komiteti i Auditimit të Brendshëm ka qenë mjaft aktiv gjatë këtij viti. Ky Komitet ka përfunduar Raportin vjetor të punës dhe e ka dorëzuar tek Zyrtari Kryesor Administrativ. Në fund të vitit 2021 Njësia e Auditimit të Brendshëm ja hartuar Planin vjetor të auditimit për vitin 2022 si dhe Planin Strategjik për zhvillimin e auditimeve për periudhën 2022-2024 të cilat Plane janë miratuar në Komitetin e Auditimit të Brendshëm. Njësia e Auditimit të Brendshëm ka ndërmarr një qasje gjithëpërfshirëse dhe profesionale për ofrimin e rekomandimeve të dobishme për menaxhmentin e komunës. Gjatë këtij aktiviteti ka zhvilluar intervista me menaxherët dhe ka shqyrtuar mostra për të identifikuar shkallën e implementimit të rekomandimeve dhe aktivitetet që janë ndërmarr në këtë drejtim. Gjatë kësaj periudhe janë dhënë një numër i rekomandimeve dhe shumica prej tyre janë implementuar ku janë ndërmarrur një numër i madh i aktiviteteve për adresimin e drejtë të tyre. Për implementimin e këtyre rekomandimeve, në fund të vitit janë identifikuar se Menaxhmenti i komunës ka ndërmarr mbi pesëdhjetë aktivitete të ndryshme që kanë pasur për qëllim implementimin e rekomandimeve të auditorëve me qëllim të arritjes së një shkalle të kënaqshme të përputhshmërisë me ligjet në fuqi si dhe shfrytëzimit sa më ekonomik, efikas dhe efektiv të buxhetit komunal.

### 1.3. ZYRA E PERSONELIT

Për gjashtëmujorin e vitit 2021, Zyra e personelit ka azhuruar listat e pagave sipas ndryshimeve, konformë zhvillimeve në stafin e punëtorëve.

2. Paraqitja në formë tabelare e realizimit sipas azhurimit në listë të pagave ;

| Muaji-viti | Punëtorë të rinj | Ndryshime | Punëtorë të larguar | Pagesa retroaktiv | etj |
|---|---|---|---|---|---|
| Janar 2021 | 1 | 2 | 0 | 8 | Lista për anët.dhe anët. të KK |
| Shkurt 2021 | 0 | 0 | 0 | 5 | Lista për anët.dhe anët. të KK |
| Mars 2021 | | 5 | 1 pensionim | 5 | Lista për anët.dhe anët. të KK |
| Prill 2021 | 1 | 6 | 1 (pensionim dhe 1 masë disiplinore | 8 | Lista për anët.dhe anët. të KK |
| Maj 2021 | 3 | 6 | 1 | 15 | Lista për anët.dhe anët. të KK |
| Qershor 2021 | 0 | 5 | 1 largim për shkaqe personale | 9 | Lista për anët.dhe anët. të KK |
| Korrik 2021 | 0 | 4 | 0 | 4 | Lista për anët.dhe anët. të KK |
| Gusht 2021 | 0 | 3 | 1 pensionim | 9 | Lista për anët.dhe anët. të KK |
| Shtator 2021 | 0 | 4 | 1 perfundim i marrdh. së punës me vdek. e nëpunësit | 5 | Lista për anët.dhe anët. të KK |
| Tetor 2021 | 0 | 4 | 0 | 5 | Lista për anët.dhe anët. të KK |
| Nëntor 2021 | 3 | 2 | 1 pensionim | 9 | Lista për anët.dhe anët. të KK |
| Dhjetor 2021 | 0 | 2 | 0 | 7 | Lista për anët.dhe anët. të KK |

Nga muaji Janar 2021, zyra e personelit me kërkesë të MAP, USAID, IKAP, ATK ka përgatitur planin për trajnimin e stafit (shërbyesve civil). Është përgatitur lista e të dhënave të të punësuarave në shërbimin civil, për staf në Arsim, në Shëndetësi, staf Politik, staf mbështetës dhe i është dërguar përmes formularit (Moduli i Statistikave) në SIMBNJ (Sistemi Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore). Hartimi i planit individual i personelit për pozitat e lira nga të gjitha format e kërkesave për vitin 2021 është përfunduar në fund të muajit Tetor 2021, përmes sistemit të SIMBNJ, si dhe në Dhjetor 2021 bëhet plotësim-ndryshimi i PPI, sipas kërkesës së DMZP qe të përfshihen edhe pozitat e lira nga sektori i Arsimit dhe Shëndetësisë. Sqarim; Pra për kërkesat e njësive kërkuese për plotësim të pozitave të lira të punës nga muaji Janar 2021 është filluar me konkurse të mbyllura (brendshme) Lëvizje paralele brenda kategorisë, gjatë vitit 2021 janë realizuar shtatë (7) pozita Lëvizje paralele brenda kategorisë. Pas këtij hapi si dhe interesimi i njësive kërkuese qe sa më parë të zhvillohen procedurat rekrutuese për pozitat e lira të punës, kërkesat për plotësimin e pozitave me rastin e pensionimit, me vdekjen e nëpunësit, me ndërprerje të marrëdhënies së punës për arsye të ndryshme, si dhe pozitat e lira të punës të planifikuara me PPI për vitin 2021 të cilat në mungesë të infrastrukturës ligjore (Plotësim-ndryshimet ligjore dhe akteve nënligjore) në nivel vendi, është filluar në Korrik të vitit 2021 me shpallje të konkurseve – pranim (konkurse të jashtme dhe janë realizuar tri (3) pozita : Përfaqësuesi Ligjor i Komunës dhe dy (2) pozita; Zyrtar Ligjor 2.

**Në muajin Maj dhe Dhjetor 2021 Auditorët e jashtëm,**

**Nga auditorët janë kërkuar**; dosjet personale për disa shërbyes civil, Akt Emërimi, Lista e pagave për muaj të caktuar, Kualifikimi (diplomë ose certifikatë), lista e shërbyesve civil në pushim të lehonisë 2020, punë shtesë të shërbyesve civil, procedurën e pensionimit me arritjen e moshës, raporti periodik i evidencës së hyrjeve dhe daljeve të punëtorëve për periudhë të ndryshme mujore.

Zyra e personelit është përgjigjur dhe ka plotësuar dokumentacionin në bazë të detyrës zyrtare edhe sipas kërkesës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me rastet ankimore. Po ashtu zyra e Personelit dhe njësia e personelit sipas detyrës Zyrtare dhe sipas Rreg.nr.11/2020 ka rolin e sekretarisë për përgatitjen e seancave sipas ankesave, për Komisionin Disiplinor, ku janë zhvilluar seancat: Ankesat kanë qenë; ankesa për masë disiplinore, për pagë jubilare.

KPMSHCK ka qenë në kryerjen vizitës monitoruese në Komunën e Drenasit me datën **20.12.2021** (**e hënë**), duke filluar me punë në ora **10:00,** në monitorim të dosjeve personale të nëpunësve civil, procedurat e rekrutimit dhe avancimit, procedurat disiplinore, procedurat e ankesave, procedurat e vlerësimit, ndërprerja dhe përfundimi i marrëdhënies së punës, trajnimi i nëpunësve civilë, vijueshmëria në punë, shtesat dhe kompensimet si dhe sa zyrtar kanë shfrytëzuar pushime mjekësore, si dhe lidhur me punët dhe detyrat e tjera që dalin nga kompetencat e zyrës së personelit.

## 2.1.ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE (ZKIE)

ZKIE- Ky raport përmbledh dhe paraqet arritjet e objektivave dhe progresin në zbatimin aktivitete lidhur me integrimet evropiane për një periudhë 1 vjeçare. ZKIE- Harton dhe miraton plane, projekte dhe ofron shërbime përkatëse në fushën e integrimeve evropiane, ofron përkrahje, këshilla profesionale në fushën e integrimit evropian duke marrë parasysh obligimet që dalin nga të gjitha dokumentet strategjike kombëtare rreth integrimit evropian dhe marrëdhënieve në Kosovë, ndihmon në koordinimin e çështjeve që kanë të bëjnë me integrime evropiane, merr pjesë në përcaktimin dhe planifikimin e aktiviteteve të Komunës në përputhje me dokumentet strategjike kombëtare për integrim evropian, koordinon dhe bashkëpunon me zyrën e personelit për ngritje të kapacitetit të stafit për çështjet e ndërlidhura me integrim evropiane, ofron udhëzime për stafin e nivelit më të ulët të njësisë organizative në bërjen e hulumtimeve, përgatitjen e raporteve dhe ofrimin e këshillave rreth çështjeve të integrimit evropian, duke kontribuar në punën e tyre sipas nevojës monitoron produktet. ZKIE gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022 ka kryer punët dhe detyrat e punës në bazë të planit të punës përshkrimit të detyrave të punës dhe Rregullores Qeverisë 08/2011. Programi Kombëtar për Zbatim të MSA-së që është dokument ligjërisht i detyrueshëm për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe Komuna, ku në nivelin lokal kemi Planin e veprimit të obligimeve të Komunave nga Agjenda Evropiane. Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi përcjellë raporte sipas kërkesës së Ministrisë për Integrime Evropiane, kemi koordinuar punën më Drejtorët e drejtorive e shefa të sektorëve dhe Udhëheqësin e personelit për identifikimin e nevojave për trajnime për stafin civil të Komunës së Drenasit. Është raportuar më kohë kryetarit dhe MPL-së për Përmbushjen e Obligimeve nga Agjenda Evropiane për periudhën Janar-Qershor 2022 për Komunën e Drenasit. Në muajin Korrik është bërë përpilimi i Raportit të Përmbushjes së obligimeve të cilat dalin nga Agjenda Evropiane dhe është përcjellë për Ministrinë e Integrimeve Evropiane përkatësisht znj.Edona Morina. Në këtë raport janë të përfshira të dhëna lidhur me Zyrën për Integrime Evropiane si dhe mbi përmbushjen e obligimeve të Komunave të cilat dalin nga Agjenda Evropiane, për periudhën Janar - Dhjetor 2022.

## 2.2.ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim këshillon autoritetet komunale në lidhje me nevojat e komuniteteve pakicë që jetojnë në Komunën tonë, të siguroj mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të tyre, qasje të barabartë të gjitha komuniteteve në shërbimet publike dhe të krijoj kushte për një kthim të qëndrueshëm të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe atyre të riatdhesuar që u përkasin të gjitha komuniteteve. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim gjatë vitit 2021, ka pasur për fokus personat e riatdhesuar – riintegrimin e tyre. Gjatë këtij viti kemi 16 persona të riatdhesuar, nga këto raste, 4 i kemi raste të cenueshme. Në bazë të Rregullores së Riintegrimit 22/2020, personat e riatdhesuar kanë mundësi aplikimi në: Vetëpunësim, Subvencionimi në punësim dhe Trajnim në punë. Tek subvencionimi dhe trajnimi në punë kemi pasur persona të cilët kanë aplikuar. Përfitues nga kjo skemë i kemi 4 persona. Gjatë këtij gjashtë mujori kemi pasur 40 kërkesa nga personat e riatdhesuar për pajisje me vërtetim, pastaj për kompletim të dokumentacionit, ku të gjithë janë pajisur në bazë të dokumenteve të kthimit që i kanë poseduar. Nga personat e riatdhesuar kemi verifikuar në teren 4 rastet e cenueshme. Verifikimi është bërë së bashku me koordinatorin rajonal nga MPB. Zyra për Komunitete dhe Kthim gjatë këtij viti ka mbajtur 6 takime të Komitetet për Komunitete, ku temë diskutimi ka qenë gjithmonë si pike e pare Raporti i punës nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, pastaj temat të cilat kanë të bëjnë me mirëqenien e qytetarëve të Komunës sonë. Gjithashtu kemi qenë pjesë e KKSB-së, ku në çdo mbledhje kemi dhënë kontributin tonë. Në fillim të muajit Mars kemi mbajtur takim me KFOR-Italian, ku kemi diskutuar për punën e ZKKK gjatë vitit 2020 dhe fillimin e vitit 2021. Zyra për Komunitete dhe Kthim gjatë vitit 2021 ka vazhduar me monitorimin dhe bashkëpunimin me Organizatën “AKTI”, mbi projektin për përgatitjen e të rinjve dhe shfaqjen e vlerave të tyre, përmes trajnimit dhe këshillimit se bashku me trajnerët e tyre. Si koordinatore e Grupit lokal të Veprimit – kemi mbajtur 6 mbledhje, ku si grup kemi diskutuar mbi punën dhe të arriturat e Org.Akti, mbi të arriturat e të rinjve të Komunës sonë. Në vazhdim të raportit paraqes punën e grupit dhe të Org. mbi aftësimin e të rinjve- grupeve të margjinalizuara duke përfshirë personat e riatdhesuar. Në muajin Janar ka përfunduar trajnimi i 20 të rinjve, 15 të reja dhe 5 të rinj. Nga grupi prej 20 të rinjve, 5 prej tyre kanë qenë me nevoja të veçanta fizike, 5 të rinj nga ndihma sociale dhe kushte të vështira ekonomike, një nënë e vetme, një grua e re që ka lënë kujdesin alternativ, një e re e divorcuar (abuzuar nga ish i saj -burri), një grua e re me një problem shëndetësor dhe 6 të rinj të papunë. Janë zhvilluar disa takime me sektorin privat, me të cilin kemi arritur një marrëveshje për të angazhuar të rinjtë që kanë qenë pjesë e projektit. Si rezultat, 3 të rinj janë të angazhuar në punë të rregullt (dy vajza dhe një djalë), një vajzë ka filluar praktikën me mundësi punësimi dhe një djalë pritet të fillojë praktikën me mundësi punësimi në një ndërmarrje të ngrohjes qendrore gjatë muajit shkurt. Dy vajza të reja janë angazhuar në hijen e punës në punën administrative në organizatën Akti-Fushë Kosovë. Certifikimi i të rinjve që morën pjesë në trajnim u bë në sallën e Kuvendit Komunal të Komunës së Drenasit, me ç ‘rast u bë një postim i veçantë në faqen e internetit të Komunës së Drenasit, ku përveç rezultateve të arritura gjatë kësaj kohe të implementimit të projektit, falënderime të veçanta iu drejtuan edhe organizatës e cila u dha këtë mundësi të rinjve të Komunës së Drenasit. Bazuar në nevojat e të rinjve të paraqitur në planet e tyre individuale, u mbajtën 11 seanca të kurrikulës "Aftësitë Themelore të Jetës" dhe 9 seanca të kurrikulës "Punësueshmëria". Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, trajnimet u mbajtën fizikisht dhe në internet. Një vështirësi ka qenë mungesa e pajisjeve teknologjike për disa të rinj që janë zëvendësuar në takimet individuale ato seanca të cilat ata nuk kanë qenë në gjendje të marrin

pjesë. Në fillim të muajit Mars është formuar Grupi i dytë për fillimin e trajnimit ku janë përfshirë 20 të rijnë. Gjatë muajve në vazhdim pastaj ka filluar trajnimi dhe janë zhvilluar procedura të njëjta si për grupin e parë.Me datë 08.06.2021 kemi mbajtur takim me tre biznese në Parkun e Biznesit, “Medruplast”, “Euromodel” dhe “Shehu”, mbi kyçjen e të rinjve në tregun e punës. Me datë 24.06.2021 ka përfunduar trajnimi i 20 të rinjve mbi “Shkathtësitë Bazë Jetësore”.Certifikimi i të rinjve u bë në të njëjtën ditë me një rezultat mjaftë të suksesëshem si rezultat i pergaditjeve në aspektin e punsushmerisë janë angazhuar: tetë(8) të rijnë në punë direkte, intership (praktikë me pagesë) si dhe praktikë varësisht prej qëllimeve në aspektin e punsushmerisë të së cilit, kurse të tjerë pritet që të angazhon në ditët në vazhdim. Nga gjithë kjo punë kemi gjithsej 40 të rijnë të certifikuar, ku nga ta kemi gjithsej 24 persona të përfshirë në punë direkte, praktikë me pagesë dhe praktikë. Me datë 16.11.2021, ka filluar grupi i tretë i trajnimit ku përfshihen 22 të rijnë. Ndërsa në fund të muajit dhjetor është bërë certifikimi i tyre, gjithsej nga të tre grupet kemi 60 të rijnë të certifikuar nga gjithë projekti. I gjithë ky rezultat është arrit falë bashkëpunimit me institucionet dhe bizneset komunale. Më datë 20.09.2021, kemi mbajtur punëtori Rreg.09/2019, për Integrimin e të huajve. Gjithashtu kemi pasur edhe dy familje të riatdhesuar në fillim të muajit dhjetor, ku kemi qenë në vizitë së bashku me koordinatorin e MPB, dhe një zyrtar nga QPS.

## 2.3.ZYRA PËR BARAZI GJINORE

ZBGJ përkatësisht, Zyrtarja për barazi gjinore Komuna Drenas, gjatë periudhës raportuese Janar – Dhjetor 2021 duke u bazuar në Ligjin për barazi gjinore, planin e punës dhe përshkrimin e detyrave të punës, pavarësisht situatës me pandeminë covid 19 ka realizuar aktivitete të cilat dalin nga fushëveprimtaria e saj si takime, trajnime, sesione informuese etj të organizuara në bashkëpunim me ekzekutivin e Komunës së Drenasit të cilat kanë për qëllim promovimin dhe respektimin e barazisë gjinore si dhe mbështetje financiare të realizuara në formë të subvencioneve. Meqenëse nuk ka ndonjë kod të veçantë buxhetor lidhur me barazinë gjinore përkrahja e të rinjve, grave dhe burrave behët përmes Drejtorive komunale dhe në bashkëpunim me OJQ të tjera. Në vazhdim të raportit janë të paraqitura në mënyrë kronologjike të gjitha aktivitetet e realizuara për periudhën 6 mujore. Janar -Organizata rinore OJQ “AKTI” në bashkëpunim me Komunën e Drenasit kanë organizuar një trajnim 3 mujor ku nga ky trajnim 20 të rinj nga Komuna e Drenasit, kanë pranuar certifikata për pjesëmarrje në fuqizimin dhe aftësimin e tyre për tregun e punës me temën “Shkathtësitë bazë jetësore dhe punësueshmëria”. Implementimi i këtij projekti, ka ardhur falë nënshkrimit marrëveshjes së mirëkuptimit mes kryetarit Lladrovci dhe drejtorit Gojnovci, për realizimin e projektit “përfshirja sociale dhe fuqizimi ekonomik i të rinjve dhe familjeve, përmes masave për krijimin e të ardhurave”. Projekti është duke u implementuar me SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë, ndërsa financohet nga The German Federal Ministry for Economik Coopertion and Development (BMZ) dhe Hermann-Gmeiner Fund Germany (HGFD). Qëllimi i këtij projekti është që të kontribuojë drejtë përmirësimit të perspektivave të punësimit, mirëqenies sociale dhe ekonomike të të rinjve dhe familjeve në Komunën e Drenasit përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës. Shkurt - Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik (DZHE) në bashkëpunim me Agjencinë për Zhvillim Rajonal Qendër (AZHR) kanë mbajtur trajnim për nxënësit, studentët dhe gjithë të interesuarit në kuadër të projektit “Trajnimi profesional dhe angazhimi në punësim” me titull “Trajnim për Orientimin në Karrierë / Trajnim për aftësi të buta” të organizuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Në këtë trajnim, të gjithë te interesuarit patën mundësinë të trajnohen në mënyrë profesionale rreth orientimit në karrierë. Mars - Me rastin e 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas nga Kryetari i Komunës u janë shpërndarë lule të gjitha punonjëseve të administratës komunale në shenjë mirënjohje për punën e palodhshme gjatë gjithë vitit. Gjithashtu Komuna e Drenasit se bashku me Komunën e Mitrovicës Jugore dhe në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Kosovë kanë organizuar Konkurs të Propozimit të Politikave Komunale. Ky konkurs ka pasur për qëllim që të identifikojë sfidat specifike me të cilat përballen gratë dhe vajzat në Komunën e Drenasit. Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci ka marr pjesë në ekspozitën e organizuar e punuar nga personat me aftësi të kufizuara Handikos në Drenas. Ekspozita me punime dore, artizanale dhe pikturë me moton “Edhe unë mundem-më përkrahni mua” është mbajtur në degën e Shoqatës për Persona me Aftësi të Kufizuara Handikos në Drenas. Kryetari Lladrovci në këtë ekspozitë, tha se personat me nevoja të veçanta duhet të përkrahen e mbështetën nga e gjithë shoqëria. “Përgëzoj anëtarët e shoqatës që kanë bërë punë të shkëlqyeshme, duke prezantuar vendin më se miri me artizanale e piktura. Ne do të vazhdojmë të mbështesim këtë shoqatë, e po ashtu ne secilin projekt të realizuar nga Komuna, që kërkohet sipas standardeve, do të krijojmë kushte e mundësi të barabarta për të gjithë”, ka thënë kryetari Lladrovci. Pastaj së bashku me Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik/Komuna Drenas dhe organizatën Kosova Women 4 Women janë mbajtur trajnime me gratë lidhur me temën për bujqësi dhe hortikulture. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë shumë gra më qëllim që të zgjerojnë kapacitetet e tyre në ekonomi dhe në tregun e punës. Projekti i SEE Mundësitë e përmirësuara te punësimit dhe të vetëpunësimit kanë për qellim përmirësimin e pozitës së grave në ekonomi dhe në tregun e punës duke i ngritur kapacitetet e tyre .

Maj- Në muajin Maj ZBGJ në bashkëpunim me Drejtoreshën për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit së bashku me rrjetin Qeliza. Në këtë u diskutua lidhur me të drejtat e grave nga marrëdhënia e punës, diskriminimi në punë, legjislacioni aktual në Kosove si dhe adresimi i shkeljeve eventuale i të drejtave nga marrëdhënia e punës. Në këtë takim gjithashtu u diskutua edhe për mekanizmat të cilëve duhet adresuar në rastet kur kemi shkelje eventuale nga marrëdhënia e punës. Pjesëmarrës në këtë takim kanë qenë zyrtare nga Komuna dhe shoqëria civile.

Qershor -Më rastin e shënimit të 1 Qershorit, Ditës Botërore të Fëmijëve, Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, gjatë ditës ka qëndruar në Çerdhen e qytetit “Ardhmëria” dhe ka uruar të gjithë fëmijët e Komunës së Drenasit për këtë ditë. Kryetari Lladrovci gjatë vizitës tha se “lumturia e fëmijëve është çelësi i lumturisë së shoqërisë tonë. Gëzuar Dita e Fëmijëve në Kosovën e lirë”, ka thënë ai. Meqenëse Komuna e Drenasit është përfituese e grantit për përformancë Komunale është mbajtur takim me ekipin DEMOS ku u diskutua lidhur me raportin e performancës komunale. Në të gjitha matjet që behën për performancë e transparencë si nga niveli qendror nga OJQ dhe ndërkombëtar, Drenasi radhitet në mesin e komunave me të mira dhe për secilin vit, është edhe përfituese e granteve, ku mjetet e fituara janë dedikuar në projektet kapitale për të mirën e qytetarëve. Nga ekipi DEMOS pjesëmarrës ishin Mjalinda Jupolli dhe Arblin Pireva ndërsa nga Komuna Drenas, Kryetari, zëvendës kryetari, zyrtarja për barazi gjinore drejtori i Financave dhe administratës Komunale .

Me qëllim të përkrahjes së grave në agrikulturë Komuna e Drenasit përkatësisht kryetari Ramiz Lladrovci kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me AZHRQ/ Agjencionit për Zhvillim

Rajonal Qendër. Kryetari Lladrovci me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes theksoi se këto projekte ndikojnë drejtpërdrejtë në fuqizimin ekonomik të grave. Ai shtoi se këto projekte janë të mirëpritura për komunën dhe se në vazhdimësi do t'i mbështesë.

Si rezultat i qeverisjes së mirë, transparente e llogaridhënëse, kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëfinancimit për realizimin e projektit për fuqizimin e të rinjve, me Ministrin e Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi.

Sipas kësaj marrëveshje, Komuna e Drenasit është përfituese e 250 mijë dollarëve për të rinjtë e komunës sonë, për financimin e iniciativave, ideve dhe biznes planeve të tyre kreative.

Ky grant është siguruar nga qeveria Japoneze përmes Bankës Botërore dhe implementohet nga Ministria e Pushtetit Lokal dhe Komunës së Drenasit. Në vlerën totale të këtij granti, komuna bashkëfinancon 15% të vlerës financiare.

Kryetari Lladrovci ka falënderuar donatorët për vlerësimin e komunës për të qenë përfitues i këtij granti që ka ardhur si rezultat i qeverisjes së mirë e transparente dhe ka shtuar se mjetet e këtij granti do të adresohen për të rinjtë, në mënyrë që të krijohen vende të reja të punës dhe aktivitete të ndryshme për të rinjtë e cila ndikon direkt në largimi i dukurive negative. Fituesit e këtij granti, do të përzgjidhen përmes thirrjeve publike që do të shpallen gjatë këtij viti dhe projekti do të zgjas deri në vitin 2023.

Korrik - Gjatë muajit Korrik mbi 30 gra të Komunës së Drenasit janë certifikuar në trajnim për hortikulturë nga organizata "Women 4 Women" në kuadër të projektit "Mundësitë e përmirësuara të vetë-punësimit dhe punësimit" I SEE, marrëveshje kjo bashkëpunimi mes Komunës së Drenasit dhe organizatës Women 4 Women.

U.D Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik, Laureta Thaqi dhe Drejtoresha e Women 4 Women, znj. Iliriana Gashi, kanë bërë ndarjen e certifikatave për pjesëmarrëset e trajnimit të mbajtur nga kjo organizatë. Të njëjtat kanë uruar pjesëmarrëset e trajnimit duke shpresuar që aftësimi i tyre në këto trajnime të ju shërbejë, në mënyrë që të kenë qasje më të lehtë në tregun e punës, përkatësisht punësimin dhe mundësinë e vetëpunësimit, që ishte edhe qëllimi i bashkëpunimit me organizatën

Edhe pjesëmarrëset e trajnimit të cilat u certifikuan, shprehen vullnetin që të vazhdojnë edhe me tutje me angazhime të tilla në mënyrë që të kenë mundësi të punësimit apo vetëpunësimit përmes bujqësisë dhe hortikulturës.

Shtator - Me qëllim të përkrahjes së të rinjve Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci dhe përfaqësuesi i "Flutura Academy" Bekim Ahmetaj, kanë përuruar aktivitetet e kësaj organizate në objektin e Qendrës Rinore në Drenas.

Të rinjtë e komunës së Drenasit, në këtë Qendër Rinore do të kenë mundësi të shfrytëzojnë këtë objekt për arsyeje edukativo-arsimore, ku do të bëhet organizimi dhe mbajtja e trajnimeve pa pagesë të ofruara nga Akademia Flutura.

Me këtë rast, kryetari Lladrovci është shprehur i lumtur që të rinjtë do të kenë mundësi të trajnohen dhe të përgatitën profesionalisht për tregun e punës.

"Ky objekt është i dedikuar rinisë së Drenasit, trajnime në sektorin e IT-së, trajnime të cilat do të ndihmojnë të rinjtë të përgatiten për tregun e punës. Pra, në kemi zgjedhur Drenasin, me kthy kontributin që ne e kemi marr pikërisht nga ky vend. Falënderoj kryetarin për bashkëpunim", ka thënë Ahmetaj.

Përurimit të aktiviteteve, i paraprinë kontrata njëvjeçare për shfrytëzimin e këtij objekti mes kryetarit Lladrovci dhe 'Flutura Academy".

Komuna e Drenasit nikoqire e kampit ndërkombëtar "Edu Camp Summer 2021"

Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci ka udhëhequr konferencën ndërkombëtare të kampit veror "Edu Camp Summer 2021", pjesë e të cilit kanë qenë mbi 500 nxënës nga Kosova, Gjermania, Austria dhe vendet e tjera të rajonit.

Drenasi, si nikoqir i organizimit të këtij kampi ndërkombëtar, ka bërë të gjitha përgatitjet për pjesëmarrje fizike, por, për shkak të pandemisë është mbajtur online në shkollën e mesme "Gjergj Kastrioti Skënderbeu".

Ai ka shtuar se arsimi mbetet prioritet i përhershëm i qeverisjes së tij në Drenas.

"Kjo tregon se arsimi është prioriteti ynë i përbashkët, nxënësit e Drenasit të jenë në hap me nxënësit dhe arsimin e vendeve të BE-së, duke përfaqësuar edhe praninë e shtetit tonë. Prania e nxënësve dhe mësimdhënësve të Drenasit, si pjesëmarrësit e vetëm nga shteti jashtë BE-së në konferencën e organizuar nga Euroscola, është po ashtu sukses i arsimit dhe qeverisjes tonë. Nxënës, prindër, mësimdhënës, ju siguroj se mbështetja ime nuk do të ju mungojë asnjëherë", ka thënë mes të tjerash ai, duke e falënderuar për bashkëpunim udhëheqësen e Education Unlimited, znj. Kerstin Zielosko.

Ndërsa, znj. Kerstin Zielosko, udhëheqëse e Education Unlimited ka falënderuar kryetarin Lladrovci për bashkëpunimin dhe organizimin e këtij kampi të rëndësishëm për nxënësit dhe mësimdhënësit, si hap i mirë i shkëmbimit të përvojave mes nxënësve të Kosovës me Gjermaninë dhe vendet e rajonit.

Në këtë konferencë mori pjesë edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti i cili falënderoi për organizimin e këtij kampi virtual, duke vlerësuar të rëndësishëm programet e tilla për arsimin në shtetin tonë.

Tetor - Muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit. Me rastin e muajit të ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit Zyra për Barazi Gjinore së bashku me ekzekutivin-drejtoreshat e Komunës së Drenasit, femrat asambleiste dhe shoqëria civile ka mbajtur marsh me qëllim të ngritjes së vetëdijes dhe ndërgjegjes lidhur me kancerin e gjirit me moton " Zbulimi i hershëm shpëton jetë ". Çdo vit përmes aktiviteteve të ndryshme bëhen thirrje për të rritur ndërgjegjësimin, në parandalimin dhe vetëdijesimin lidhur me kancerin e gjirit, sëmundje kjo e cila merr jetën e shumë femrave në mbarë botën. Gjithashtu në bashkëpunim me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale si dhe QKMF

në Drenas është mundësuar që të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit të bëjnë ekzaminimin e gjirit MAMOGRAFINË paraprakisht duke caktuar termin çdo të mërkurë.

Fushata kundër trafikimit me njerëz. Komuna e Drenasit përkatësisht Zyra për Barazi Gjinore, ka hapur fushatën sensibilizuese kundër trafikimit me qenie njerëzore. Qëllimi i kësaj fushate është Parandalimi i trafikimit me njerëz dhe ngritja e vetëdijes së popullatës së gjerë lidhur me trafikimin e njerëzve meqenëse trafikimi me njerëz është një dukuri e cila e prek edhe shoqërinë tonë. Një ndër format me të reja të mashtrimit të viktimave të trafikimit është përmes internetit dhe komunikimit nëpër rrjete sociale. Të rinjtë mashtrohen për punë kinse ju sjellin përfitime ndërsa përfundojnë në rrjet të trafikantëve.

Sipas Kodit Penal të Kosovës "trafikim me njerëz" nënkupton rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim i personave me anë të kanosjes ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthimit, keqpërdorimit të pushtetit apo të keqpërdorimit të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies ose marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër, me qëllim të shfrytëzimit.

Kjo fushatë vetëdijesuese lidhur me parandalimin e trafikimit me njerëz në Komunën e Drenasit ka filluar me datë 19 tetor dhe ka zgjatur deri më 18 nëntor duke filluar me shpërndarjen e materialeve të pranuara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal/ Divizioni për Avancimin e të Drejtave të Njeriut në Komuna cilat si mesazh kanë raportimin e trafikimit me njerëz, format se si vjen deri tek trafikimi me njerëz e sidomos trafikimi i fëmijëve. Këto materiale fillimisht janë shpërndarë në hapësirat e Komunës së Drenasit në Zyrën e informimit me qytetarë meqenëse gjatë ditës shumë qytetarë kërkojnë shërbime të ndryshme dhe nga Zyrtari për informim dhe shërbim me qytetarë janë njoftuar qytetaret me hapjen e kësaj fushate vetdijësuese janë shpërndarë edhe broshurat të cilat përcjellin mesazhin se si mund të vie deri tek trafikimit me njerëz dhe rëndësinë e raportimit të këtyre rasteve tek organet kompetente për parandalimin e trafikimit me njerëz.

Në bashkëpunim me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale si dhe Qendrën për Punë Sociale si organe të cilat ofrojnë shërbime lidhur me parandalimin dhe viktimat e trafikimit me njerëz është mbajtur takim me Drejtorët për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale si dhe Zyrtarët për Shërbime Sociale ku si temë diskutimi e këtij takimi ishte : faktorët të cilët ndikojnë në trafikimin e njerëzve format e trafikimit e sidomos trafikimi me fëmijë, masat të cilat janë ndërmarrë nga Qendra për Punë Sociale me qëllim të parandalimit të trafikimit me njerëz. Gjithashtu janë shpërndarë poster dhe broshura në ambientet e Qendrës për Punë Sociale për te theksuar rëndësinë e kësaj fushate dhe parandalimit të trafikimit me njerëz . Nga Qendra për Punë Sociale / Komuna Drenas gjatë periudhës Janar -Tetor 2021, janë trajtuar dhe menaxhuar 5 raste të viktimave të trafikimit me njerëz nga Zyrtarët për Shërbime Sociale.

Gjithashtu në kuadër të kësaj fushate vetëdijesuese në bashkëpunim edhe me Drejtorinë Komunale të Arsimit është mbajtur takim me Drejtorin dhe Zyrtarët për Arsim dhe është bërë shpërndarja e posterave dhe broshurave tek drejtorët e shkollave të mesme të ulëta me qëllim të informimit të stafit dhe nxënësve lidhur me dukurinë trafikimit me njerëz si dhe janë mbajtur ligjërata të shkurtër rreth përmbajtjes se këtyre materialeve. Këto materiale janë vendosur në hapësira të shkollave me qëllim që nxënësit të informohen se cilat janë mënyrat të cilat fëmijët mund të jenë në rrezik të trafikimit,

cilat janë mënyrat e raportimit të trafikimit në qoftë se gjenden në një situate të tillë, cilat janë organet kompetente për parandalimin dhe luftimin e trafikimit më njerëz.

Projekti " Përkrahja dhe fuqizimi i grave në agrikulturë ". Drejtoria për Zhvillim Ekonomik me qëllim të përkrahjes së femrave-grave në agrikulturë në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Komunës së Drenasit dhe Agjencisë për Zhvillim Rajonal Qendër (AZHRQ) ka përkrahur përmes granteve ka përkrahur 13 femra .Trajnimi për fuqizimin dhe shkathtësimin e të rinjve nga YEEP ka vazhduar me temën "Fuqizimi dhe shkathtësimi i rinjve përmes mundësive të reja" YEEP në Drenas, ku 20 të rijnë kanë qenë përfitues të pakos së trajnimeve nga metodologjia "Shkathtësitë Themelore Jetësore dhe Punësimit".

Implementimi i këtij projekti është mundësuar nga nënshkrimi i memorandumit mirëkuptimit mes kryetarit të komunës, z.Ramiz Lladrovci dhe drejtorit të organizatës Z. Rexhep Gojnovci.. Projekti është implementuar nga organizata rinore AKTI në bashkëpunim me SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë, ndërsa është financuar nga The German Federal Ministry for Economik Coopertion and Development (BMZ) dhe Hermann-Gmeiner Fund Germany (HGFD).

Përmes këtij projekti, muaj me parë janë certifikuar 40 të rijnë nga Komuna e Drenasit të cilët kanë marr pjesë në trajnimin për fuqizimin dhe aftësimin e tyre për tregun e punës, dhe pas certifikimit, 24 prej tyre janë tani në marrëdhënie pune apo edhe punë praktike. Memorandum bashkëpunimi me Këshillin e studentëve të Fakultetit Juridik. Me qëllim të përkrahjes së të rinjve, Kryetari i Komunës së Drenasit z.Lladrovci ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me Këshillin e studentëve të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës " Hasan Prishtina ". Përmes këtij memorandumi të bashkëpunimit, stduentët Komunës së Drenasit do të kenë mundësi që të kryejnë praktikë profesionale në komunë, e cila do ti shërbejë zhvillimit profesional të studentëve dhe zbatimi i njohurive të marra gjatë studimeve.

Nëntor 13 gra nga Drenasi, përfitojnë makineri në agrokulturë. Pas nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit mes kryetarit të Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci dhe Drejtoreshës së Agjencinë për Zhvillim Rajonal Qendër, Mrika Gashi, janë nënshkruar kontratat me 13 gra përfituese për makineri nga agrikultura. Kryetari Lladrovci, ka falënderuar AZHR-në për këtë përkrahje dhe ka përgëzuar përfitueset e kësaj skeme të grandeve. Lladrovci ka thënë se qeverisja e tij, do të jetë çdo herë në mbështetje të grave për të ju krijuar lehtësira ne të bërit biznes dhe ka uruar që mjetet e fituara të jetë frytdhënëse në punën që bëjnë.

Drejtoresha e AZHR-së, Mrika Gashi dhe Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik, Egzona Jetullahi-Gjoshi, kanë nënshkruar marrëveshjet mes palëve përfituese dhe kanë uruar ato për mjetet e agrolutures.. Marrëveshja e bashkëpunimit është bërë në kuadër të projektit "Përkrahja dhe fuqizimi i grave". Grupi Lokal i Veprimit. Grupit Lokal të Veprimit merret me monitorimin e Organizatës Akti në implementimin e projektit "përfshirja sociale dhe fuqizimi ekonomik i të rinjve dhe familjeve, përmes masave për krijimin e të ardhurave". Anëtarët Grupit Lokal të Veprimit Lokal kanë mbajtur takime ku janë njoftuar lidhur me procesin e punës së OJQ "Akti" e cila është duke u marr me trajnimin e të rinjve për vetëpunësim.

Drejtori i OJQ "Akti", Rexhep Gojnovci, anëtarëve të Grupit Lokal të Veprimit, i ka njoftuar se grupi i tretë i trajnimeve është në përfundim dhe së shpejti pritet edhe certifikimi i tyre, ndërsa pas përfundimit të këtij grupi, do të vazhdohet me këtë projekt duke përfshirë të gjithë të rinjtë që nuk kanë mundur të gjejnë veten në punësim e praktikë, duke ju mundësuar aftësime profesionale për punësim e vetëpunësim. Shpenzimet e ndjekjes së trajnimit, i mbulon organizata "Akti".

Implementimi i këtij projekti, ka ardhur falë nënshkrimit të mirëkuptimit mes kryetarit Lladrovci dhe drejtorit Gojnovci, për realizimin e projektit. Projekti është duke u implementuar me SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë, ndërsa financohet nga The German Federal Ministry for Economik Coopertion and Development (BMZ) dhe Hermann-Gmeiner Fund Germany (HGFD).

Përmes këtij projekti, vitin e kaluar dhe gjatë këtij viti, janë certifikuar 40 të rinj nga Komuna e Drenasit të cilët kanë marr pjesë në trajnimin për fuqizimin dhe aftësimin e tyre për tregun e punës dhe pas certifikimit, 15 prej tyre janë tani në marrëdhënie pune. Ndërsa tani është në përfundim edhe trajnimi i grupit të tretë me 22 pjesëmarrës të grup moshave rinore të cilët janë certifikuar në fund të muajit nëntor.

20 Nëntori Dita Botërore e të drejtave të fëmijëve. 20 Nëntori është shënuar në kalendar si "Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve". Përcaktimi i kësaj dite ka marrë shkas nga Konventa për të drejtat e fëmijëve, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 20 Nëntor 1989.

Qëllimi i shënimit të Ditës Botërore të fëmijëve është të kthejë vëmendjen e shoqërisë së gjerë tek detyrimet që i kanë ndaj fëmijëve, si dhe tek problemet më të rëndësishme të cilat përballen fëmijët.

HANDIKOS në Drenas ka shënuar këtë datë përmes një fjalimi për historikun e kësaj date, recitimeve, mesazheve sensibilizuese përmes pankartave, programit kulturorë artistik të përbashkët me nxënësit e SHKA Shqipet e Drenicës, fëmijët para prindërve, familjarëve të tyre dhe përfaqësues nga Komuna e Drenasit përkatësisht Zyrtarja për Barazi Gjinore dhe Zyrtarja për Shëndetësi, përçuan mesazhe për liri dhe të drejta, dhe që institucionet dhe shoqëria në përgjithësi të punoj për avancimin e të drejtave dhe lirive të tyre.

Komuna e Drenasit me aktivitete nis fushatën "16 Ditë e Aktivizimit kundër dhunës në familje". Komuna e Drenasit, përkatësisht Zyra për Barazi ka hapur fushatën sensibilizuese "16 ditët e aktivizmit kundër dhunës në familje" me vizitat në institucione të cilat kanë për qellim të parandalojnë, mbrojnë dhe trajtojnë viktimat e dhunës në familje.

Në vazhdën e aktiviteteve në kuadër të kësaj fushate janë mbajtur disa takime me akteret të cilët kanë rol kyç në parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie negative si dhe është bërë shpërndarja e posterëve e mesazh "unë zgjedh të jetoj pa dhunë" si dhe fletëpalosjeve. Në këto takime është dakorduar për forcimin e bashkëpunimit me këto institucione me qëllim të parandalimit dhe vetëdijesimit të qytetarëve për këto dukuri negative dhe raportimit të dhunës. Mesazhi kryesor i kësaj fushate sensibilizuese "unë zgjedh të jetoj pa dhunë" thekson se dhuna ne familje është njëkohësisht edhe shkelje e të drejtave të njeriut dhe cenim i të drejtës së jetës, e drejtë kjo e mbrojtur dhe e sanksionuar me ligj

Fillimisht është realizuar vizita në Stacionin Policor në Drenas meqenëse janë ata të cilët fillimisht përballen me rastet e dhunës në familje. Pjesë e këtij takimi ishin ZBGJ Gentianë Morina, ZL Altina Mulaj, Togeri Milaim Nuredini dhe Rreshterja, Aferdita Gucati. Gjatë këtij takimi është diskutuar lidhur me rastet e dhunës në familje, sa ndihen gratë të sigurta për lajmërimin e dhunës në familje, a ka ngritje a rënie të rasteve të dhunës në krahasim me vitin e kaluar sa ka ndikuar pandemia në ngritjen e këtyre rasteve, bashkëpunimi i policisë me akteret e tjerë kyç në trajtimin e dhunës në familje, cilat janë vështirësitë më të cilat përballen gjatë punës së tyre etj.

Pastaj vizita në Qendrën për Punë Sociale Komuna Drenas. Prezent gjatë realizimit të kësaj vizite ishin ZBGJ Gentianë Morina, ZL Altina Mulaj, Drejtori i QPS Elmi Dobra dhe Zyrtarët për Shërbime Sociale Vlorjan Meha dhe Teuta Morina. Në këtë takim është diskutuar rëndësia e ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit te shoqërisë në parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj gruas, forcimi i mekanizmave institucionale, ofrimi i shërbimeve sociale dhe mbështetja e viktimave të dhunës në familje, numri i rasteve të trajtimit të dhunës në familje, mosha e cila preket me së shumti nga dhuna në familje, llojet me të shpeshta të dhunës / dhuna fizike ndërkaq ajo psikologjike dhe seksuale janë raste me të rralla.

Vizita ka vazhduar edhe në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega Gllogoc ku të pranishëm ishin kryetari i kësaj Gjykate z.Daut Qela, ZBGJ Gentianë Morina, ZL Altina Mulaj ku nga kryetari i kësaj gjykate jemi njoftuar më hollësisht se procedurat të cilat kanë të bëjnë me dhunën në familje janë prioritet i kësaj gjykate dhe trajtohen në harmoni me legjislacionin në fuqi. Sfida me të cilën ata përballen gjatë punës së tyre të përditshme është realizimi i alimentacionit.

3 Dhjetori – Dita ndërkombëtare e personave me aftësi të kufizuara. Me moton “Kthjelluni-se boll ma ” HANDIKOS në Drenas ka shënuar 3 Dhjetorin Ditën ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuara ku pjesë e këtij aktiviteti ishte edhe ZBGJ nga KK Drenas. Përmes një video dokumentari në prezencën e personave me aftësi të kufizuara, prindërve dhe familjarëve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara si dhe përfaqësues nga Komuna e Drenasit është shënuar kjo datë duke përcjellë edhe mesazhin se Personat me Aftësi të Kufizuara meritojnë vëmendje dhe trajtim të dinjitetshëm për të jetuar një jetë të pavarur dhe me të drejta të barabarta në shoqëri. Gjithashtu janë shpërndarë edhe fletëpalosje lidhur me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

# 3. RAPORTET SIPAS DREJTORIVE

## 3.1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Periudha raportuese njëvjeçare e punës në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme përfshin lëmenjtë apo fushat nga Sektori i Gjendjes Civile, Zyra e Prokurimit, Qendra për Shërbime me Qytetar, Shërbimit të Kuvendit të Komunës, Sektori i Teknologjisë Informative dhe Logjistikë dhe Sektorit të Arkivit Komunal.

**I. Gjendja Civile**:

Në departamentin e Gjendjes Civile prej datës 01.01.2021-31.12.2021 janë lëshuar këto dokumente:

1.Ekstrakte të lindjes – **30302** copë
2.Certifikata të lindjes- **10655** copë
3. Certifikata të martesës- **6499** copë
4. Certifikata të vdekjes- **2278** copë
5. Certifikata të vendbanimit**- 855** copë
6. Certifikata të bashkësisë familjare- **4236** copë
7. Certifikata të gjendjes martesore- **1763** copë
8. Certifikata të shtetësisë- **258**copë
9.Vërtetim nga arkiva- **575** copë
10. Regjistrime të mëvonshme të lindjes- **26** aktvendime
11. Regjistrime të mëvonshme të vdekjes-**76** aktvendime
12. Kërkesa për ndërrim të emrit dhe mbiemrit- **28** aktvendime
13. Kërkesa për korrigjim të emrit dhe mbiemrit- **90** aktvendime
14. Kërkesa për korrigjimin e të dhënave- **16** aktvendime
15. Kërkesa për plotësimin e të dhënave të prindërve- **20** aktvendime
16. Kërkesa për anulimin e regjistrimeve të dyfishta- **12** aktvendime
17. Kërkesa për humbje të shtetësisë- 94 aktvendime
18. Kërkesa për fitim të shtetësisë- 15 aktvendime
Gjithashtu gjatë vitit 2021 përmes e-kioskut janë nxjerr **2142** certifikata.

**II. Zyra e Prokurimit**

**Gjatë periudhës 01.01.2021 deri më 31.12.2021 në Zyrën e Prokurimit Publik janë bërë kërkesa për blerje dhe zhvillim të procedurave të prokurimit nga të cilat**:

1. Administrata komunale janë 131 procedura
2. Institucionet arsimore dhe
3. Institucionet shëndetësore

a. Nga këto kërkesa kjo Zyrë ka zhvilluar **131 procedura**, prej tyre për:
   1. Vlera minimale 24
   2. Kuotime të çmimeve 36

3. Punë shtesë 04
4. Procedura të hapura 63
5. Procedure me Negociata 02
6. Minitender 02

b. Janë nënshkruar **126 kontrata**, prej tyre për:
   1. Vlera minimale 24
   2. Vlera të vogla 33, dhe
   3. Vlera të mesme ose të mëdha 69

d) Ri-tenderime (19) të njoftimeve për kontratë

**III. Qendra për Shërbime të Qytetarëve –QSHQ**:

Qendra për Shërbim të Qytetarëve gjatë periudhës 01/01/2021-31/12/2021 ka regjistruar gjithsej 30 489 lëndë të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese, siç janë:

| | |
|---|---|
| Janar: | 2 263 lëndë të ndryshme; |
| Shkurt: | 2 512 lëndë; |
| Mars: | 2 275 lëndë; |
| Prill: | 1 820 lëndë; |
| Maj: | 1 944 lëndë; |
| Qershor: | 2 878lëndë; |
| Korrik: | 2 901 lëndë; |
| Gusht: | 3 172 lëndë; |
| Shtator: | 3 353 lëndë; |
| Tetor: | 2 506 lëndë; |
| Nëntor: | 2 429 lëndë, dhe |
| Dhjetor: | 2 436 lëndë. |

Qendra për Shërbim të Qytetarëve përmes sistemit elektronik ka ofruar të gjitha shërbimet për qytetarët, ka pranuar dhe regjistruar të gjitha lëndët që u janë drejtuar organeve komunale. Në këtë sektor është dhënë prioritet në ofrimin e sa më shumë shërbimeve digjitale, duke krijuar mundësinë që qytetarët fare të mos frekuentojnë fizikisht në zyrat e komunës.

Bazuar në rregullat ligjore dhe politikat për TI-në dhe gjithnjë në koordinim me nivelin qendror si dhe institucionin përgjegjëse për e-Qeverisje, QSHQ ka kryer këto funksione: Ka kontaktuar drejtpërdrejt me qytetarët, ka pranuar dhe regjistruar kërkesat dhe ankesat nga qytetarët. Ka përcjellë kërkesat tek drejtoritë përkatëse për shqyrtim dhe vendimmarrje dhe ka kthyer përgjigje përmes QSHQ-ve ose në mënyrë elektronike, me synim eliminimin e qarkullimit të kopjeve fizike. Ka ofruar ndihmë juridike administrative, ka njoftuar qytetarët për ecurinë e kërkesave të tyre brenda afatit ligjor, ka kryer transaksione të tjera në pajtim me kompetencat e komunës. Është përdor libri unik i Protokollit në të gjithë komunën, duke përfshirë edhe kërkesat për gjendjen civile, si dhe zyrat e vendit. Funksionalizimi i Fletë Kërkesave dhe i Librit Unik të Arkës, duke përdorur sistemin e

integruar të Arkës gjenerohen të gjitha llojet e faturave për pagesa në institucionet e komunës edhe pagesat me UNIREFA për pagesa bankare, bëhen në QSHQ.

**IV. Shërbimet e Kuvendit të Komunës**

Kuvendi i Komunës gjatë periudhës njëvjeçare ka mbajtur gjithsejt 15 mbledhje si vijon:

- 11(njëmbëdhjetë) mbledhje të rregullta,
- 1 (një) mbledhje inauguruese dhe
- 3 (tri) mbledhje solemne.

Për 11 mbledhje të rregullta të organizuara të Kuvendit janë shqyrtuar: 89 (tetëdhjetë e nëntë) pika të rendit të ditës, 9 (nëntë) pika në mbledhjen solemne dhe 7 (shtatë) pika të rendit të ditës në mbledhje inauguruese.

Kuvendi i Komunës së Drenasit ka miratuar gjithsej **47 akte** ( **46** Vendime dhe **1** Statut).

**V. Sektori i Përgjithshëm**

**Zyra e Teknologjisë Informative:** Avancimi dhe modernizimi i shërbimeve digjitale komunale është prioritet. Duke përdorur shërbimet digjitale, qytetarëve u është lehtësuar marrja e shërbimeve në komunë. Tani qytetari duke përdorur platformën e re te ueb faqes, i mundësohet informimi me rrjedhjen e zgjidhjes së kërkesës së tij drejtuar organeve komunale. Implementimin e proceseve të e-shërbimeve dhe aplikacioneve në komunë si: (Intraneti, Ueb-faqja, SMAED-i, SIMBNJ-a, SVMP-ja, e-Arkiva, e-Pasuria, GJC, Arka, etj.) ka lehtësuar punën për zyrtarë dhe shërbime më të lehta dhe më të shpejta për qytetar. Është mbështetur dhe trajnuar stafi për përdorimin e aplikacioneve dhe platformave digjitale. Është menaxhuar me rrjetin shtetërorë ne institucionet komunale, sistemin e TI-ve, dhe proceseve te qeverisjes elektronike ne administratën e komunës. Kemi siguruar te gjitha te dhënat qe ruhen në serverët e komunës dhe DATA Qendër. Kemi menaxhuar, mirëmbajtur dhe krijuar llogarit zyrtare për zyrtar dhe këshilltar komuna. Të gjitha pajisjet zyrtare janë domain. Me implementimin e aplikacioneve të E-Qeverisjes, komuna jonë monitorohet online nga MPL, si mbledhjet e kuvendit, performancën, aplikacioni i Intranetit dhe modulin e lejeve të ndërtimit. Qytetarët mund të marrin shërbimet e Gjendjes Civile në 24 orë/7ditë duke përdorur e-Kioskën, këto shërbime mund ti marrin edhe nga distanca duke përdorur ueb faqen e komunës. Tani komuna ka dy e-Kioska për marrjen e shërbimeve te Gjendjes Civile ne Drenas dhe Komoran. Është mirëmbajtur sistemi i telefonisë VoIP është aktiv numri i telefonit për thirrje pa pagesë për qytetaret ne tel: 080013050. Pjesëmarrje në grupet punuese në ndërtimin dhe avancimin e aplikacioneve si: Intarnet, ueb faqe, Implementimi i Strategjisë së E-Qeverisja 2020-2025. Mbështetje e stafit në përdorimin e sistemeve dhe pajisjeve të TI-së, duke realizuar kërkesat ne fushën e TI-ve për përkrahje.

Nga **Zyrtari për Pranim të Mallit-Depoist dhe Logjistikë** gjatë periudhës njëvjeçare janë kryer këto punë:

Pranimi, evidentimi i të gjitha kërkesave nga drejtoritë komunale, për pagesën e faturave sipas kontratave të lidhura nga zyra e Prokurimit për punët, furnizimet dhe shërbimet e kryera dhe të pranuara nga Njësitë kërkuese; nga **FreeBalance -Moduli i Blerjes** janë nxjerrë gjithsej **912 raporte**

**të GRNS**, në çdo raport është bërë përshkrimi në bazë të punëve të pranuara në teren nga menaxherët e projekteve, organeve mbikëqyrëse si dhe komisioneve për pranimin teknik të punëve, shërbimeve dhe furnizimeve. Për të gjitha projektet janë marrë nënshkrimet nga zyrtarët autorizues të Njësive Kërkuese; **Shkarkimi i inventarit** nga zyrtarët e Komunës, të cilët kanë dalë në pension dhe shkarkimi i inventarit jashtë përdorimit i cili është dorëzuar në depo, gjithsej **63 asete; Ngarkimi** me inventar të përdorur gjithsej **281 asete**; **Ngarkimi** me inventar të ri gjatë vitit 2021 në sistemin e E-Depos është gjithsej **157 asete**; Artikuj të ndryshëm të regjistruar në sistemin e E-depos janë gjithsej **401 artikuj**, në vlerë prej **67.779.00 €; Donacion** është **1 (një artikull**- tablet-samsung nga Giz); **Transfere** kanë qenë gjithsej **28** artikuj; Është mbajtur evidenca e regjistrimit të faturave të regjistruara në Excel në E-pasuri, gjithashtu edhe në fletoren e punës; Të gjithë zyrtarët janë ngarkuar me mallin e porositur nga Njësitë Kërkuese dhe janë nënshkruar në fletë ngarkimin e mallit si dhe të gjitha pagesat të cilat kanë shkuar për certifikim janë skanuar dhe regjistruar për ç'do secilën pagesë veç e veç sipas drejtorive; Regjistrimi i inventarit të Komunës së Drenasit nga librat e punuara nga komisioni për regjistrimin dhe vlerësimin e inventarit të komunës për vitin 2021 në regjistrin e Excel-it në bazë të ditarëve të punuar; Azhurimi i raportit për regjistrimin e inventarit të Komunës, nga komisioni i caktuar për verifikimin e zyrtarëve të cilët nuk janë më pjesë e stafit të komunës.

**Mbikëqyrësi i autoparkut** është përkujdesur për mirëmbajtjen e veturave të Komunës që të jenë të pastërta brenda dhe jashtë, ka kryer të gjitha kontrollet e nevojshme të sigurisë, servisimit rutinor dhe regjistrimit të veturave zyrtare. Përdorimi i veturave për pune zyrtare është respektuar sipas rekomandimeve, për përdorim zyrtar të veturave sipas kërkesave të pranuara me postë elektronike. **Shpërndarësi i postës** ka kryer detyrat sipas nevojës dhe kërkesave të shërbimeve. Çdoherë shkresat janë përcjell me kohë dhe saktësi, ku gjatë kësaj periudhe ka shpërndarë mbi 2500 shkresa të ndryshme (vendime, ftesa, kërkesa, ankesa etj) nëpër të gjitha fshatrat e komunës së Drenasit dhe jashtë saj. Shërbimet në mirëmbajtjen e objektit dhe inventarit nga ana e zyrtarit përgjegjës janë kryer sipas kërkesave për intervenim. Përkujdesa për mirëmbajtjen e sistemit energjetik në objektin komunale ka qenë në nivel, problemet te cilat janë paraqitur në kohë janë eliminuar nga punëtori i autorizuar. Punëtoret e shërbimeve kanë kryer pune dhe detyrat tjera sipas kërkesave nga ana e zyrtarëve.

**Recepsionisti** ka vazhduar me udhëzimin e palëve në të gjitha Drejtoritë/Zyrat komunale ku janë pajisur me kartela të vizitorëve. Gjatë kësaj periudhe kanë qenë rreth **4341 qytetarë** që kanë kërkuar shërbime në drejtorit komunale vetëm në katin II, të cilët janë pajisur me kartela të vizitorëve dhe janë regjistruar në evidencë. Zyrtari përgjegjës ka udhëzuar palët sipas nevojës gjatë orarit zyrtar, ka dhënë informacione palëve lidhur me kontaktet me zyrtarët, ka evidentuar parregullsitë që vërehen në hyrje-dalje të portës.

### VI. Sektori i Arkivit Komunal

Numri i lëndëve të arkivuara në mënyrë fizike për të gjitha programet për vitin 2021 është 4699 dhe krahasuar me vitin 2020 kemi të arkivuara 400 lëndë më shumë. Ndërsa numri i lëndëve të arkivuara në mënyrë elektronike për të gjitha programet për vitin 2021 është 30136, i përafërt me

vitet e kaluara. Në vazhdim po e paraqesim në mënyrë tabelare numrin e lëndëve që janë kthyer për arkivim në mënyrë fizike sipas Programeve dhe Drejtorive.

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1. | Zyra e Kryetarit të Komunës | 379 | Lëndë |
| 2. | Drejtoria Administratës së Përgjithshme | 896 | Lëndë |
| 3. | Drejtoria për Buxhet dhe Financa | 41 | Lëndë |
| 4. | Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural | 401 | Lëndë |
| 5. | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | 40 | Lëndë |
| 6. | Drejtoria i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale | 196 | Lëndë |
| 7. | Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë | 00 | Lëndë |
| 8. | Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | 69 | Lëndë |
| 9. | Drejtoria për Arsim | 00 | Lëndë |
| 10. | Drejtoria për Kulture, Rrini dhe Sport | 00 | Lëndë |
| 11. | Drejtoria i Inspektimit Komunal | 2.507 | Lëndë |
| 12. | Zyra e Kuvendit | 170 | Lëndë |
| 13. | Drejtoria për Shërbime publike dhe Emergjencë | 00 | Lëndë |
| 14. | Zyra për Komunitete dhe Kthim | 00 | Lëndë |
| 15. | Drejtoria për Infrastrukturë Lokale | 00 | Lëndë |

## 3.2.DREJTORIA E ARSIMIT

Raporti i punës së Drejtorisë për Arsim (DKA) paraqitur kryetarit të komunës përfshinë periudhën prej muajit Janar-Dhjetor - 2021. Të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e këtij Drejtorati janë realizuar gjatë kësaj periudhe më përkushtim dhe më përgjegjësi të plotë. Me prezantimin e këtij raporti do të jeni më afër të informuar sidomos në aspektin zyrtar për punën, organizimin dhe zhvillimin transparent të politikave arsimore në Drenas. Procesi arsimor gjatë kësaj periudhe ka qenë vazhdimisht i përcjellë me kujdes nga Departamenti jonë, ku të gjitha institucionet arsimore janë vizituar disa herë, si nga ana e Drejtorit, ashtu edhe nga zyrtarët e arsimit. Në fund të çdo muaji kemi realizuar mbledhje të rregullta me drejtorë të institucioneve shkollore. Janë mbajtur takime të rregullta( me prani fizike dhe virtuale) në MASHTI, gjithashtu janë organizuar edhe trajnime me prani fizike apo online, ku çdo detyrë dhe politik arsimore dhënë nga ana e tyre është realizuar me sukses nga ana jonë. Përkundër pandemisë shumica e shkollave në komunën e Drenasit kanë punuar sipas skenarit A ( me prezencë fizike në shkollë ) —Në bazë të numrit të rasteve me covid nga ana e mësimdhënësve shkollat kanë kaluar në mësim online sipas planit B për përudhën dy javore ( MASHTI)

**STRUKTURA ORGANIZATIVE -** Këtë sektor e përbejnë 11 punëtor: Drejtori, një zyrtar për personel dhe administratë, një zyrtar për arsim, një pedagog, një psikolog, një zyrtar për financa, një zyrtar për prokurim, një punëtor për lista të pagave dhe arkivim, një zotues, një depoist. Drenasi ka një Institucion parashkollor publik me një paralele të ndarë fizike, 30 shkolla fillore dhe të mesme të ultë me 2 paralele të ndara fizike, dy shkolla të mesme, gjithsejtë 33 institucione arsimore publike. Ku punojnë gjithsejtë 957 punëtor dhe ndjekin mësimin e rregullt 11242 nxënës. 54 punëtor administrativ, 766 mësimdhënës, 131 punëtor teknik. Institucioni Parashkollor Publik

"Ardhmëria" ka gjithsejtë 137 fëmijë, klasa përgatitore 796 fëmijë, shkollat fillore dhe e mesme e ulët prej ( I - IX ) ka gjithsejtë 7338 nxënës, SHML Gjimnazi "Gj.K.Skënderbeu" ka gjithsejtë 956 nxënës dhe ShMP "Fehmi Lladrovci" ka gjithsejtë 1421 nxënës.

**AKTIVITETET DHE DETYRAT E PUNËS -** Janë realizuar me sukses mbledhje të rregullta me drejtorë të Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Drenas, i është dhënë përkrahje e vazhdueshme e shkollave për përmirësimin dhe ngritjen e kapaciteteve te performancës dhe ngritjen e cilësisë me bazë në shkollë. DKA -Drenas në Qershor 2021 ka shtrirë projektin për Vlerësimin e brendshëm të shkollave, duke i përfshirë të gjitha shkollat në vlerësimin e brendshëm të shkollës duke i mbështet dhe financuar trajnerët si ekip profesionale në ngritjen dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Komuna Drenasit tanimë e kanë të përfunduar vlerësimin e brendshëm të shkollave me vlerësimin e 5 (pesë ) fushave të cilësisë. Ekipi profesional për implementimin e KKK-së, për hartimin planifikimeve vjetore komunale për nivelin arsimorë 0-1. Me vendim të DKA-së janë organizuar takime informues trajnerët dhe mësimdhënësit lidhur me hartimin e plan-programeve mësimore për nivelin komunal. Diskutim lidhur me identifikimin, ndarjen e përvojave dhe praktikave të mira për zbatimin dhe realizimin e plan-programeve si dhe realizimin e tyre. Certifikimi i mësimdhënësve (sipas kritereve ) që kanë zbatuar për herë të parë kurrikulën për vitin shkollor 2020/2021. Hartimi i Planit Operacional për trajnimin për mësimdhënësit e klasës përgatitore dhe nivelin arsimor fillor për 5 modulet e trajnimet sipas projektit "Ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve në arsimin fillor ". Duke e parë rendësin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve në ngritjen e cilësisë në arsim, DKA-ja ka shtrirë projektin "Qasja praktike për zbatim të kurrikulës 0-5 dhe monitorimi me bazë në shkollë duke përfshirë në këtë fazë 8 shkolla me gjithsej 74 mësimdhënës si dhe certifikimin e tyre. Materialet dhe udhëzuesit e përgatitur nga "Projekti zhvillimi profesional i mësimdhënësve". Shtrirja e projektit për trajnimin e mësimdhënësve për ngritjen e vazhdueshme profesionale , është mbështetur, koordinuar nga DKA-ja, dhe ekipi i trajnerëve për ngritje profesionale me vendim të DKA-së. Është planifikuar dhe realizuar mbajtja e garave t matematikes, fizikes, ku nxënësit fitues ne nivel komunal kane marre pjese ne nivel nacional, gjithashtu është planifikuar dhe është mbajt testit të arritëshmerisë dhe të maturës, ku organizimi është vlerësuar jashtëzakonisht mirë nga administruesit e testit në nivel MAShTI. Paraqitja e pandemisë COVID- 19, ka paraqitur vështirësi dhe sfida të mëdha duke rezultuar në humbjen e orëve mësimore në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Andaj, nga 07.05.2021 është konstatuar se organizimi i mësimit plotësues është parë një prej mundësive që do të lehtësonte humbjen e mësimit, përshpejtimin e të nxënit, dhe përmirësimin e rezultateve në të nxënit . Në vijim paraqesim të dhënat për nxënësit nga Komuna Drenasit që kanë mbajtur mësimin plotësues në këto fusha kurrikulare.

| Fushat Kurrikulare | Nr i nxënësve | Numri i orëve të realizuara | Përqindja |
|---|---|---|---|
| Gjuhë dhe Komunikim | 4146 | 1347 | 38.68% |
| Matematikë | 4403 | 1335 | 41.08% |
| Biologji | 1920 | 949 | 17.93 |
| Fizikë | 2062 | 493 | 19.24 |
| Kimi | 2240 | 459 | 20.90% |

Është kërkuar respektimi në përpikëri i ligjeve dhe Udhëzimeve të reja Administrative të nxjerra nga MASHT-i. Janë realizuar takime me prindër, është zgjedhe këshilli i prindërve në nivelin komunal. Gjatë kësaj periudhe është monitoruar mbarëvajtja e procesit edukativ arsimor. DKA-ja edhe gjate pandemisë ka realizuar takime të rregullta dhe virtuale te vazhdueshme me nivelin qendrorë dhe ka monitoruar nga afër mbarëvajtjen e procesit mësimor. Kemi pranuar raporte të rregullta në baza ditore nga të gjithë drejtoret e shkollave. Interesimi dhe angazhimi i të gjithë akterëve ( personelit arsimor, prindërve, nxënësve, stafit mbështetës etj.) ka qene ne nivel ashtu siç është kërkuar në këto rrethana. Si DKA ju kemi bëre të qarte të gjithëve detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin e mësimit me prezencë fizike dhe në distance konformë udhëzimeve te pranuara nga MASHTI. Të gjithë mësimdhënësit i kane formuar grupet e komunikimit dhe kanë qene ne kontakt te vazhdueshëm me prindërit dhe nxënësit duke e përcjellë angazhimin e nxënësve dhe kryerjen e detyrave. DKA ka përfshirë 65 FAMNV në arsimin gjithëpërfshirës në të gjitha institucionet arsimore në nivelet 0,1,2 dhe 3,duke ju ofruar mbështetjen profesionale në edukim, arsimim. Janë zbatuar politikat arsimore në bazë të kapaciteteve të lejuara administrative me sistemimin e pesë (5) mësimdhënësve mbështetës dhe katër (4) asistentëve mbështetës, me qëllim të ngritjes së arritjeve të tyre në procesin edukativ arsimor. Integrimi dhe mbështetja e FAMNV bazohet në U.A. Nr. 16/2017, rregulloren e punës dhe planit zhvillimor të koordinatorit për arsim gjithëpërfshirës, ndërsa shkalla e vlerësimit të FAMNV bëhet nga ekipi komunal për vlerësim. Hartimi i planit PIA bëhet me akteret: edukator/e, mësimdhënës, asistent, prind për secilin fëmijë/ nxënës për fushën që e ka pengesën në zhvillimin e tyre, i cili plan ndihmon në produktivitetin e tij/saj për arritjet në procesin edukativ mësimor dhe ngritje në përformacën jetësore. Rastet e referuara nga prindërit, edukatoret, mësimdhënësit dhe drejtoret e shkollave për nxënësit me sjellje jo të mira sociale në procesin edukativ arsimor janë trajtuar në mënyrë profesionale duke bashkëpunuar edhe me institucionet e shtetit si: Gjykatën, Policin, QPS, Shërbimin Sprovues-i cili me vendim të Prokurorit vendos për Masën e Diversitetit si Këshillim Psikologjik profesionale, po ashtu edhe me referenca të organeve të sigurisë për kujdesin dhe përmirësimin e sjelljeve devijante të miturve në institucione arsimore, në disa raste edhe në përmirësimin e raporteve mësues-nxënës-prind-shkollë dhe anasjelltas.

Sa i përket menaxhimit me personel dhe administrate në vitin 2021 janë realizuar aktivitetet në vijim:

Konkurse ------------------------------------------------------- 22
Rishpallje të konkursit ------------------------------------------ 12
Shpallje të rezultateve të konkurseve------------------------- 34
Vendime të komisioneve intervistuese ---------------------- 37
Vendime për transferim --------------------------------------- 5
Vendime të lehonisë ------------------------------------------ 30
Aktvendime për pensionim ---------------------------------- 19
Aktvendime për ndërprerje të marrëdhënies së punës------ 7
Aktvendime te pushimeve pa pagesë------------------------ 12
Vendim te ndryshme ------------------------------------------ 120
Aktvendime të ndryshme ------------------------------------- 361
Njoftime të ndryshme ----------------------------------------- 64
Njoftime për ushqim ------------------------------------------ 145
Njoftim për udhëtim ------------------------------------------ 107
Njoftime për gradime shtesë --------------------------------- 467

Hartimin e konfirmimeve për borxhe ------------------------ 77
Hartimin e pëlqimeve të ndryshme -------------------------- 38
Hartimin e kërkesave të ndryshme---------------------------- 12
Hartimin e ankesave të ndryshme ---------------------------- 39
Përgjigjeje në padi-------------------------------------- 35

Në kuadër të menaxhimit me personel kemi bashkëpunuar më përfaqësues të Avokaturës Shtetërore, Inspektor të MAShTI-të, Inspektorin e Punës në Drenas, Inspektor në MPMS-Prishtinë. Kemi kalkuluar koston e shpenzimeve që burojnë nga kontrata kolektive dhe të njëjtën e kemi përcjell në Ministrinë e Arsimit dhe të Financave

**DONACIONET -** Edhe në këtë periudhë nuk kanë munguar donacionet: Nga MASHT ka vazhduar ndërtimi i palestrës sportive në Poklek. Nga MZHE është siguruar renovimi i SHFMU "Dëshmorët e Drenicës" në Vërboc. Janë implementuar granatet nga Banka Botërore në 3 shkolla: SHFMU ''Ali Gashi'' – Drenas, SHFMU '' 24 Korriku'' në Fushticë, SHFMU '' Arif Shala'' në Korroticë të Ulet. Nga MAPL janë edhe ndërtimi i dy shkollave: SHMP në Komoran dhe SHFMU në Fushticë të Epërme, ku është duke vazhduar ndërtimi i tyre në fazat e punimeve të vrazhda. Nga Caritasi Zviceran janë pajisur 5 klase para fillore me inventar dhe janë trajnuar 46 edukatore.

**INVESTIMET KAPITALE** Gjatë këtij viti kalendarik në drejtorin e arsimit kanë qenë të planifikuara 8 projekte kapitale këtu janë përfshirë disa projekte mirëpo janë grupuar në mënyrë që të realizojmë më pak shpallje, nga këto projekte 6 kane qenë me burimin e fondeve grante qeveritare (10), dhe 2 kane qenë nga të hyrat vetanake si dhe 2 me kombinimin e të dy burimeve të fondeve (10 dhe 21).

Gjatë këtij viti kalendarik në drejtorin e arsimit janë realizuar këto projekte kapitale:

1. **Inventarizimi i shkollave ne Drenas në vlerë 40,000€, GQ**

Nga ky projekt në vlerë **10,165 €,** janë shpërndarë 50 tavolina, 200 karrika dhe 490m$^2$ dysheme gome, nëpër klasat e para filloreve në disa shkolla që janë përzgjedhur nga një komision.

2. **Ndërtimi i pllatove për rreshtimin e nxënësve dhe trotuareve me kubëza në vlerë** 45,000€, GQ

Ky projekt është realizuar në tri faza.

**Në fazën e I-rë në vlerë 34,967.00€,** janë ndërtuar pllato me kubëza, ulëse druri për tre 23lluqev dhe shporta për hedhurina në shkollat: "Jusuf Gervalla" në Negroc, "Halil Bajraktari" në Drenas, "Arif Shala" Korroticë e Poshtme, "Ali Gashi" Çikatovë e Re, "24-Korriku" Fushticë e Poshtme dhe në shkollën "Rasim Kiqina"-Drenas.

**Në fazën e II-të në vlerë 8,699.00€,** është ndërtuar parkingu, trotuari dhe pllatoja me kubëza, ulëse druri për tre 23 lluqeve dhe shporta për hedhurina në shkolla "Fazli Grajqevci" në Vasilevë

**Në fazën e III-të, në vlerë 1,324.20€,** është ndërtuar trotuari me kubëza në shkolla "Shaban Polluzha" në Polluzhë.

3. **Furnizimi i shkollave me pajisje te TIK-ut në vlerë 50,000€, GQ**

Ky projekt nuk është realizuar.

DKA ka hartuar specifikimet teknike për këtë projekt dhe janë iniciuar procedurat e tenderimit, është përzgjedhur oferta fituese, por ndaj kësaj përzgjedhje është paraqitur ankesë në OSHP. OSHP nuk ka shqyrtuar ankesën ende pasi që nuk ka qen funksional, përkatësisht nuk ka pasur të kompletuar numrin e anëtarëve nga kuvendi i Kosovës.

4. **Furnizimi i shkollave me kabinet për Kimi, Fizikë dhe Biologji në vlerë 60,000€**

Ky projekt i financuar nga grandi qeveritar nuk është realizuar.

DKA ka hartuar specifikimet teknike për këtë projekt dhe janë iniciuar procedurat e tenderimit, është përzgjedhur oferta fituese, por ndaj kësaj përzgjedhje është paraqitur ankesë në OSHP. OSHP nuk ka shqyrtuar ankesën ende pasi që nuk ka qen funksional, përkatësisht nuk ka pasur të kompletuar numrin e anëtarëve nga kuvendi i Kosovës.

5. **Renovimi i objekteve shkollore (kulm, dysheme dhe ndërrimi i dyerve dhe dritareve), në vlerë 70,000.00€ (prej të cilave 5,340€ financuar nga Grandi qeveritar).**

Për fazën e parë të këtij projekti është lidhur kontratë në vlerë 55,000.00€. Inicimi i fazës së dytë për shumën e mbetur prej 15,000€, nuk ka pasur mundësi të iniciohet, pasi që faza parë ka përfunduar shumë vonë me 25.10.2021. Sipas kontratës së lidhur janë realizuar 82% e punëve të parapara, përkatësisht janë kryer punime në vlerë 45,102.48€. Punimet e mbetura, do të përfundojnë në pjesën e parë të vitit 2022, pasi që burimi i financimit është nga të hyrat vetanake të komunës.

Nga ky projekt janë realizuar këto punime:

**Çerdhja "Ali Gashi" në Çikatovë të Re**. Në këtë objekt është punuar ngrohja qendrore nën dysheme, është vendosur sistemi i klimatizimit dhe ngrohjes në çdo dhomë të Çerdhes, është ndërruar nivelizimi dhe dyshemeja me llaminat e komplet objektit. Janë veshur muret e kuzhinës me pllaka, janë ndërruar dyert e hyrjes dhe dritaret që kanë qenë të dëmtuara, si dhe është ndrruar ulluku i kulmit që ka qenë i dëmtuar.

**Gjimnazi "GJ.K. Skënderbeu**" – janë ndërruar të gjitha dritaret e katit të tretë (16cope), janë ndërruar 23 dyerë dhe 24 dritarë në 16 nyje sanitare, tavanet e 8 nyjeve sanitare janë punuar me pllaka amstrongu, ndërsa 8 tjera janë suvatuar me fasadë, është ndërruar ndriçimi në nyje sanitare, janë rregulluar ventilatorët, pastaj është bërë bashkimi dhe ndarja e re e kabineteve të informatikës, si dhe është bërë riparimi i pjesshëm i mbulesës së objektit të gjimnazit.

**Shkolla "Azem Bjeta" në Shtuticë**- është bërë ndërrimi i 24lluqeve te mbulesës dhe mbështjellja e strehës me llamarinë.

**Në shkollën e Gllanasellës** është bërë ndrrimi i dy dritareve, dy dyerve, shtrimi i dyshemesë së **korridorit në linelium, është bërë ndërrimi i ndriçimit me led, si dhe është bërë ndërrimi i një pjesë** të ulluqeve të mbulesës

**Në shkollën "Gani Syla"-** është punuar me linelium dyshemeja e në disa klasë, është punuar me pllaka qeramike korridori dhe salla e bodrumit, si dhe është ndërruar dera e sallës së bodrumit.

**Në shkollën e "Arif Shala" në Zabel të Ulët**- janë punuar dyert e hyrjes së shkollës.

**Në shkollën "Xheladin Gashi**" është punuar izolimi i kulmit në pjesën e dy palë nyjeve sanitare.

**Në shkollën e Nekocit**, është riparuar një pjesë e mbulesës dhe ulluqeve, si dhe terasa para hyrjes së shkollën dhe para klasës së parashkolloreve është punuar me pllaka.

**Në shkollën e Negocit** –janë veshur me granit shkallët e shkollës.

**Në shkollën e Vasilevës** janë punuar me linielium dyshemet e 6 klasë dhe janë ndërruar ulluqet e mbulesës së shkollës.

Në shkollën e Fushticës së Poshtme janë ndërruar ulluqet e mbulesës së shkollës dhe është punuar me pllaka terasa në hyrje të shkollës.

**Në shkollën "Halil Bajraktari**" janë ndërruar disa dyer të banjove dhe ndriçimi i shkollës.

6. **Ngjyrosja dhe suvatimi i objekteve shkollore në vlerë 50,000.00€, GQ**

Ky projekt është realizuar në tri faza

**Faza I-rë në vlerë 18,666.00€** - në këtë fazë janë ngjyrosur me polikolor këto objekte shkollore: Gjimnazi, shkolla profesionale "Fehmi Lladrovci", shkolla e Negrocit, shkolla e Gllanasellës, Çerdhja në Komoran, shkollën në Likoshan dhe shkollën "Gani Syla".

**Faza II-të në vlerë 15,310.00€, prej kësaj faze janë realizuar vetëm 11,023.28€**. Për shkak të tejkalimit të planit dinamik është rekomanduar shkëputja e kësaj kontrate. Në këtë fazë janë ngjyrosur këto objekte shkollore: shkolla e Baicës, shkolla "Ali Gashi" në Qikatovë, një pjesë e çerdhes në Drenas, shkolla e Abrisë së Epërme, shkolla "Abedin Bujupi" në Arllat, shkolla në Bytyq një pjesë është suvatuar dhe ngjyrosur dhe suvatimi i shkollës në Kishnarekë.

**Faza I-rë në vlerë 13,150.00€** -në këtë fazë janë suvatuar shkolla e Vasilevës, shkolla e Gradicës, korridori i shkollës së Nekocit, tri klasë të shkollës së Kishnarekës dhe qerdhja "Ali Gashi", si dhe janë suvatuar dhe ngjyrosë shkolla e Fshticës së Poshtmë, kati i parë i shkollës në Zabel të Ulët dhe disa salla dhe kabinete në Gjimnaz.

7. **Riparimi i nxemjeve qendrore(radiator dhe paisje tjera percjellse në vlerë 15,000.00€**

Për këtë projekt është lidhur kontratë kornizë 2 vjeçare. Sipas kësaj kontrate janë ndërruar 30 radiator në shkollën "Gani Syla", "Halil Bajraktari" dhe shkollën e Abrisë.

**BUXHETI I APROVUAR DHE REALIZIMI, Grantet qeveritare fondi burimor 10**

**Tabela nr.1,Pagat,Mallra dhe Shërbime dhe Shpenzime komunale**

| Nr. | Drejtoritë | Buxheti i aprovuar 2021,Pagat | Buxheti i aprovuar 2021,Mallra dhe Shërbime | Buxheti i aprovuar 2021,Shpenzime komunale | | | Buxheti i aprovuar 2021,Pagat-Alokimet | Buxheti i aprovuar 2021,Mallra dhe Shërbime-Alokimet | Buxheti i aprovuar 2021,Shpenzime komunale-Alokimet | Buxheti i aprovuar 2021,Subvencionet-Alokimet | Kapitalet-Alokimet | Buxheti i aprovuar 2021,Pagat-Shpenzimet | Buxheti i aprovuar 2021,Mallra dhe Shërbime-Shpenzimet | Buxheti i aprovuar 2021,Shpenzime komunale-Shpenzimet | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Administrata e Arsimit | 76,212 | 315,266 | - | | | 90,850.37 | 297,655.00 | - | - | 335,000 | 90,850.00 | 297,655.00 | - | |
| 2 | Arsimi Parafillorë-QEAP"ARDHMËRIA" | 118,615 | 21,482 | 6,120 | - | - | 125,129.06 | 17,022.77 | 6,120 | - | | 125,129.00 | 17,022.77 | 2,966 | |
| 3 | ARSIMI FILLOR | 4,548,372.00 | 321,789 | 61,312 | - | - | 4,865,603.0 | 321,789.00 | 61,312.00 | - | - | 4,865,603.74 | 212,498.00 | 37,287 | |
| 4 | ARSIMI I MESËM | 1,290,482 | 95,507 | 21,125 | - | - | 1,280.886 | 95,507 | 21,125 | - | - | 1,280886 | 76,162.80 | 7,925 | |

**RAPORTI VJETOR I PUNËS, REALIZIMI I BUXHETIT VJETOR/2021**
**BUXHETI I APROVUAR DHE REALIZIMI, Të hyrat vetanake nga fondi burimor 22 dhe 21,SUBVENCIONET/Bursa për student dhe Mallra dhe Shërbime**

**Tabela nr.2,**

| **Nr.** | **Drejtoritë** | | **Buxheti i aprovuar 2018,2020Mallra dhe Shërbime** | **Buxheti i aprovuar 2021,Mallra dhe Shërbime** | **Buxheti i aprovuar 2020,Subvencionet** | **Buxheti i aprovuar 2021,Subvencionet** | | Buxheti i aprovuar 2018,2020,Mallra dhe Shërbime-**Shpenzimet** | Buxheti i aprovuar 2021,Mallra dhe Shërbime-**Shpenzimet** | | | | Buxheti i aprovuar 2022,Mallra dhe Shërbime-**Shpenzimet** | Buxheti i aprovuar 2022,Mallra dhe Shërbime-**Shpenzimet** | Buxheti i aprovuar 2021,Subvencionet-**Shpenzimet** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | **Administrata e Arsimit** | **-** | **-** | **-** | **4,350 .00** | **80,000.00** | | **4,000.00** | **80,000.00** | | | | | | **14,000** |
| **2** | **Arsimi Parafillorë-QEAP"ARDHMËRIA"** | **-** | **24,123** | **25,000** | | | | 24,123 | 16,364 | | | | 2,693 | 6,798 | - |
| **3** | **ARSIMI FILLOR** | **-** | | | | | | | | | | | | | |
| **4** | **ARSIMI I MESËM** | **-** | | | | | | | | | | | | | |

**RAPORTI GJASHTËMUJOR I I PUNËS, REALIZIMI I BUXHETIT GJASHTËMUJORI I PARË/2021**
**BUXHETI I APROVUAR DHE REALIZIMI,KAPITALET Grantet qeveritare fondi burimor 10,21,22**
**Tabela nr.3**

| Nr. | Administrata e Arsimit | | | Kapitalet Aprovimi Fondi 22,Grante | Kapitalet Aprovimi Fondi 21,Grante | Kapitalet Aprovimi Fondi 10,Grante | | | | | Kapitalet-Alokimet | | | | Kapitalet-Shpenzimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Renovimi i objekteve shkollore(Kulm, dysheme dhe ndërrimi i dyerve dhe dritareve | | | | | 5,340 | | | | | 5,340 | | | | 5,340 |
| 2 | Ngjyrosja dhe suvatimi i objekteve shkollore | | | | | 50,000 | | | | | 50,000 | | | | 50,000 |
| 3 | Ndërtimi i platove për rreshtimin e nxënësve dhe | | | | | 45,000 | | | | | 45,000 | | | | 44,989.5 |

| | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | trotuareve me kubëza | | | | | | | | | | | | | | |
| 4 | Inventarizimi i shkollave në Drenas | | | | | 40,000 | | | | | 40,000 | | | | 37,914 |
| 5 | Furnizimi i shkollave me pajisje të TI | | | | | 50,000 | | | | | 50,000 | | | | 49,804 |
| 6 | Furnizimi i shkollave me kabinete: kimi, fizikë dhe biologji | | | | | 60,000 | | | | | 60,000 | | | | 0.00 |
| 7 | Rrethojat e oborreve shkollore | | | 5,215 | | | | | | | 5,215 | | | | 0.00 |
| 8 | Renovimi i objekteve shkollore(Kulm, dysheme dhe ndërrimi i dyerve dhe dritareve | | | | 64,660 | | | | | | 64,660 | | | | 35,681.01 |
| 9 | Riparimi i nxemjeve qendrore | | | | 15,430 | | | | | | 15,430 | | | | 15,430.0 |

**BUXHETI I APROVUAR DHE REALIZIMI,PROJEKTET E Bankës Botërore, Financim nga Huamarrja, Fondi burimor 04,**

**Tabela nr.4,** **Bartje e mjeteve nga viti 2020 në vitin 2021**

| Nr. | Drejtoritë | | Buxheti i aprovuar 2021,Mallra dhe Shërbime, TRAJNIME | | | Kapitalet; FURNIZIM ME TI DHE PAJISJE TJERA;KABINETE ETJ. | Buxheti i alokuar 2021,Mallra dhe Shërbime, TRAJNIME | Mallra dhe Shërbime, Alokimet | | | Kapitalet-Alokimet | | | | Kapitalet-Shpenzimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 1.SHFMU"ALI GASHI",2.SHFMU"ARIF SHALA"DHE 3.SHFMU "24 KORRIKU" | | 9,460 | | | 6,586 | 9,460 | 9,460 | | | 6,586 | | | | 6,375 |

**KOMUNIKIMI ME MASHT-in -** Gjatë kësaj periudhe kemi realizuar takime të rregullta me MASHT-in, ku kemi dhënë kontributin tonë me nevojat dhe prioritet tona si DKA në sferën e arsimit. Në çdo mbledhje me drejtorë të drejtorive Komunale për Arsim janë paraqitur kërkesat tona dhe gjithashtu janë marruar detyra nga MASHT-i. Kemi dërguar disa kërkesa për përkrahje te cilat janë ne proces: Kërkesë për mbështetje te stafit mësimor-edukativ-arsimor me trajnime te akredituara sipas katalogut te trajnimeve nga MASHTI, kërkesë për përkrahje ne pako për laboratorë (fizike, kimi, biologji), kërkesa për renovime te tualeteve te shkollave, kërkesa për themelime të institucioneve parashkollore publike me qëndrim tërë ditor, kërkesa për furnizim me inventarë për klasat përgatitore etj.

**BASHKËPUNIMI ME BE-në** - Gjatë kësaj periudhe, kemi zhvilluar takime me përfaqësuesit e BE-së lidhur me donacionin "Ndërtimi e institucionit parashkollor publik për fëmijë me qëndrim tërë ditor. Punimet kane filluar dhe janë duke u zhvilluar në ndërtimin e objektit. Janë certifikuar shumica e mësimdhënëseve nga projekti i BE-së implementuar nga GIZ-i në bashkëpunim më Fakultetin e Edukimit, trajnimet e mësimdhënëseve kanë vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe. Kemi realizuar 6 konferenca ndërkombëtare krahas shkollave të Bashkimit Evropian me ekspert të ndryshëm të kurrikulave duke trajtuar tema që kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënje. Kemi realizuar 2 takime virtuale me drejtues te arsimit në Zvicër me qellim të shkëmbimit të përvojave ne fushën e arsimit.

**VËSHTIRËSITË –** Pandemia ka shkaktuar vështirësi të shumta në te gjitha dimensionet, obligimet financiare që dalin nga implementimi I kontratës kolektive ( kërkesa të medha per shujta, gradim dhe transport). Gjithashtu kemi kërkuar edhe trajnimin e zyrtarëve të administratës më qëllim të ngritjes kapaciteteve profesionale në sektorin përkatës. Stafi profesional na mungon në shumicën e shkollave (sekretar, pedagog, psikolog). Në shumicën e shkollave punët administrative, pedagogjike etj, i kryen drejtori i shkollës.

**PËRFUNDIM-** Jemi të vetëdijshëm për sfidat që kemi përpara vetës edhe në këtë vit. Mbesim të përkushtuar me angazhim maksimal që në Drenas të ngritët cilësia në arsim, të shtohet disiplina në punë dhe të këtë llogaridhënie në këtë drejtim. Për të krijuar kushte dhe mundësi të reja në rrethanat e reja shtetërore që sot e nesër të kemi shkolla efektive dhe funksionale në kuptimin e plotë të fjalës, vlen që te gjithë të angazhohemi për ta ngritur cilësinë në arsim. Për këtë kemi krijuar një komision i cili ka për detyra te skanoje gjendjen në teren dhe të nxjerr rekomandime në funksion të përmirësimit te cilësisë.

## 3.3.DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

| **Aktivitetet kryesore Janar-Dhjetor 2021** | **Arritjet/progresi/përformanca kyçe gjatë muajve ( janar-dhjetor/2021 )** |
|---|---|
| **Aktivitetet kulturore** | **Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka realizuar në tërësi plan-programin e vet të punës dhe për periudhën janar-dhjetor i ka kryer këto aktivitete:**<br><br>- Raporti vjetor i DKRS-së për vitin 2021<br>- Plani dhe programi i punës për vitin 2022<br>**Aktivitete në Sektorin e Kulturës:**<br>- Si DKRS në respektim të vendimeve të qeverisë dhe masave tjera mbrojtëse të rekomanduara nga OBSH dhe IKSHPK, për parandalim të përhapjes së pandemisë COVID-19, jemi obliguar të reduktojmë dhe mbajmë me masa kufizuese aktivitetet kulturore, sportive dhe rinore;<br>- Takim me Presidentin e Komitetit Olimpik të Kosovës dhe Koordinimi për bashkëpunimin e mëtutjeshëm në realizim të aktiviteteve të përbashkëta sportive;<br>- Pjesëmarrje në ekspozitën “Edhe unë mundem, më përkrahni” organizuar nga Handikos Drenas;<br>- Mbajtja e Festivalit të Tunxhit “Kosova Brass Fest” në Sallën e Kulturës më 04.02.2021.<br>- Manifestimin për 17 shkurtin-Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, filloi duke bërë homazhe tek shtatoret e heronjve në sheshin “Fehmi Lladrovci”, në kompleksi memorial në Marinë dhe tek të gjitha vend varrezat e dëshmorëve në komunën e Drenasit,<br>- Janë bërë homazhe për dëshmorët dhe heronjtë tanë duke vendosur kurora lule pranë vendvarrezave në përvjetorët e tyre;<br>- Është shënuar 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas;<br>- Është shënuar me akademi 40 Vjetori i demonstratave të 2 prillit të vitit 1981;<br>- Është shënuar aktiviteti kulturor i Sofrës Poetike “Ymer Elshani” 2021 në formatin virtual për shkak të masave mbrojtëse ndaj pandemisë Covid-19;<br>- Në bashkëpunim me DKA-në kemi shënuar Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve-1 Qershorin, ku si DKRS kemi realizuar aktivitetin e ngjyrosjes me të gjithë fëmijët e Çerdhes “Ardhmëria”;<br>- Me rastin e shënimit të 21 Vjetorit të Ditës së Çlirimit, qyteti ynë u dekorua me flamuj dhe bilborda me mbishkrim me 11.06.2020 ndërsa me 14.06.2020 u mbajt Seancë Solemne e Kuvendit Komunal për të vazhduar me homazhe te shtatoret e heronjve në sheshin “Fehmi Lladrovci”, Komplekset Memoriale në Prekaz dhe Marinë si dhe homazhe tek të gjitha vendvarrezat e dëshmorëve në komunën tonë (për shkak të situatës pandemike nuk është mbajtur ndonjë aktivitet tjetër festiv); |

- Është përuruar shtatorja e Heroit Dr. Hafir Shala në oborrin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Drenas;
- Është shënuar 22 vjetori i Ditës së Çlirimit të komunës së Drenasit, me ç' rast janë bërë homazhe tek shtatoret e heronjve në sheshin "Fehmi Lladrovci", në Kompleksin Memorial në Marinë dhe tek të gjitha vendvarrezat e dëshmorëve në komunën tonë;
- Me kërkesa të DKRS-ës dhe bashkëpunim me autor librash kemi arritur të pasurojmë fondin e bibliotekave tona me libra të rinj të cilat i dhuruan: Publikimi i listës së përfituesve të Subvencioneve-2021 dhe konsulta me perfitues te klubeve
- Plotësimi i kërkesave finale i Buxhetit të DKRS-së 2022-2024.
- Plotësimi i dokumentave sipas thirrjes se aplikuesve të subvencioneve-2021.
- Takim pune me komisionin për ndarjen e Subvencioneve-2021,
- Takim pune me zyrtaret e Prokorimit,
- Kontrollim i dokumetacionit të Aplikuesve pas mbarimit të afatit plotësues të shpalljes kualifikuese për Subvencione-2021,
- Shpallja e Listës Finale të përfituesve të Subvencioneve-2021
- Procedimi final i projektit Dekorimi i Qytetit për festa Nacionale dhe Kombtare për zyren e Prokorimit.
- Harmonizimi kërkesave buxhetore finale për vitet 2022-2024.
- Konsultë me palet që kanë përfituar subvencionet-2021
- Shënimi i 30 Gushtit , , Dita e të Pagjetureve,"
- Pranimi i donacionit nga MKRS, për Bibliotekat e Drenasit me vlerë 9000 euro.
- Shqyrtimi i kërkesës së MPL-së, për bashkfinacim,
- Shqyrtimi final i kërkesave Buxhetore, 2022-2024.
- Pregaditje për Orgonizimin e Kongresit të Manastirit,
- Akademi Solemne për Kongresin e Manastirit-1908,
- Akademi Solemne për nder të 28 Nëntorit,
- Hapja e Ekspozitës me 28 Nëntor,
- Takim pune për organizimin e Sportistit të Vitit,
- Raporti sektorial i DKRS-ë

| Autori - Institucioni | Exemplarë | Tituj | Gjithsej | Viti |
|---|---|---|---|---|
| Autorja Xhevahire Morina | 5 | 5 | 5 | 2021 |
| Autori Riza Greiçevci | 200 | 94 | 200 | 2021 |
| Autori Hisni Gashi | 50 | 24 | 50 | 2021 |
| Biblioteka Kombëtare "Pjetër Bogdani" | 237 | 237 | 237 | 2021 |
| Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Spotit | 202 | 93 | 202 | 2021 |
| Instituti i Historisë, , Ali Hadri '' | 104 | 45 | 104 | 2021 |
| Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | 1762 | 528 | 1762 | 2021 |
| Gjithsejt | 2560 | 1026 | 2560 | |

**Në vitin 2021 Bibliotekat kan përfituar donacione në vlerë - 9000 euro.**

**Arkivi komunal:**

- Pranimin e 2 kërkesave nga hulumtues për punim shkencor për të dhënat e Arkivit Historikun e fondeve arkivore ofrimin e të dhënave për përgatitjen e punimeve etj. 4 palë kanë marrë certifikata shkollore në fondet e shkollave nga arkivi. 10 palë janë shërbyer

| | |
|---|---|
| | nga arkivi me dokumente të kopjuara, nga arkivi për lokale shtëpi dhe njoftime të ndryshme. Gjithsejtë 16 dokumente dhe njoftime të lëshuara nga Arkivi të evidentuara në Protokollin e Arkivit.<br>- Skanimin e lëndëve të fondit nr. 5 revista të vitit 2010 të RFBSH-së;<br>- Verifikimin e raporteve Narrative dhe financiare të pranuara nga OJQ-të Kulturore,<br>- Pjesëmarrje në komisionin e vlerësimit të Inventarit në organet e Administratës së Përgjithshme për vitin 2020 përgatitjen e Raportit përfundimtar dhe dërgimin Zyrës së Kryetarit.<br>- **Punë të tjera të kryera nga zyrtari për arkiv dhe kulturë**<br>- Përpunimin e lëndëve në zyrën e DKRS-së në komunë të vjetër, klasifikimin, regjistrimin renditjen dhe përgatitjen e procesverbalit për dorëzim shefit të DKRS-së në zyrën e komunës së re, shpërndarjen e librave të autorit Bardhyl Mahmuti '' **Mashtrimi i Madh**" që i kemi marr në zyrën e DKRS-së në objektin e komunës së vjetër, nëpër Bibliotekat e Komoranit, Tërstenikut, Drenasit dhe të Arllatit nga 20 ekzemplarë;<br>- Përpunimin e lëndëve të Intranetit për DKRS dhënien e statusit të tyre, bashkëngjitjen e lëndëve shtesë etj.<br>- Pranimin e Raporteve Narrative dhe Financiare të OJQ-ve Kulturore dhe Individëve, kontrollimin e dosjeve dhe përgatitjen e raportit përfundimtar dhe dërgimin zyrës së Kryetarit të komunës dhe DKRS-së.<br>- Plotësimin e Tabelave në Excel me të dhënave të gjitha OJQ-ve Kulturore, Sportive, Rinore së bashku me zyrtarin e Sportit, të pranuara nga Drejtorati për Buxhet financave;<br>- Përgatitjen e raporteve të komisionit për pranim të mallrave për DKRS,<br>- Përgatitjen e kërkesave, kontratave për punëtoret e Palestrës dhe Stadiumi Sintetik që janë me kontrata të MSHV.<br>- Përgatitjen e deklaratës së nevojave për kontratë kornizë tri vjeçare, dërgimin e lëndës ZP përmes Protokollit,<br>- Pranimin e vendimit për emërim të menaxherit të kontratës " Furnizim me Buqeta Lulesh të Freskëta për Homazhe", plotësimin e procedurave në E- prokurim, nënshkrimin e planit të menaxherit, përgatitjen e lëndëve dhe procedimin për pagesë në Drejtoratin e Financave etj.<br>- Takime pune me grupin lokal të veprimit i caktuar me vendim të Kryetarit të komunës me OJQ Akti dhe me përfaqësuesit e bizneseve, me të rinjtë e trajnuar për punësim diskutim për rekrutimin dhe fillimin e trajnimin me të rinjtë, hartimin e një raporti mbi bazën e nevojave dhe rekomandimeve për të rinjtë në tregun e punës.<br>- Evidentimin e lëndëve arkivore të fondit nr. 30 të Drejtoratit për Administratë të Përgjithshme;<br>- Pranimin e një kërkese nga Drejtoresha e Drejtoratit për Urbanizëm për lejimin e kontrollimit te lëndëve në Arkiv nga zyrtarja Flora Thaçi për të gjetur vendimin të cilin na është dërguar në emalin zyrtar,<br>- Skanimin e librit të Amzës nr. 4 me të dhënat e nxënësve të fondit nr. 1 të fondit të shkollës fillore "Bashkimi" me emra të nxënësve dhe suksesin e tyre,<br>- Përgatitjen e sallës së bashku me puntorët e DKRS-së për pjesmarrjen ne 40 vjetorin e demonstratave të 2 Prillit viti-1981 i mbajtur në sallën e Kulturës; |

| | |
|---|---|
| | - Pjesmarrje në trajnimin e organizuar nga IKAP për dy ditë radhazi për menaxhimin e kontratave, shkëmbim bisedash për menaxhimin e kontratave dhe eliminimi i defekteve në procesin e realizimit të tyre,<br>- Vizitë te burimi i ujit te Kroi i Mbretit së bashku me komisionin e caktuar nga zyra e kryetarit për të vlerësuar gjendjen hapsirës së dëmtuar, përgatitjen e raportit përfundimtar dhe dergimin zyrës së kryetarit dhe DKRS-së<br>- Punët Administrative të DKRS-së ndryshimin e deklaratës së nevojave për kontratë kornizë tri vjeçare, dergimin e lëndës për nenshkrim, pranimit të faturave përgatitjen e raporteve për faturat e pranimit te materialit për garat e shkollave fillore dhe të mesme., porosinë për punimin e sofrës së drurit, vënjën e mbishkrimit, për eventin e mbajtur " Sofra Poetike Ymer Elshani " 2021.<br>- Pjesmarrje në takimin Online me komitetin Olimpik për mbajtjen e garave për ditën e Olimpiadës, mbajtjen e garave për nderë të Ditës së Olimpiadës së Kosovës,<br>- Përgatitjen së bashku me puntorët e DKRS-së për nder të zbulimit të shtatorës së Heroit Hafir Shala;<br>- Pjesmarrje në trajnim një ditor së bashku me zyrtarën e Dr. Zhvillimit Ekonomik për Trashegiminë Kulturore dhe Turizmin,<br>- Pranimin e dy shkresave nga MTI – Zëvendësuesja e Drejtorit të Departamentit të Turizmit dhe Zyrtari i Lartë për Standarde dhe Cilësi të Turizmit me tabela për plotësimin e atraksioneve turistike, përgatitjen e materialeve plotësimin e fushave sipas kategorive dhe llojit të monumenteve kontrollimin e materialit së bashku me zyrtaren e DZHE.<br>- Përgatitjen e listës së kërkuar nga zyra e Informimit me të dhëna ne promovimin e Kulturës dhe trashëgimisë kulturore klasifikimin e monumenteve Natyrore dhe Kulturore plotësimin me të dhëna dhe dërgimin zyrës së informimit.<br>- Skanimin e lëndëve të fondit shkollor nr. 1. " Bashkimi " tabela statistikore të nxënësve vitet 1975/76.<br>- Vizitë zyrtare në Arkivin e Skenderajt – shkëmbim përvojash të punës arkivore ndërmjet dy arkivave.<br>- Skanimin, evidentimin e librave të kontributeve të drejtoratit të ardhurave shoqërore të viteve 1979 – 1980 klasifikimin dhe renditjen sipas viteve, vendosjen në deponë arkivore,<br>- Perpunimin e lëndëve të fondit nr. 1 regjistrimin e listave te nxënësve të klasëve të teta<br>- Pjesmarrje ne takim një ditorë " Komunat për të rinjët."Plotësimin e listës me staf mbështetës nga të gjitha drejtoritë, dërgimin e listës ne MAPL;<br>- Kontrollimin e tabelave të plotësuara për Trashegimi Kulturore dhe Natyrore sebashku me Drejtoreshën e DKRS-ës dhe Shefen e Drejtoratit të Zhvillimit Ekonomik për ti përcjellur Ministrisë së Tregtisë këtë tabelë;<br>- Plotësimin e pyetsorit të pranuar nga zyrtarja e Asistencës Sociale për Trashëgiminë Kulturore.<br>- Plotësimin e 4 fushave me drejtime të ndryshme që na janë kërkuar nga MAPL dergimin e listës në zyrën e kabinetit të Kryetarit për konsultim të kësaj liste, dergimin zyrtarës së MAPL-së. |

- Takim së bashku me Nenkryetarin dhe Drejtoreshën e DKRS-së me perfaqsuesen e bankës Botërore Arlinda Koshi e financuar nga JSDF e Qeverisë Japoneze " Komunat për të Rinjtë" në Kosovë diskutim per hapat e më tutjeshëm të projektit.
- Pranimin e vendimit nga zyra e Kryetarit të Komunës për vlerësimin e aplikacioneve për Start Up-et, takim me komisionin për vlersimin e Aplikacioneve, kontrollimin e aplikacioneve përgatitjen e Procesverbalit dhe të Listës së Aplikantëve,
- Përgatitjen e të dhënave për aktivitetet dhe projektet e realizuara Kulturore, Sportive, Rinore për vitet 2017 – 2021.
- Pranimin e një pyetësori nga zyra e Informimit për çasje në dokumentet zyrtare, plotësimin së bashku me shefin e DKRS-së,

**Bibliotekat në Komunën e Drenasit gjatë vitit 2021 kanë këtë pasqyrë:**

| Muaji-Janar-Dhjetor 2021 | Nr. i ekzemp. | Nr i titujve | Ekzemplar të ri | Tituj të ri | Libra të lexuara | Nr. i lexuesve | Lexues të ri | Gjithsej të lexues |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Drenas | 10121 | 3945 | 1291 | 584 | 2119 | 1103 | 235 | 1338 |
| Terstenik | 4904 | 1585 | 746 | 224 | 170 | 264 | 44 | 265 |
| Arllat | 5154 | 954 | 0 | 0 | 20 | 292 | 5 | 297 |
| Komaran | 4063 | 2293 | 855 | 449 | 591 | 480 | 45 | 480 |
| **Gjithsejt TOTALI** | **24242** | **8777** | **2892** | **1257** | **2900** | **2139** | **329** | **2380** |

**Aktivitetet sportive**

**Sektori i Sportit e ka realizuar plan-programin e vetë të punës dhe për periudhën janar-dhjetor ka zhvilluar këto aktivitete.**

Në kuadër të planifikimit të punëve dhe aktiviteteve të zhvilluara në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, përkatësisht Sektorit të Sportit janë kryer këto punë – aktivitete sportive:

- Janë zhvilluar takime me klubet dhe shoqatat sportive për plotësimin e dokumentacionit-formularëve dhe raportimit të subvencionit;
- Pjesëmarrje në komisione të ndryshme vlerësuese të ofertave për projektet e ndryshme në bazë të vendimit të kryetarit të komunës;
- Është bërë raportimi i të dhënave në sistemin e Menaxhimit të përformancës Komunale për vitin 2020;
- Janë zhvilluar garat për Sh.F.M.U-ve dhe Sh.M.L-ta për garat në lojërat Sipas Kalendarit të garave të Federatës së Sportit shkollor për këtë -2021 për Djem e Vajza në këto disiplina: Pingpong, Basketboll, Shah, Vojelboll dhe Futsall;
- Janë ndihmuar klubet në transportin e lojtarëve për zhvillimin e Lojërave kampionale, pjesëmarrje në evente të organizuara nga federatat e ndryshme sportive;
- Në palestrën sportive, ‚Hysni Jetullahu'' janë zhvilluar garat e SHMFU-ve të nivelit Regjional nga Federata e Sportit Shkollor në disiplinën e Hendbollit;
- Me datë 13.06.2021 u mbajt aktiviteti sportiv Kupa e Çlirimit të Republikës së Kosovës 2021 nga Federata e Shigjetarisë së Kosovës;

- Zyrtari i sportit iu është përgjigjur kërkesave të ndryshme nga klubet tona sportive iu është dhënë përgjigja adekuate në bazë të ligjit për sport, udhëzimeve administrative dhe rregulloreve në fuqi;
- Zyrtari i sportit ka ndihmuar dhe prezantuar në mbledhjet, kuvendet e mbajtura nga klubet sportive, në seanca stërvitore dhe ndeshje kampionale të zhvilluara gjatë këtij gjashtë mujori;
- Në bazë të kërkesave është dhënë në shfrytëzim Stadiumi Sintetik sipas rregullores në fuqi për Taksa, Tarifa Ngarkesa dhe Gjoba;
- Zyrtari i sportit si organ mbikëqyrës ka bërë raporti për pagesën në projektin, "Dekorimi i Qytetit'';
- Me datë 23.06.2021 në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës me mbështetje të Drejtorisë Komunale për Arsim të Komunës Drenasit është zhvilluar aktiviteti sportiv me fëmijët e lindur në vitin 2008 për shënimin e Ditës Ndërkombëtare Olimpike në të cilin aktivitet morën pjesë 944 nxënës të lindur në vitin e pavarësisë, vitin 2008, gjegjësisht nxënës të klasave të VII, nga ta 419 vajza dhe 525 djem;

**Stadiumi Sintetik – Drenas**

**Raporti mujor Janar-dhjetor**

- Është respektuar vendimit i Qeverisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës, për manuali për COVID-19 për mos pjesëmarrje të shikuesve gjatë aktiviteteve sportive;
- Është mbajtur turneu në Shigjetari "Kupa e Çlirimit të Republikës së Kosovës " nga Federata e Shigjetarisë së Kosovës;
- Janë mbajtur dy lojë me pagesë nga KF: Drenica-Skenderaj;
- Kemi bërë mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruar për rreth objektit të Stadiumit Sintetik;
- Kemi bërë pastrimin e objektit dhe fushës brenda dhe jashtë Stadiumit Sintetik;
- Është bërë pastrimi i fushës nga bora;
- Është bërë mirëmbajtja (krehur) barit sintetik në fushë;
- Nga klubi i futbollit Drenasi donacion rrjeta për porta të futbollit.

| Nr | Muaj | Stërvitjet | Orë | Nr. i Lojtarëve | Nr. i shikuesve | Ndeshje Kampionale |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | **Janar** | 32 | 46 | 894 | 0 | 0 |
| 2. | **Shkurt** | 128 | 70.10 | 4052 | 0 | 15 |
| 3. | **Mars** | 176 | 228 | 5452 | 0 | 27 |
| 4. | **Prill** | 160 | 195 | 5091 | 0 | 23 |
| 5. | **Maj** | 142 | 173.20 | 5237 | 0 | 29 |
| 6. | **Qershore** | 149 | 163.50 | 4828 | 0 | 16 |
| 7 | **Korrik** | 103 | 118 | 2540 | 0 | 6 |
| 8 | **Gusht** | 173 | 177 | 5090 | 0 | 14 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 9 | **Shtator** | 265 | 348 | 984 | 1521 | 57 |
| 10 | **Tetor** | 204 | 252 | 5838 | 2184 | 34 |
| 11 | **Nëntor** | 259 | 315.20 | 6280 | 1329 | 24 |
| 12 | **Dhjetor** | 52 | 62 | 1387 | 267 | 10 |
| | **Përmbledhje e aktiviteteve** | **1843** | **2146.40** | **47673** | **5301** | **255** |

**Palestra e Sportit '' Hysni Jetullahu " – Drenas**

**Raporti vjetor Janar-Dhjetor**

| Nr | Muaj | Stërvitjet | Orë | Nr. i lojtaeve | Nr. i shikuesve | Ndeshje Kampionale |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1.** | **Janar** | 18 | 31 | 190 | - | 1 |
| **2.** | **Shkurt** | 85 | 167 | 1247 | - | 7 |
| **3.** | **Mars** | 60 | 116 | 1241 | - | 9 |
| **4.** | **Prill** | 55 | 101 | 1189 | - | 10 |
| **5.** | **Maj** | 87 | 180 | 2044 | - | 6 |
| **6.** | **Qershor** | 51 | 81 | 684 | - | 1 |
| **7** | **Korrik** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **8** | **Gusht** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **9** | **Shtator** | 49 | 81,5 | 814 | 28 | 6 |
| **10** | **Tetor** | 84 | 162 | 1772 | 858 | 18 |
| **11** | **Nëntor** | 78 | 143,5 | 1572 | 728 | 11 |
| **12** | **Dhjetor** | 39 | 96,5 | 462 | 129 | 4 |
| | **Përmbledhje e aktiviteteve** | **606** | **1159,5** | **11215** | **1743** | **73** |

**Aktivitetet rinore**

**Sektori i Rinisë në bashkëpunim me KVRL-në gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar këto aktivitete:**

- Janë mbajtur zgjedhjet e rregullta për zgjedhje të strukturës udhëheqëse të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal, ku për një mandat të dytë u zgjodh edhe për një mandat Donika Zogu;
- Realizimi i takimeve me strukturat e KVRL-ës;
- Realizimi i trajnimeve në disa fusha më të rinjtë e komunës sonë;
- Shënimi i ditës botërore të pastrimit;
- Pregaditje për Orgonizimin e Kongresit të Manastirit,
- Angazhim në Komiosione të ndyshme,
- Akademi Solemne për nder të 28 Nëntorit,
- Takim pune për organizimin e Sportistit të Vitit,

| | |
|---|---|
| | Në kuadër të projekteve kapitale në vitin 2021 kemi pasur pengesa në realizimin e tyre për shkak të pandemisë, por prapë ka pasur zhvillim të punimeve kështu kemi këto projekte të zhvilluara në këtë periudhë:<br>- Vazhdimi i ndërtimit të Stadiumit "Rexhep Rexhepi" faza e dytë;<br>- Renovimi i Stadiumit Sintetik, Faza e Parë si projekt kapital;<br>- Ndërtimi i Fushave Sportive dhe Rekreacion;<br>- Renovimi i monumentit natyrorë '' Uji i Thartë " në Poklek, projekt kapital emergjent, **është përfunduar si projekt.** |

## 3.4.DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL (DBPZHR)

Kjo Drejtori gjatë kësaj periudhe një vjeçare (për vitin 2021) ka kryer punët dhe detyrat në të gjitha lëmit përkatëse që janë kompetencë e saj, në bazë të Statutit të Komunës ku është obligim dhe përgjegjësi e kësaj Drejtorie, që të zbatojë dispozitat ligjore lidhur me të gjitha lëmit që janë në kompetencë të saj:

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (DBPZHR) në kuadër të kompetencave, autorizimeve dhe përgjegjësive të saja funksionon në zbatimit të drejtpërdrejt të ligjeve:

- Ligjin për tokën bujqësore Nr.02/L-26 ;
- Ligjin për mbrojtjen e bimëve Nr.02/L-95 ;
- Ligji për Shërbime Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural – Nr.04/L-074
- Ligjin për Gjuetinë Nr.02/L-53 ;
- Ligjin për Bletarin Nr.02/L-111 ;
- Ligjin për kujdesje ndaj kafshëve Nr.02/L-10 ;
- Ligjin për pyjet e Kosovës Nr.2003/3 ;
- Ligjin 03/L-153 për ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit Nr.2003/3 për Pyjet e Kosovës .

Në komunën e Drenasit Bujqësia po shndërrohet në një sektor të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik dhe duke pasur parasysh kushtet e volitshme si nga aspekti pedologjik po ashtu edhe në atë klimatik. Duke pas parasysh këta faktor komuna e Drenasit ka për qëllim që të zgjerojë kapacitetin e zhvillimit bujqësor ku përmes saj do të hapen vende të reja të punës e po ashtu si qëllim kryesor do të jetë rritja e prodhimeve vendore dhe ulja e importit.

### SEKTORI I BUJQËSISË DHE SEKTORI I ZHVILLIMIT RURAL KA KRYER KËTO PUNË:

- Këshillime për fermerë për të gjitha sektorët e bujqësisë;
- Këshillime, udhëzime fermerëve rreth aplikimit për Grande në MBPZHR, në sektorët e ndryshëm.

- Këshillime fermerëve rreth aplikimit për subvencione në pagesa direkte në sektorët e ndryshëm të bujqësisë.
- Regjistrimi i fermerëve të rijnë në regjistrin e fermës (NIF).
- Është bërë lëshimi i Certifikatës së fermeri ( NIF) dhe informatave përcjellëse të fermerit-(ANEXI ).
- Është bërë planifikimi dhe realizimi i të mbjellave pranverore **2021** (të **planifikuara 2,460 ha** ku prej tyre janë realizuara **2.298 ha**).
- Është bërë planifikimi dhe realizimi i të mbjellave vjeshtore **2021/2022** (të planifikuar **3,650 ha** ku prej tyre janë realizuar **2,875 ha).**
- Është bërë raportimi në MBPZHR për planifikimin dhe realizimin e mbjelljeve pranverore/vjeshtore.
- Është bërë vlerësimi dhe ekspertizat e dëmeve në kulturat e ndryshme bujqësore nga fatkeqësitë natyrore si erërat e forta, bora, breshëri, vërshimet**.**
- Është bërë pranimi i kërkesave të ndryshme të fermerëve në sektor të bujqësisë :
  - 367 kërkesa për vlerësim të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore;
  - 407 kërkesa – aplikues në 3 projektet e drejtorisë ;
  - 7 kërkesa të ndryshme të fermerëve, është bërë raporti i vlerësimit për secilin fermer dhe kthimi i përgjigjeve.
- Pas vlerësimit të kërkesave të fermerëve nga fatkeqësitë natyrore për çdo muaj kërkesat janë dorëzuar në MBPZHR për kompensim të dëmit. Në fundvit MBPZHR ka marr vendim për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore gjatë vitit 2021 në vlerë prej 36% të vlerës totale të vlerësuar nga komisioni i formuar nga komuna dhe për këtë qëllim sipas kërkesës së komisionit verifikues pranë MBPZHR-së nga zyrtarë e DBPZHR-së janë kompletuar të dhënat e 310 fermerëve për pagesë (kopja e letërnjoftimit dhe konfirmimi i llogarisë bankare).
- Është bërë përpunimi i 407 lëndëve për tri projektet e drejtorisë dhe dorëzimi i lëndëve fizike në arkivin e komunës.
- Përgatitja rreth Korrje –Shirjeve, bashkëpunim me MBPZHR, auto-kombajnerët, fermerët dhe pikat grumbulluese të drithërave në territorin e Komunës së Drenasit.
  - ➢ **Çmimi i korrje -shirjeve ka qenë 90 € për ha**
- Pas përfundimit të Korrje -Shirjeve është bërë raportimi në MBPZHR rreth ecurisë së këtij procesi si dhe për rendimentet e marra nga kultura e grurit.
- Kompania – Ndërmarrja **" IBËR LEPENCË"** Njësia e Punës në Komoran gjatë këtij viti ka punuar në rregullimin e rrjetit të ujitjes dhe ndërrimin e pjesëve të dëmtuar në rrjet në mënyrë që të zgjerohen sipërfaqet e ujitura, tani rrjeti i ujitjes është i aftësuar me **2970 ha**, ndërsa sipërfaqet të ujitura për vitin 2021 janë **mbi 144.26 ha.**
- **Punim në komisionin për** Pëlqime **Mjedisore Komunale ;**
- **Punim në komisionin për Arsim dhe** Shëndetësi **për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për nëpunësit që punojnë në sektorin publik të cilët nuk janë shërbyes civil;**
- Janë **kryer** punë shtesë **nga** zyrtarët **e drejto**risë tonë ne bazë **të vendimit të** zyrës **së Kryetarit .**
- **Punim në** platformën **e-prokurimi – mena**xh**er të kontratave të ndryshme.**

- **Punim në** platformën **e-prokurimi** – mbikëqyrës **të kontratave të** ndryshëm.
- **Takime me Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural .**
- **Takime me OJQ të ndryshme me qëllim përkrahjen në projekte të ndryshme bujqësore.**

**Projektet nga Komuna**

- Janë bërë realizimet e të gjitha projekteve të planifikuara nga DBPZHR.
- Projektet të cilat janë realizuar gjatë vitit 2021 janë:

➢ **Perimtari**

**Furnizimi i fermerëve me Serra me sipërfaqe 50 m²**

Në këtë projekt kanë aplikuar 229 fermer dhe kanë përfituar gjithsej 68 fermer me vlerën totale të projektit **36,584.00€ .** Projekti ka qenë me Financim të Komunës 70 % dhe Participim nga fermeri 30% .

➢ **Blegtori**

**Furnizimi i fermerëve me Makina Mjelëse**

Në këtë projekt kanë aplikuar gjithsej 64 fermer dhe kanë përfituar gjithsej 40 fermer me vlerën totale të projektit **6,360.00€** ky projekt ka qenë me Financim të Komunës 70% dhe Participim të fermerit 30% .

➢ **Pemëtari**

**Furnizimi i fermerëve me Pajisje për Krasitjen e Pemëve**

Në këtë projekt kanë aplikuar gjithsej 114 fermer dhe kanë përfituar gjithsej 114 fermer me vlerën totale të projektit **6,840.00€,** ky projekt ka qenë me Financim të Komunës 80% dhe Participim të fermerit 20%.

**Projektet nga MBPZHR në bashkëpunim me Komunën**

Është bërë informimi i fermerëve për aplikim rreth grandeve, subvencioneve për pagesa direkte: Grurë, sasi të grurit të dorëzuar në sillose, mullinj ose pika grumbulluese, Farë Gruri, Elbit, Thekrës, Misër, Luledielli, Vreshta, Pemë, për prodhimin Fidanor të Pemëve, Perime në fushë të hapur, Lopë dhe Buallica Qumështore, Dele, Dhi, Bletari, Pula Vojse, Dosa në Riprodhim, Bimë Mjekues Aromatike, Bujqësi Organike dhe Thëllëza.

Është bërë DIGJITALIZIMI i parcelave i të mbjellë me kultura të ndryshme, janë bërë të gjitha pranimet e aplikacioneve të fermerëve që kanë aplikuar në programet e ndryshme për subvencionime nga MBPZHR, janë kompletuar dokumentacionet dhe janë dërguar në AZHB, gjithsej 861 aplikacione të fermerëve aplikues në të gjithë sektorët e bujqësisë Pemëtari, Perimtari, Lavërtari, Blegtori, Bletari, Shpeztari etj.

- **Subvencionimi i të mbjellave me grurë,** është bërë digjitalizimi i parcelave **1713.40 ha,** subvencionimi për 1 hektar ka qenë **75€** dhe sasi të grurit 1,829.862 kg me subvencionim me çmim 0.019€ për kg të grurit të dorëzuar
- **Subvencionimi i të mbjellave me elb,** është bërë digjitalizimi i parcelave **192.96 ha,** subvencionimi për 1 hektar ka qenë **150€**.
- **Subvencionimi i të mbjellave me thekër,** është bërë digjitalizimi i parcelave **64.72 ha,** subvencionimi për 1 hektar ka qenë **150€**.
- **Subvencionimi i të mbjellave me tërshëre**, është bërë digjitalizimi i parcelave **100.17 ha.** subvencioni për 1 hektar ka qenë **150€**
- **Subvencionimi i të mbjellave me misër**, është bërë digjitalizimi i parcelave **1074.00 ha,** subvencionimi për 1 hektar ka qenë **150€**.
- **Subvencionimi i Plantacioneve me pemë**, është bërë digjitalizimi i parcelave **142.15 ha,** subvencionimi për 1 hektar ka qenë **400€**.
- **Subvencionimi i Perimekulturës - (në fushë të hapur dhe të mbyllur),** është bërë digjitalizimi i parcelave **89.19,** subvencionimi për 1 hektar ka qenë **400€.**
- **Subvencionimi i BMA-së -,** është bërë digjitalizimi i parcelave **4.50** ha subvencionimi për 1 hektar ka qenë 4**00€**,

**Subvencionet: Blegtori (Lopë, dele, dhi) bletari**

- **Subvencionimi i lopëve qumështore** – Fermerët kanë aplikuar për **1.452** krerë lopë qumështore, subvencionimi për 1 lopë qumështore ka qenë **85 €**.
- **Subvencionimi i Viçave** – Fermerët kanë aplikuar për **360** krerë viça, subvencionimi për 1 viç ka qenë **10 €**.
- **Subvencionimi i deleve,** Fermerët kanë aplikuar për **3.954** krerë dele, subvencionimi për 1 dele ka qenë **20 €**.
- **Subvencionimi i dhive,** Fermerët kanë aplikuar për **573** krerë dhi, subvencionimi për 1 dhi ka qenë **20 €**.
- **Subvencionimi i shoqërive me bletë** Fermerët kanë aplikuar për **4.702 koshere** bletë, subvencionimi për 1 koshere ka qenë **15 €**.

**Subvencionet: Shpeztari**

- **Subvencionimi i fermerëve për pula Vojse** kane aplikuar 2 fermerë për **13,000 copa** pula Vojse
- **Subvencionimi i fermerëve për thëllëza** ka aplikuar 1 fermerë me **10,200 copa.**

**Subvencionimi për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë**

- Kanë aplikuar **34** fermer për qumësht/litër për gjashtëmujorin e parë sipas kategorive: **Ekstra klasë 0.06 €, Klasa e parë 0.04€, Klasa e dytë 0.02€ Gjithsej: 708,933.00 Litra**

Trajnimet e mbajtura nga MBPZHR në bashkëpunim me zyrtarët e DBPZHR-së për fërmerët e komunës së Drenasit:

- Teknologjia e avancuar në prodhimtarinë bujqësore
- Planifikimi, menaxhimi dhe analizimi i fermës,
- Marketingu i prodhimeve bujqësore,
- Agropërpunimi dhe diversifikimi rural,
- Trajnim me gra për bletari.
- **Marrja e mostrave të tokës për analiza tek 12 fermer dhe komunikimin e rezultateve të analizave kimike, biologjike dhe fizike me ESG.**

## 3.5.DREJTORIA E INSPEKCIONIT

| | |
|---|---|
| **Menaxhimi, arritjet kryesore, performanca kyçe në periudhën janar-dhjetor 2021 për realizimin e prioriteteve** | Drejtoria e Inspeksionit, punët dhe detyrat e punës për periudhën janar-dhjetor 2021 i ka kryer duke u bazuar në planin operativ për vitin 2021. Drejtoria e Inspeksionit duke u bazuar në parimin se asgjë nuk ka mbi ligjin, ka qenë këmbëngulëse në zbatimin e ligjeve të aplikueshme dhe vendimeve të Kuvendit Komunal, pa marrë parasysh vështirësitë, pengesat dhe sfidat që ka hasur kjo Drejtori gjatë kryerjes së punëve dhe detyrave zyrtare. Mënyra e menaxhimit, në këtë Drejtori ka qenë në nivel të aktiviteteve të rëndësishme, varësisht prej punëve dhe detyrave ku çdo herë si model është aplikuar parimi i efikasitetit, gjegjësisht identifikimi i problemit, definimi i qëllimit të zgjedhjes së problemit, vlerësimi i alternativave, zgjedhja e alternativës më të mirë, (marrja e vendimit), implementimi (zbatimi) i vendimit dhe kontrolla e implementimit. Me qellim të parandalimit të infeksionit Corona Virus (COVID-19) Drejtoria e Inspekcionit në bashkëpunim dhe asistimin e PK në bazë të Ligjit për Shëndetësi nr. 04/L-125, Ligjit nr.02/1-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, Manualit dhe Rekomandimeve të IKShP si dhe në zbatim të Vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ka vazhduar inspektimet e të gjitha subjekteve për të respektuar masat mbrojtëse për mbrojtje ndaj COVID-19.<br><br>Vlen të theksohet se gjatë këtij viti është bërë edhe punë shtesë jashtë orarit me qëllim të realizimit të planit të punës dhe vetëdijesimit të qytetarëve në zbatim të Ligjeve në përgjithësi. Në të gjitha lëmit e inspektimit është punuar nga secili inspektor në kuadër të kompetencave ligjore, rrethanave në terren dhe në përputhje me realitetin ekzistues në territorin e komunës së Drenasit. Gjatë periudhës raportuese janar –dhjetor 2021 vazhdimisht është bërë koordinimi i punëve dhe detyrave të punës në teren dhe është bërë përcjellja e punës së inspektorëve, duke raportuar çdo ditë, si dhe janë dhënë sqarime profesionale në zbatushmerinë inspektuese. Janë hartuar raportet ditore të punës nga inspektorët e lëmive përkatëse për punën në teren, raportet javore, mujore dhe periodike nga Shefi i Drejtorisë rreth kryerjes së punëve dhe detyrave të punës në DI. Në vazhdimësi është përcjellë buxheti i vitit 2021, zotimet dhe shpenzimet për paga, mallra dhe shërbime. Po ashtu është hartuar buxheti –kërkesat finale për periudhën 2022-2024 për Drejtorinë për Inspeksion. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2021 janë kryer punët dhe detyrat nën mbikëqyrjet inspektuese si vijon: |

| | |
|---|---|
| | • Inspektimet rreth mbrojtjes nga pandemia COVID-19 sipas Manualit të IKSHP, Ligjit për mbrojtje të sëmundjeve ngjitëse dhe Vendimeve të Qeverisë së Kosovës.<br>• Inspektimi i subjekteve afariste hoteliere rreth Ligjit të duhanit dhe marrja e masave ndaj shkelësve të këtij Ligji.<br>• Inspektimi rreth higjienës dhe kushteve higjiena-sanitare etj.<br>• Inspektimet lidhur me tregtimin me pakicë, pajisjen e subjekteve afariste me certifikata të biznesit si dhe inspektimet mbi blerjen, shitjen, çmimet, delegacionin e mallit, mbrojtjen e konsumatorit, zbatimin e orarit të punës etj<br>• Mbikëqyrja e tregjeve, rrugëve, trotuareve, e sidomos inspektimi rreth ujërave të zeza në zonat rurale.<br>• Mbarëvajtja e tregjeve javore në Drenas dhe Komoran<br>• Mbikëqyrja e kualitetit të ushqimit, të produkteve të ambalazhuara dhe të paambalazhuara.<br>• Mbikëqyrja e ndërtimit në sektorin publik dhe privat rreth punimeve dhe pajisjes me leje të ndërtimit, si dhe ndalimi i punimeve të objekteve pa leje dhe marrja e masave të nevojshme.<br>• Inspektimi rreth ndotësve të ambientit<br>• Mbikëqyrja e kompanive të transportit në komunikacionin rrugorë, orari i udhëtimit, lejet e operimit, rendet e udhëtimit, stacionet, parkingjet etj.<br>• Janë kryer edhe punë tjera sipas kërkesave dhe nevojave në teren. |
| Nga lëmia e Inspektorit Sanitar | Nga lëmia e Inspektorit Sanitar është bërë inspektimi rreth parandalimit të dhe luftimit të sëmundjeve ngjitëse COVID-19, higjienës së ujit, Institucioneve shkollore, artikujve ushqimor, hoteleve, kuzhinave ushqimore si dhe higjiena e objekteve tjera afariste.<br>• Që nga fillimi i këtij viti është vazhduar aksion i përbashkët me Inspektorët e Agjensionit të Ushqimit dhe Veterinës dhe Policinë e Kosovës-Njësiti në Drenas, në kontrollë të gastronomive dhe subjekteve tjera, operatorëve transportues, Institucioneve private shëndetësore dhe publike, respektimi i të gjitha masave mbrojtëse për luftimin e COVID-19.<br>• Janë inspektuar me rëndësi të veçantë marketet ushqimore, barnatoret, sallonet e ondulimit dhe furrat e bukës rreth respektimit të masave anti COVID dhe në ato subjekte ku kanë hasur në shkelje janë shqiptuar gjoba mandatore.<br>• Është vazhduar me mbikëqyrjen e zbatimit të masave mbrojtëse dhe respektimi i distancës sociale brenda të gjitha subjekteve aktive, si dhe respektimi i orarit të punes së gastronomive sipas vendimeve të fundit.<br>• Ndërsa që nga muaji shtator kur është bërë pranimi i inspektorëve të ri për Covid nga AUV, në mbikëqyrjet inspektuese në kontrollë të masave mbrojtëse ndaj virusit janë marr vetëm ata dhe nuk kemi raportim nga ana tyre për masat në teren.<br>• Me paraqitjen e rasteve të radhës të infektuar me virusin COVID-19 në Komunën e Drenasit, nga Drejtoria e Shëndetësisë janë sjellë raportet ditore të rezultateve të |

| | |
|---|---|
| | testeve dhe këtyre personave të rezultuar pozitiv ju kemi lëshuar Aktvendimet për karantinim sipas rekomandimeve nga IKSHP.<br>• Gjithashtu edhe rasteve të shëruara të cilët e kanë përfunduar kohën e izolimit ju kemi lëshuar Anulimet e vendimeve për izolim gjithmonë duke respektuar kohën e izolimit sipas rekomandimeve të IKSHP.<br>• Janë shqyrtuar kërkesat e subjekteve për marrjen e pëlqimit sanitar në ushtrimin veprimtarisë të subjekteve afariste dhe ato shëndetësore private.<br>• Janë shqyrtuar ankesat e konsumatorve për artikuj ushqimor që kanë hasur në shitje gjatë blerjes në dyqane ushqimore, të cilat janë shqyrtuar dhe janë marr masat e duhura, ku palët janë njoftuar me shkrim për masat e marra.<br>• Është bërë mbyllja fizike e lëndëve të sektorit sanitar nga muaji janar 2021 dhe miratimi i tyre në sistem, si dhe dërgimi me procedurë të rregullt për arkivë, gjithsej 1230 lëndë.<br><br>**Pasqyra e punës në shifra për vitin 2021:**<br><br>• Inspektime........................................ ........422<br>• Procesverbale........................................... 123<br>• Aktvendime për izolim........................... 2214<br>• Anulime të vendimeve për izolim .............698<br>• Gjoba mandatore........................................ 09 (1390 **€**)<br>• Kërkesa.......................................................20<br>• Ankesa të konsumatorëve..............................04<br>• Pëlqime sanitare..........................................15<br>• Procedimi i lëndëve për arkivë................1230 |
| **Nga lëmia e Inspektorëve të Tregut** | Duke u bazuar edhe në planin e punës për vitin 2021, Inspektorati i Tregut ka kryer një mori inspektimesh në fusha të ndryshme të tregut. Si shkak i inspektimeve të vazhdueshme në biznese të pa regjistruara, dikun rreth 13 biznese janë regjistruar dhe rreth 10 të tjera janë në proces të inspektimeve për regjistrim. Janë mbyllur 2 lokale që kanë ushtruar veprimtari të paligjshme. Në bashkëpunim edhe me Njësitet Speciale të Policisë së Kosovës janë kryer edhe bastisje dhe kontrolle në lokalet e natës që operojnë në territorin e Drenasit. Inspektimet në lidhje me respektimin e orarit kanë vazhduar edhe këtë vit, në lëmin e të cilit janë shqiptuar dy gjoba mandatore. Gjatë kontrollimit të mallit dhe artikujve të ndryshëm në treg, në shtatë raste kemi bërë konfiskime dhe asgjësime të mallit pa afat.<br><br>Duke u bazuar që vendi është duke kaluar një periudhë të vështirë pandemie, edhe në këtë aspekt Inspektorët e Tregut kanë dhënë kontributin e tyre, duke kryer inspektime sipas nevojës dhe me autorizim si Inspektor Sanitar duke nxjerrë mëse 200 Aktvendime për izolim të të infektuarve me Covid-19.<br><br>• Inspektimet e subjekteve afariste rreth regjistrimit të bizneseve. |

<table>
<tr><td></td><td>
<ul>
<li>Kontrollë rreth zbatimit të orarit të punës, deklaracionit të mallit dhe kontrollit të çmimit të artikujve.</li>
<li>Inspektimi i sigurisë së produkteve ushqimore me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve.</li>
<li>Inspektimet e herëpashershme sipas kërkesave dhe në bashkëpunim më MTI-në në bazë të Ligjit të tregtisë së brendshme.</li>
</ul>
Raporti i shprehur në shifra
Procesverbale.........................................................................135
Kërkesa te palëve ..............................................................13
Gjoba mandatore...................................................................3
Vlera e gjobave mandatore ............................................1470 €
Lëndë të mbyllura.............................................................120
Pëlqime për ushtrimin e veprimtarisë .......................... 15
</td></tr>
<tr><td>Nga lëmia e Inspektorit të Ndërtimit</td><td>
Nga lëmia e ndërtimtarisë janë përcjellë në vazhdimësi ndërtimet rreth lejeve të ndërtimit dhe tërë dokumentacionin e nevojshëm ndërsa për shkelësit e ligjit janë marrë masat e nevojshme. Gjatë vitit 2021 janë inspektuar objektet siç janë :Objekte të ndërtimit të kategorisë së I-rë dhe të II-të, instalime elektrike-ujësjellës-kanalizim, mure rrethuese, rrethoja të ndryshme, rrugë të dëmtuara, bllokim i ujë rrjedhave me mbushje, fasada të ndërtesave, parkingje etj. Në këto inspektime përfshihen objektet me leje dhe pa leje ndërtimore. Procedurat e gjata për pajisje me leje ndërtimi për shkak të problemeve me prona, definimi, eksproproimi, si dhe pronari i tyre si dhe zonat nen komasacion dhe nen ujitje, po krijojnë procedura të gjata, vështirësi dhe vonesa në pajisjen e investitorëve me leje të ndërtimit. Po ashtu problem në vete paraqesin zonat e komasacionit dhe tokat bujqësore. Inspektorati i Ndërtimit vazhdimisht ka zhvilluar inspektime në teren të ndërtimeve me leje dhe pa leje dhe ka shqiptuar masat ndëshkuese sipas ligjeve në fuqi. Janë zhvilluar aktivitete të ndryshme, duke cekur ndërprerje të ndërtimit, shqiptim të gjobave, kallëzime penale, vendosje të shenjës zyrtare, urdhra për rrenim.
<ul>
<li>Është hartuar një tabelë me të dhëna lidhur me objektet pa leje dhe me leje ku janë vendosur te gjitha të dhënat. Ndërprerje të ndërtimeve gjatë viti 2021 - 87 objektet me destinim te ndryshëm.</li>
<li>Objekte të cilave i janë ndërprerë punimet por janë pajisur me leje ndërtimore - 36 objekte.</li>
<li>Objekte të cilat janë në procedurë të lejes (probleme me trashëgimi te tokës) janë - 7 objekte, janë nën vëzhgim dhe</li>
</ul>
</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | • Objekte me urdhër për ndalje qe janë në procedurë sipas afatit janë **4** objekte.<br>• Kallëzime penale janë bërë gjithsej **21** për persona fizik.<br>• Gjatë tërë vitit janë lëshuar 38 Urdhëra për ekzekutim të Aktvendimeve (rrenim të objekteve), por që nuk janë ekzekutuar ende për arsyeje të ndryshme nga organi kompetent.<br>• Gjoba të shqiptuara 33 gjoba arrin vlerën **56,000 €** |
| **Nga lëmia e Inspektorit të Mjedisit** | Drejtoria e Inspekionit konkretisht Sh.S- Inspektori i mjedisit gjatë kësaj periudhe ka kryer punët në bazë të detyrave të punës, ligjeve, udhëzimeve administrative dhe rregulloreve në lëmin e mbrojtjes se mjedisit. Gjatë kësaj periudhe kemi pasur një numër të kërkesave nga banoret e komunës të cilat kanë pasur të bëjnë kryesisht me lëmin e mjedisit. Të gjitha këto kërkesa janë shqyrtuar brenda afatit me ç 'rast janë bërë edhe procesverbalet, si dhe janë marrë masat konformë ligjeve, udhëzimeve administrative dhe rregulloreve në fuqi. Përveç shqyrtimit të kërkesave ne rregullisht kemi dal në teren dhe kemi bërë procesverbale edhe për personat të cilët kanë vepruar në kundërshtim me ligjin si vijon :<br>• Inspektimi i hedhjes së mbeturinave afër rrugëve, vendeve publike.<br>• Inspektimi i largimit të mbeturinave inerte në vendet ku ka pasur ndërtime.<br>• Inspektimet e operatorëve të cilët veprojnë në Komunën e Drenasit e që janë ndotës të mjedisit.<br>• Inspektimet sipas kërkesave të qytetarëve rreth kanalizimeve, ujërave të zeza, plehrave, sidomos në zonat rurale.<br>• Inspektim i largimit – pastrimit të deponive të egra të hedhura në sipërfaqe publike dhe natyrë, për punët e kryera në teren janë hartuar **129** procesverbale, janë shqyrtuar **54** kërkesa, janë shqiptuar **11** gjoba mandatore.<br>• Shuma totale e gjobave është :**2110 €** |
| **Nga lëmia e Inspektorit të Komunikacionit** | Gjatë periudhës kohore Janar-Dhjetor 2021 është inspektuar në lëmin e transportit të udhëtarëve sipas Ligjit për transportin rrugorë Nr. 04/L179, në bazë të Rregullores së Komunës së Drenasit Nr. 06/7086 dhe Rregullores 12. Nr. 344-50040.<br>Pikësynim kryesorë gjatë kësaj periudhe ka qenë largimi i transportuesve ilegal në veçanti kombi-buste të cilët ushtrojnë veprimtarin transportuese të udhëtareve pa licencë që është në kundërshtim me rregulloret në fjalë.<br>• Mbikëqyrja e kompanive të transportit në komunikacionin rrugorë, orari i udhëtimit, lejet e operimit, rendet e udhëtimit, stacionet, parkingjet etj.<br>• Janë kryer edhe punë tjera sipas kërkesave dhe nevojave në teren.<br>• Janë inspektuar kompanitë e licencuara për transportin e udhëtarëve, janë konstatuar disa parregullsi tek kompanitë transportuese, ku janë evidentuar me procesverbale dhe në bazë të procesverbaleve janë marrë masa sipas Ligjit në fuqi<br>• Janë inspektuar OE të transportit lidhur me respektimin e masave COVID-19 te rekomanduara nga IKSHP dhe Ministria e Shëndetësisë. |

| | |
|---|---|
| | • Inspektimet janë kryer me asistimin e Policisë së Kosovës –Drenas për transportuesit e licencuar dhe transportuesit ilegal, ku kemi pas agjenda të përbashkëta.<br>• Janë kryer edhe punë tjera sipas kërkesave dhe nevojave në teren.<br>Në vijim paraqesim në mënyrë tabelore raportin e punës:<br><br>Procesverbale **75, g**joba mandatorë**2x800=1600€, p**ërjashtime nga komunikacioni **19,** konfiskime të tabelave**19**<br><br>Inicime në Gjykatën Themelore-Drenas **4,** pezullime nga Gjykatën Themelore-Drenas, vërejtje **2,** kontrolle/inspektime-asistime **121+76 =197**<br><br>Gjatë vitit 2022-të në bashkëpunim me Policinë e Kosovës njësiti në Drenas do të ketë inspektime më të shtuara për largimin e transportit ilegal te udhëtareve . |

**Gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2021 janë realizuar:**

| | |
|---|---|
| **-Inspektime.........................................................................** | **1411** |
| **-Aktvendime për izolim (COVID-19).......................................** | **2214** |
| **-Anulime të Aktvendime për izolim (COVID-19)..................** | **698** |
| **-Aktvendime për ndërprerje të punimeve...............................** | **87** |
| **-Objekte tek të cilat janë ndërpre punimet por janë pajisur me leje ndërtimore...............................................................** | **36** |
| **-Kallëzime penale.................................................................** | **21** |
| **-Draft-urdhër për ekzekutim ..................................................** | **38** |
| **-Pëlqime për ushtr. veprimtarisë dhe sanitare........................** | **30** |
| **-Konfiskim i tabelave të automjeteve.......................................** | **19** |
| **-Gjoba mandatore...................................................................** | **58** |
| **-Shuma e gjobave mandatore....................................................** | **62.570 €** |

## 3.6.DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa, gjatë periodës janar- dhjetor /2021, punët dhe detyrat e punës i ka kryer duke u bazuar në Plan-programin e punës, të mbështetur në Ligjin për Menaxhimin e Financave publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L-048, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal nr. 03 / L-049, Ligjin për vetëqeverisjen Lokale nr. 03 / L-040, rregulloret, vendimet, udhëzimet e MEF-it dhe Kuvendit të Komunës, si dhe në bazë të detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me Statutin e Komunës së Drenasit.

Kjo drejtori, punën e vetë kryesisht e ka orientuar në këto lëmi:

- raporti i punës dhe financiar për vitin 2021,
- pasqyrat financiare 2021,
- procesi buxhetor-Strategjia Fiskale 2022-2024, sipas kërkesave të Drejtorive,
- aprovimi i shpenzimeve dhe certifikimi për buxhetin komunal sipas programeve,
- kryerja e pagesave lidhur me shpenzimet operative dhe kapitale, si dhe barazimi me raportet e SIMFK,
- punët lidhur me arkën e parave të gatshme ( arkëtimi dhe pagesat),
- regjistrimi në sistemin kompjuterik i të gjitha të hyrave të arkëtuara nga burimet vetanake dhe barazimi ditor, javor, mujor dhe periodik me SIMFK,
- autorizimi i shpenzimeve për D.B.F
- përcjellja e të hyrave publike të akorduara nga B.K.K,
- përgatitja e transfereve të parave të depozituara në llogaritë e thesarit të MEF-it,
- caktimi i tatimit në pronë- shpërndarja e faturave për vitin 2021,
- evidentimi i objekteve të reja si pasuri e paluajtshme dhe rimatja e objekteve,
- përgatitja e analizave mujore lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal,
- raporti i punës dhe financiar sipas periodave të vitit /2021,
- propozim Korniza Afatmesme Buxhetore 2022-2024,
- shlyerja e pagesave për tatimin në pronë,
- plotësimi i formularëve për buxhetin 2022-2024, sipas kërkesave fillestare,
- Trajnimin e punëtoreve të D.B.F,
- punë dhe detyra tjera të punës për pushtetin lokal dhe qendror,
- punët me palë në lëmin e buxhetit dhe financave.

Struktura e përgjithshme organizative për funksionet e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, tani më është e bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin për Vetëqeverisjen lokale, Statutin e Komunës, sipas Sektorit të Buxhetit, Thesarit dhe Financave.

1. **Sektori i Buxhetit .-** Për periodën janar-dhjetor/2021, ka kryer këto punë dhe detyra pune:

- zhvillimi i aktivitetit lidhur me planifikimin e buxhetit komunal 2022-2024, sipas kërkesave fillestare,
- përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2022-2024
- vërtetime tjerë për qytetaret
- lidhur me rregullimin e dokumentacionit,

- numri i kërkesave të regjistruara dhe koduara për shpenzime nga shfrytëzuesit e buxhetit komunal ,
- lëshimi i fletëpagesave sipas kërkesës së palëve,
- ruajtja e data bazës për të dhënat e regjistruara,

- objektet e reja të matura – rimatura,
- fatura të shpërndara përmes poste,
- numri i ankesave të pranuara ,
- pranimi i kërkesave për regjistrimin e objekteve të reja,

2. **Sektori i Thesarit.-** Në këtë sektor, punët dhe detyrat e punës për periodën janar-dhjetor/2021, janë kryer si vijon:

- Është bërë arkëtimin e parave të imta për shërbime në ofiqari, arkiv, Gjeodezi, Urbanizëm, shërbimet e pagesës se tatimit në pronë, dhe për shpallje të tenderëve - shërbime për arkëtim të parave të imta. Përveç arkëtimit, është bërë përgatitja dhe depozitimi ditor i parave në llogarinë bankare të Komunës.
- regjistrimi i të hyrave vetanake të arkëtuara është bërë për çdo ditë në data bazë dhe në sistemin e Free- balancit,
- tansferi i të hyrave vetanake nga llogaria bankare komunale në llogari të thesarit MEF për çdo fund muaji,
- barazimi i raporteve të arkës me raportet e bankës dhe kontrollimi i tyre për çdo ditë,
- hartimi i raporteve mujore për të hyrat vetanake për nevoja të ekzekutivit dhe MEF-së,
- zotimi i parave publike për qëllime të pagimit të shpenzimeve operative dhe kapitale, sipas modulit të blerjes, dhe sipas modulit të aprovimit,
- kryerja e pagesave nga buxheti i Sektorit të Përgjithshëm (drejtoritë dhe zyrat komunale) për të gjitha lëndët që kanë qenë të kompletuara. Vlen të cekët se 100% e lëndëve të pranuara në zyrën e pagesave janë procesuara për pagesë,
- Certifikimi UOP për të gjitha kategoritë: 4,484,
- Certifikimi i UOP për Komunali 1,914,
- Aprovimi i avanseve për para të imta 77,
- Certifikimi i UOP për mallra dhe shërbime 2068,
- Certifikimi i UOP për Subvencione 143,
- Certifikimi i UOP për shpronësime 66,
- Certifikimi i UOP për Investime Kapitale 216
- Totali i UOP 4,484,
- përgatitja e analizave mujore lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal sipas sektorëve kryesor dhe programeve.

3. **Sektori i Financave**.- Në periodën janar-qershor /2021, përmes Sektorit të Financave janë kryer këto punë dhe detyra pune:

- Përgatitja e pasqyrave financiare për vitin /2021,
- certifikimi i dokumentacionit financiar për buxhetin komunal sipas programeve – drejtorive dhe zyrave komunale me modulin e blerjes 4,848,
- certifikimi i lëndëve për pagesë sipas modulit të aprovimit 1,653,

- përgatitja e regjistrit të faturave të paguara për dosjet e dokumentacionit financiar, për vitin 2021.
- është mbajtur evidencë analitike për të gjitha lëndët e certifikuara sipas shpenzimeve veç e veq,4,848
- raporti i punës-financiar për periodën Janar-Mars /2021
- raporti i punës-financiar i periodës janar-qershor/ 2021,
- raporti i punës dhe financiar janar - shtator 2021
- raporti i punës dhe financiar janar-dhjetor 2021
- plani i punës për vitin 2021,

**4. Zyra e Tatimit në Pronë**

- Raste të reja 428,
- Verifikim Tereni 2,238,
- Lëndë të miratuara intranet 11,228,
- Pagesa të pranuara në arkë 12,426
- Certifikata të pagesës për TPr 13,717
- Shpronësimet dhe ndërrimet e pronarëve 37
- Korrigjime dhe kalkulim manuale të pagesave 1,225
- Ri programim i marrëveshjeve 19
- Certifikata për jo tatimpagues 622,
- Lidhja e marrëveshjeve për pagës me këste 19,
- Shqyrtimi i kërkesave për korrigjim 29,
- Leshuarja e faturave në mënyrë manuale 9,112,

Nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, për periodën raportuese( janar-dhjetor /2021), janë kryer edhe shumë punë dhe detyra tjera të punës që nuk janë evidentuar më lartë e të cilat kanë ndihmuar punën e Bordit të Drejtorëve, Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendin e Komunës.

## 3.7.DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Situata Epidemiologjike në Komunën e DRENAS-it lidhur me PANDEMINË COVID-19, nga Marsi 2020, deri me dt. 29 dhjetor 2021

| | | |
|---|---|---|
| Gjithsej raste TEST POZITIVE SARS-COV-2 | 3445 | 100.00% |
| Gjithsej raste AKTIVE SARS-COV-2 | 5 | 0.15% |
| Gjithsej raste te SHERUARA | 3351 | 97.27% |
| &EX& | 89 | 2.58% |

Perfshirja e Infeksionit me SARS-CoV2 Drenas sipas gjinisë

| M | F | Totali |
|---|---|---|
| 1760 (51%) | 1685 (49%) | 3445 |

Epidemiologjia me Test Pozitiv në SARS-CoV2 sipas grup moshave 2020-2021 Drenas

| Deri 20 vjeç | | 21 deri 40 vjeç | | 41 deri 60 vjeç | | 61 deri 80 vjeç | | mbi 80 vjeç | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| M | F | M | F | M | F | M | F | M | F |
| 140 | 117 | 681 | 671 | 602 | 561 | 290 | 309 | 48 | 26 |
| 257 (7.4%) | | 1352 (39.2%) | | 1163 (33.7%) | | 599 (17.3%) | | 74 (2.1%) | |
| 3445 | | | | | | | | | |

| Nr.R. | Muajt | Gjinia | | Excitus | Totali: |
|---|---|---|---|---|---|
| | | M | F | | |
| 1 | Janar 2020 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Shkurt 2020 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 3 | Mars 2020 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 4` | Prill 2020 | 1 | 1 | 0 | 2 |
| 5 | Maj 2020 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 6 | Qershor 20 | 17 | 9 | 0 | 26 |
| 7 | Korrik 2020 | 98 | 70 | 9 | 168 |
| 8 | Gusht 2020 | 89 | 61 | 18 | 150 |
| 9 | Shtator 2020 | 31 | 21 | 2 | 52 |
| 10 | Tetor 2020 | 48 | 40 | 1 | 88 |
| 11 | Nëntor 2020 | 170 | 134 | 5 | 304 |
| 12 | Dhjetor 20 | 191 | 137 | 14 | 328 |
| 1 | Janar 2021 | 82 | 60 | 4 | 142 |
| 2 | Shkurt 2021 | 61 | 31 | 5 | 92 |
| 3 | Mars 2021 | 113 | 132 | 4 | 245 |
| 4 | Prill 2021 | 107 | 122 | 6 | 229 |
| 5 | Maj 2021 | 22 | 28 | 1 | 50 |
| 6 | Qershor 21 | 0 | 2 | 2 | 2 |
| 7 | Korrik 2021 | 9 | 11 | 0 | 20 |
| 8 | Gusht 2021 | 522 | 578 | 5 | 1100 |
| 9 | Shtator 2021 | 185 | 234 | 13 | 419 |
| 10 | Tetor 2021 | 7 | 7 | 0 | 14 |
| 11 | Nëntor 2021 | 6 | 3 | 0 | 9 |
| 12 | Dhjetor 21 | 2 | 3 | 0 | 5 |
| Totali | | 1761 | 1684 | 89 | 3445 |

**VDEKSHMËRIA - MORTALITETI në CoV-19**

**Drenas 2020-2021**

| Deri 20 vjeç | | 21 deri 40 vjeç | | 41 deri 60 vjeç | | 61 deri 80 vjeç | | mbi 80 vjeç | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| M | F | M | F | M | F | M | F | M | F |
| 0 | 0 | 4 | 0 | 8 | 6 | 31 | 26 | 10 | 4 |
| 0 | | 4 | | 14 | | 57 | | 14 | |
| 89 | | | | | | | | | |




**I.** **<u>Pandemia COVID-19 (të dhëna me aktivitete tjera shtesë jashtë të dhënave të lartëshenuara):</u>**

1. Nga 13 Marsi 2020 tri (3) ekipe tona kanë kontrolluar hyrje-daljet në pikën ajrore te R.Kosovës Aeroportin Nderkombëtar “Adem Jashari”, e sipas nevojës edhe në pika tjera të hyrjeve tokësore kufitare.
2. <u>Vala e pare (120 ditë-4muaj 2020, ka përfshi 12% të Infeksioneve</u>) e Pandemisë me COVID-19 nga Qershori, Korrik, Gusht dhe Shtator ka pasë:
   - Të Infektuar: 396,Vizita mjekësore 2099,Shërbime mjekësore 3898, Totali 5997.
3. <u>Vala e dytë (120 ditë-4 muaj 2020, ka përfshi 28% të infeksioneve</u>) e Pandemisë me COVID-19 nga Tetori, Nëntor, Dhjetor 2020 e Janar 2021:
   - Të Infektuar:954, Vizita mjekësore 5056, Shërbime mjekësore 9390, Totali 14446.
4. <u>Vala e tretë (90 ditë-3 muaj, ka përfshi 15% të infeksioneve</u>) e Pandemisë me COVID-19 nga <u>Marsi, Prill dhe Maj 2021:</u>
   - Të Infektuar: 526, Vizita mjekësore 2788, Shërbime mjekësore 5177, Totali 7968.
5. <u>Vala e katërt-Delta (120 ditë-4 muaj, ka përfshi 45% të infeksioneve</u>) e Pandemisë me COVID-19 nga Korrik, Gusht, Shtator, Tetor 2021:
   - Të Infektuar: 1546, Vizita mjekësore 8194, Shërbime mjekësore 15217, Totali 23411.

   **<u>Pra në totalin peiudhës 19 Mujore (570 ditore) me COVID-19, nga Marsi 2020 – Dhjetor 2021 janë realizuar gjithsej 18137 vizita mjekësore</u>** (duke i përfshi edhe ato shtëpiake), **<u>shërbime shëndetësore 33682</u>** (terapi orale, terapi infusive, dhënje e medikamenteve parenterale, oksigjenoterapi, inhalime, kontrolli i sheqerit në gjak, sherbimet e referuara QKUK dhe aktivitete tjera) ose **<u>51819 vizita e sherbime</u>**.

**II.** **<u>Situata Epidemiologjike në Drenas deri sot (30.12.2021) të Infektuar janë: 3445 test Pozitiv, raste Aktive 5 (0.15%), të shëruar 3351 (97.27%) dhe vdekshmëria është 2.5% (ose 89 raste gjithsej).</u>**

**III.** **<u>Testimi i qytetarëve me shenja klinike COVID-19</u>**

- Gjithsej të testuar me Teste Serologjike SARS-CoV-5 (IgM dhe IgG) mbi 7000 të testuar në QKMF Drenas, vazhdon në kontinuitet.
- Gjithsej të testuar me teste të shpejta Rapide mbi 6000 nëper Institucionet e KPSH Drenas, vazhdon në kontinuitet.
- Gjithsej të testuar RT-PCR 3445 qytetarë nga IKSHP Kosovës, vazhdon në kontinuitet.
- **Gjithsej Testime për Covid-19 janë 16445 qytetarë të testuar.**

IV. **<u>Vaksinimi i qytetarëve me Vaksina kundër Covid-19 (Pfizer dhe AstraZeneca</u>**)

- Të vaksinuar gjithsej :42061.
- Të vaksinuar me dozen e parë (I-rë) 16616.
- Të vaksinuar me dozen e dytë (II-të): 25445.

**Pako Ushqimore dhe Higjenike COVID-19 / 2021 për kategoritë në nevojë:**

I. **<u>Pako Ushqimore dhe Higjenike dhe MIELL, nga Buxheti Komunal:</u>**

1. **PAKO: 2120 pako ushqimore-higjenike**
2. **MIELL: 2231x25=55.775 kg.**
3. **Miell: 01.11.2021= 12.500 kg miell,**

***II.*** ***<u>Donacione me Miell: 54.225 kg.</u>***

***<u>Donacione me pako ushqimore e higjenike : 1772 pako</u>***

***Donacone me material Mbrojtese Personale - Anti COVI-19 = 4929***




**Kujdesi Parësorë Shëndetësor**

## QENDRA KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE, ‚Dr.HAFIR SHALA" Drenas

Qendra kryesore e mjekësisë Familjare ne bazë të infrastrukturës dhe strukturës organizative ofron shërbime shëndetësore në gjithë teritorin e Komunës së Drenasit në bazë të konceptit të mjekësisë familjare. Këto sherbime shëndetësore janë gjithëpërfshirëse për të gjitha grup moshat . Kujdesi shëndetësor në bazë të rrethanave të kohës dhe përparimit të teknologjisë ka një qasje të avancuar në aspektin e trajtimit dhe përkujdesjes shëndetësore, është një kohë e transformimit dhe një qasje gjithëpërfshirëse shëndetësore, mirqenies sociale, ekonomike, epidemiologjike dhe rehabilituese.

**<u>Detyrat e përgjithshme Ligjore dhe statuore të QKMF-së</u>**

-Zbaton ligjin për shëndetsi me qëllim të ruajtjes dhe përparimit të shëndetit të qytetarëve

-Zbaton politikat shëndetësore të hartuar nga DSHMS

-Zbaton planin operativ te propozuar nga Kuvendi Komunal përmes DSHMS-se

-Bënë Planifikimi i nevojave për resurse humane profesionale në harmoni me politikat shendetësore Qendrore dhe Lokale.

-Shfrytzimi racional i buxhetit të aprovuar nga K.Komunal në bashkpunim me DSHMS-le

-Organizimin e punës në kujdesin parësor shëndetësor me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore profesionale dhe cilësore.

-Respektimi i protokoleve dhe udhërrëfyesve klinik përcjell trendin e trajtimit të sëmundjeve dhe Diagnostifikimit.

-Zbaton udhëzimet administrative për kujdes parësor te hartuara nga Ministria e Shëndetësisë.

-Vlerson nevojat lokale në bazë të të dhënave dhe parashtron DSHMS-le për hapat e veprimit

-Raporton për situatën epidemiologjike DSHMS –në në mënyrë që të monitorohen situatat nga DSHMS-le.

-Bashkpunimi me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare që kan për qellim perparimin e shëndetit në kujdesin parësor shëndetësorë.

KPSH- Bazohet në ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore dhe të sigurta,të ndërtuara mbi parimet e konceptit të Mjekësisë familjare,të drejtuara nga nevojat dhe kërkesat e individëve, familjeve dhe bashkësisë, me synim të promovimit ruajtjes dhe përmirsimit të shëndetit për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës respektivisht Komunës së Drenasit. Duke u bazuar në Ligjin e Shëndetësisë së Kosovës si dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale i cili ka inkorporuar në tërësi konceptin e Mjekësisë Familjare duke e definuar atë si "formë themelore e ofrimit të shërbimeve shëndetësore gjithëpërfshirëse në nivelin parësor të kujdesit shëndetësor, për individët dhe familjet e tyre", KPSh në Komunën e Drenasit shëbimet shëndetësore i ofron në bazë te konceptit të Mjekësisë Familjare bazuar në legjislacionin në fuqi. Edhe në periudhën e raportimit KPSh ka ndihmuar që shërbimet shëndetësore të ofrohen edhe per pacient te komunave tjera ne bazë të

vendimimit të QK per situaten e Pandemisë COVD 19 të drejten e qytetarëve të RK për ofrim të kujdesit shendetësorë nga të gjitha Institucionet shëndetësore. Situata e krijuar me pandeminë COVID-19 pothuajese gjatë gjithë vitit ka pas ndikim në të gjitha aspeket e veprimtarisë së QKMF dhe dukshëm ka dëmtuar realizimin e planit dhe objektivat të parashtruara.Kjo situate ka ndikuar edhe në aspektin e cilësisë së sherbimeve shendetësore.Në ketë vit per shkak të ndarjes së specializimeve nga MSH per nivelin dytësorë dhe interesimi i ulët per specializim për nivelin parësor, numri i profesionistëve shëndetësor nga dhjetori I vitit 2020 deri në prill 2021 kemi pasur zvoglim të personelit doktorë të mjeksisë pe 40%.dhe ka krijuar veshtersi në ofrimin e vizitave mjekësore dhe cilësin e tyre. Një studim i organizuar nga Agjencioni për Bashkëpunim Zviceran dhe e implenetuar nga Projekti i AQH ka treguar se ofrimi i shërbimeve me theks në Sëmundjet Kronike Masovike Jo Ngjitëse por dhe në fushat tjera ka treguar se nevojitet përmirësim dhe vetëdijësim, si nga ana e personelit shëndetësor ashtu edhe të komunitetit në mënyrë që të parandalohen dhe trajtohen këto patologji duke siguruar një efiçiencë më të mirë të shërbimeve, parandalimin e sëmundëshmërisë si dhe përmirësimin e kualitetit të jetës. Disa mjete (instrumente) për përmirësimin e cilësisë janë promovuar si një domosdoshmëri për përmirësimin e performancës se intitucionit. Poashtu edhe vlerësimi i përformancës së stafit ka filluar me një qasjë më bashkëkohore. Përkunder ketyre veshtersive me perkrahje nga niveli Komunal dhe DSHMS në planifikimin e aktiviteteve bazur në resureset në dispozicion kemi arritur që të ofrojmë kujdes shëndetësor për të gjithë banoret e Drenasit.

**OBJEKTIVAT e K.P.Sh. përmes QKMF- së "Dr Hafir Shala" Drenas**

Bazuar në legjislacionin në fuqi si dhe misionin që ka QKMF si objektivin startegjik për vitin 2021 e ka përkufizuar si: Sigurimi i shërbimeve shëndetësore themelore dhe cilësore të ofrohen në kuadër të KPSh dhe duke u bazuar në konceptin e Mjekësisë Familjare.

Ojektivat specifike:

- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore
- Forcimi i kapaciteteve profesionale, të menaxhimit dhe llogaridhënjës
- Zhvillimi i resurseve humane
- Promovimi shëndetësore dhe pjesëmarrja e komunitetit në shërbimet e ofruara
- Përmirësimi i komunikimit ndërsektorial dhe ndërinstitucional
- Fuqizimi i i punës ekipore
- Evaluimi dhe monitrorimi

Objektivat janë zbatuar duke u udhëhequr nga parimet :

- Barazia
- Cilësia
- Ndershmëria dhe përgjegjësia

- Gjithëpërfshirja dhe jo diskriminimi
- Financimi i qëndrueshëm
- Financimi kosto-efektiv
- Bashkëfinancimi

**<u>Veprimtaria e KPSH sipas Ligjit për Shëndetësi është e përcaktuar (në 12 grupe shërbimesh, 105 Aktivitete dhe 148 nënaktivitete shëndetësore):</u>**

1. Shërbimet e promovimit shëndetësor duke përfshi informimin, komunikimin dhe edukimin (5 aktivitete dhe 8 nënaktivitete).
2. Shërbimet e imunizimit dhe vaksinimit e shërbimet tjera parandaluese (10 akvitete dhe 23 nënaktivitete).
3. Shërbimet e kujdesit Urgjent dhe emergjent (16 aktivitete dhe 8 nënaktivitete).
4. Shërbimet për sëmundjet acute dhe kronike (4 aktivitete dhe 35nënaktivitete).
5. Shërbimet shëndetësore për fëmijë dhe adoleshent (10 aktivite dhe 11 nënaktivitete).
6. Shërbimet e kujdesit për gruan dhe shëndetin riprodhues (1 aktivitet, 6 nënaktivitete e 17 hapa)
7. Shërbimet e shëndetit oral parandalues (7 aktivitete dhe 23 nënaktivitete).
8. Shërbimet e shëndetit mendor (4 aktivitete e 16 nënaktivitete).
9. Shërbimet e kujdesit shtëpiak, përfshirë shërbimet për nëna, fëmijë dhe kujdesit terminal/paliativ (3 aktivitete e 11 nënaktivitete).
10. Shpërndarja e barërave nga Lista Esenciale (1 aktivitet dhe 7 nënaktivitete).
11. Shërbimet laboratorike hematologjike-biokimike ( QKMF: 34 aktivitete-analiza, QMF: 29 analiza) dhe AMF 7 analiza).
12. Shëbimet Imazherike QKMF (5 aktivitete radiologjike +1aktivitet shtesë-mamografia dhe 5 aktivitete Ultrasonike).

STRUKTURA ORGANIZATIVE NË QENDRËN KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE

“Dr hafir Shala” - DRENAS




Në tabelen poshtëshenuar janë të pasqyruar numri I personelit shendetësor gjatë vitit.Nga kjo mund të verehet se kemi pasur levizje të personelit shendetësor krahasuar me planifikimin, arsyeja qendron se një numer i mjekëve per arsye të specializimit ka shkëputur kontraten me njësin punuese pa paralajmrim me vetëdeshirë. Ne rrethana të tilla janë krijuar kushte për procedurat e rekrutimit me kohë, duke marrë parasysh qe një procedur e konkursit per personel public merr kohë deri në 45 ditë (30+15) e tutje deri në shpallje të rezultateve (pothuaj 60 ditë)- janë shpallur gjithsej 3 konkurse deri në plotësim të vendeve të lira për doktor. Kjo qasje është e shprehur ne diagram dhe kurben e paraqitur më poshtë.

Numri I punetoreve aktiv ne QKMF sipas muajve

| Mujt e vitit | Planifikim-Realizimi 2020 | Situata e krijuar 2021 | Real. % |
|---|---|---|---|
| Jan | 181 | 175 | 96.69 |
| Shk | 181 | 170 | 93.92 |
| Mar | 181 | 170 | 93.92 |
| Pri | 181 | 163 | 90.06 |
| Maj | 181 | 162 | 89.5 |
| Qer | 181 | 162 | 89.5 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Kor | 181 | 169 | 93.37 |
| Gsh | 181 | 168 | 92.82 |
| Sht | 181 | 177 | 97.79 |
| Tet | 181 | 175 | 96.69 |
| Nën | 181 | 173 | 95.58 |
| Dhj | 181 | 173 | 95.58 |
| TOTALI | 2172 | 2037 | 93.78 |







**Aktivitetet në realizimin i objektivave -** Duhet të potencohet se shumica e aktiviteteve të cilat i mbulohen si pasojë e shpalljës së Emergjencës mjekësore shkaktuar nga Pandemia SARS-COV-2 dukshëm ka ndikuar në realizimin e objektivave parashtruara si dhe Planin e Punës për vitin 2021. Situata e krijuar ka pas ndikim në të gjitha Deparatementet, Sektoret dhe njësit Organizative. Por edhe përkundër gjendjës së krijuar QKMF me rrjetin e institucioneve në vazhdimësi ka ofruar të gjitha shërbimet në kuadër të mandatit, e nganjëherë në forma të redukuara. Siguria e personelit dhe pacientëve ka qenë një nga sfidat kryesore në organimzimin e aktiviteve me theks në periudhën korrik -shtator ku si pasoj e situatës së krijuar me pandeminë jemi ballafaquar më sfida të shumta në të gjitha segmentet e ofrimit të shërbimeve. Sido që të jetë, si objektiv strategjik ka qenë riorganizimi dhe menagjimi i aktiviteteve si në Departamente/Sektore, poashtu edhe në rrjetin e Institucioneve të KPSh hapjen e Qendres per trajtimin e pacientëve COVID19. Kryerja e shërbimeve shëndetsore të pacientëve gjatë kohës së pandemisë COVID-19 duke marrë parasysh rekomandimet, udhëzimet

nga MSH, IKSHP, OBSH dhe Shtabit Komunal Emergjent- Drenas. Fillimisht është marrë vendim nga shtabi emergjent i KK Drenas 30.07.2021 që të vendoset trajtimi i pacientëve në objektin qendrës për në Objektin e Qendres pë performancën e gruas duke e funksionalizuar objektin me 22 shtretër si dhe dhomën e Konsultimeve e hapsirën per trajtim me paisjeve të nevojshme percjellëse (EKG, Oxigjen concen.glikometer,inhalator, testime) pastaj, hapsirat për LEB dhe furnizim me barna nga bugjeti Komunal për trajtim e pacientëve ne bazë të Protokollit për trajtimin e COVID19. Synim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të ofruara duke ju përshatur situatës se krijuar nga pandemia me COVID-19, si dhe ngritjen e përgjegjesisë dhe llogaridhënjës.

**Aktivitetet sipas departamenteve dhe sektoreve**

**Departamenti i Mjekësisë Familjare**

**Sektori i Mjekësisë Familjare**

Si sektor më i madh në aspektin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore, burimeve njerëzore, objekteve dhe hapësirave punuese ky sektor edhe ne vitin 2021 ka qenë një nga bartësit kryesor të aktiviteteve dhe implementimit të konceptit të Mjekësisë Familjare. Një nga objektivat ka qenë ngritja e cilësisë së shëbimeve të ofruara si dhe shërbimet me pacientin në qendër. Që nga muaji Mars jemi përballur me mungesë të profesionistëve shendetësor (Doktor të mjekësisë) për arsye të shkuarjes në specializime si dhe shkuarja 3 Mjekë familjar në Qendrat tjera komunale të KPSH. Per arsye të situatës së krijuar kemi riplanifikuar terheqjen e disa doktoreve nga AMF-të me qellim që te ofrohen vizita shendetsore në 2 (dy) qendra 24 orë ne QMF Komoran dhe QKMF Drenas per të pasur qasje në sherbime shendetësore më të qasëshme në ç'do kohë. Duke marrë parasyshë këtë situatë të imponuar, qasja ne sherbime shendetësore ka qenë e veshtersuar ne pjeset periferike të Komunes së Drenasit,por rastet paliative dhe personat që nuk kan mundur te kenë qasje në shërbime shendetsore neper disa AMF janë trajtuar nga ekipet mobile për shendet paliativ.

| | QKMF - Drenas M.F | QMF - Komoran M.F | QMF - Arllat M.F | QMF - Terstenik M.F | QMF - Gllanasellë M.F | QMF - Baicë M.F | AF - Nekoc M.F | AF - Sankoc M.F | AF - Paklek / Vasilevë M.F | AF - Dobroshec M.F | AF - Abri e Epërme M.F | AF - Terdec M.F | AF - Gradicë M.F |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Totali i Vizitave | 41480 | 34347 | 2206 | 405 | 1289 | 134 | 443 | 11 | 0 | 289 | 0 | 0 | 77 |
| Injektimi IM (A55.00) | 26766 | 14954 | 1080 | 756 | 558 | 524 | 165 | 2 | 0 | 179 | 0 | 496 | 7 |
| Injektimi IV (A55.00/2) | 1265 | 678 | 10 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 0 |
| 00000 - NUK PERDORET | | 0.00 | 63,560.00 | |
| 50011 - TAKSA PËR REGJISTRIMIN E TRASHËGIMISË - NDËRRIMI I PRONARIT | | 0.00 | 40,307.00 | |
| Bilancet e Hapura | | 0.00 | 0.00 | |
| Totali për periudhën | 1 | 0.00 | 1,767.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 1,767.00 | |
| Totali për periudhën | 2 | 0.00 | 1,342.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 3,109.00 | |
| Totali për periudhën | 3 | 0.00 | 2,693.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 5,802.00 | |
| Totali për periudhën | 4 | 0.00 | 2,445.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 8,247.00 | |
| Totali për periudhën | 5 | 0.00 | 4,123.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 12,370.00 | |
| Totali për periudhën | 6 | 0.00 | 3,360.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 15,730.00 | |
| Totali për periudhën | 7 | 0.00 | 3,525.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 19,255.00 | |
| Totali për periudhën | 8 | 0.00 | 5,982.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 25,237.00 | |
| Totali për periudhën | 9 | 0.00 | 3,464.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 28,701.00 | |
| Totali për periudhën | 10 | 0.00 | 3,676.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 32,377.00 | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Totali për periudhën | 11 | 0.00 | 4,589.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 36,966.00 | |
| Totali për periudhën | 12 | 0.00 | 3,341.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 40,307.00 | |
| 50012 - TAKSA PËR NDËRRIMI I DESTINIMIT TË TOKËS | | 0.00 | 22,264.00 | |
| Bilancet e Hapura | | 0.00 | 0.00 | |
| Totali për periudhën | 1 | 0.00 | 533.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 533.00 | |
| Totali për periudhën | 2 | 0.00 | 1,734.50 | |
| Bilanci | | 0.00 | 2,267.50 | |
| Totali për periudhën | 3 | 0.00 | 1,556.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 3,823.50 | |
| Totali për periudhën | 4 | 0.00 | 1,229.50 | |
| Bilanci | | 0.00 | 5,053.00 | |
| Totali për periudhën | 5 | 0.00 | 1,366.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 6,419.00 | |
| Totali për periudhën | 6 | 0.00 | 1,021.50 | |
| Bilanci | | 0.00 | 7,440.50 | |
| Totali për periudhën | 7 | 0.00 | 1,905.50 | |
| Bilanci | | 0.00 | 9,346.00 | |
| Totali për periudhën | 8 | 0.00 | 3,009.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 12,355.00 | |
| Totali për periudhën | 9 | 0.00 | 5,829.50 | |
| Bilanci | | 0.00 | 18,184.50 | |
| Totali për periudhën | 10 | 0.00 | 1,772.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 19,956.50 | |
| Totali për periudhën | 11 | 0.00 | 1,207.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 21,163.50 | |
| Totali për periudhën | 12 | 0.00 | 1,100.50 | |
| Bilanci | | 0.00 | 22,264.00 | |
| 50019 - TAKSA TJERA ADMINISTRATIVE | | 0.00 | 193.00 | |
| Bilancet e Hapura | | 0.00 | 0.00 | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Totali për periudhën | 1 | 0.00 | 193.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 193.00 | |
| Totali për periudhën | 2 | 0.00 | 0.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 193.00 | |
| Totali për periudhën | 3 | 0.00 | 0.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 193.00 | |
| Totali për periudhën | 4 | 0.00 | 0.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 193.00 | |
| Totali për periudhën | 5 | 0.00 | 0.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 193.00 | |
| Totali për periudhën | 6 | 0.00 | 0.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 193.00 | |
| Totali për periudhën | 7 | 0.00 | 0.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 193.00 | |
| Totali për periudhën | 8 | 0.00 | 0.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 193.00 | |
| Totali për periudhën | 9 | 0.00 | 0.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 193.00 | |
| Totali për periudhën | 10 | 0.00 | 0.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 193.00 | |
| Totali për periudhën | 11 | 0.00 | 0.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 193.00 | |
| Totali për periudhën | 12 | 0.00 | 0.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 193.00 | |
| 50504 - TAKSA PËR MATJEN E TOKËS NË TEREN | | 0.00 | 796.00 | |
| Bilancet e Hapura | | 0.00 | 0.00 | |
| Totali për periudhën | 1 | 0.00 | 110.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 110.00 | |
| Totali për periudhën | 2 | 0.00 | 18.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 128.00 | |
| Totali për periudhën | 3 | 0.00 | 122.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 250.00 | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Totali për periudhën | 4 | 0.00 | 220.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 470.00 | |
| Totali për periudhën | 5 | 0.00 | 21.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 491.00 | |
| Totali për periudhën | 6 | 0.00 | 20.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 511.00 | |
| Totali për periudhën | 7 | 0.00 | 22.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 533.00 | |
| Totali për periudhën | 8 | 0.00 | 103.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 636.00 | |
| Totali për periudhën | 9 | 0.00 | 80.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 716.00 | |
| Totali për periudhën | 10 | 0.00 | 0.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 716.00 | |
| Totali për periudhën | 11 | 0.00 | 80.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 796.00 | |
| Totali për periudhën | 12 | 0.00 | 0.00 | |
| Bilanci | | 0.00 | 796.00 | |
| Total Balance | | 0.00 | **63,560.00** | |

## 3.10. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

| Objektivat | Aktivitetet | Bartësit e aktiviteteve | Afati Kohor | Buxheti ( burimet financiare ) |
|---|---|---|---|---|
| 1.Shërbimet Publike | | | | |
| Hartimi i planit buxhetor dhe hartimi i raporteve mujore dhe atyre vjetore te Drejtorisë së DSHPE-së<br><br>Hartimi i planit të zotimeve dhe shpenzimeve | Hartimi i planit buxhetor për vitin në vijim | Shefat e sektorëve | Hartimi i Planit buxhetor behët gjatë periudhës Maj Qershor-Shtator, ndërsa hartimi i raporteve behët në baza ditore, javore dhe mujore, permanent gjatë vitit<br><br>Plani zotimeve në muajin Janar | Buxheti për vitin 2022 i DSHPE-së është : 919,887.00€ |
| Hartimi i planit të punës. | Hartimi i planit të punës për vitin 2022 | Drejtori dhe Shefi i sektorit | Gjatë muajit Dhjetor 2021 | |
| Hartimi i raportit të punës për DSHPE | Hartimi i raportit vjetor të punës | | Janar-Qershor-dhjetor-2022 | |
| Pranimi i kërkesave nga qytetarët. Klasifikimi i kërkesave për sektorët e caktuar brenda DSHPE-se | Pranimi, regjistrimi i kërkesave te adresuara në DSHPE dhe përcjellja e lendeve tek përgjegjësit dhe dhënia e përgjigjeve për palët | Drejtori dhe Shefat e sektorëve dhe zyrtaret e fushave përkatëse | Gjatë tërë vitit | / |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Hartimi i paramasave për projektet kapitale dhe për projektet e mirëmbajtjeve të shërbimeve publike | Hartimi i paramasave për projektet kapitale dhe projekteve që janë të përfshira me buxhetin me Mallra dhe Shërbime | Shefi i sektorit | Prej - janar-Qershor | / |
| Kontaktimi me palet dhe njoftimi me problemin në teren. | Koordinimi me stafin për vizita në lokacione të caktuara për identifikimin e nevojave (problemeve) | Drejtori, shefat e sektorëve dhe zyrtaret e DSHPE-së. | Gjatë tërë vitit | / |
| Sqarime juridike dhe procedurale rreth çështjeve të caktuara . | Koordinimi me drejtoritë përkatëse rreth implikimet në projektet e DSHPES-se | Drejtori, shefat e sektorëve | Permanent gjatë vitit | / |
| Aplikimi në Ministrit e linjës dhe donatoret për fitimin e grandeve për projekte të ndryshme | Kontaktet me donatoret dhe Ministrit e linjës për realizimin e synimeve te projekteve dhe përfitimet nga palët e treta. Përgatitja e projekteve dhe aplikacioneve | Drejtori, shefi i sektorit | Mars- Korrik | / |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Menaxhimi i kryerjes së projekteve në përputhje me kontratat në fuqi. | Mbikëqyrja e projekteve nga menaxheret dhe organet mbikëqyrës, që përfundimi i projekteve të jetë sipas planit dinamik dhe në përputhje me paramasen dhe parallogarin | Drejtori me menaxheret e projekteve dhe organet mbirëse | Permanent gjatë vitit | Buxheti i DSHPE-së, për projekte kapitale është:247,600.00€ , me grande janë: 110,100.00€, ndërsa me të hyra janë:137,500.00€ |
| Përgjegjësit e zyrtareve në përputhje me kryerjen e punëve në teren me qellim të reflektimit pozitiv të qytetaret. | Përcjellja e kërkesave dhe zotimi i mjeteve për të gjitha faktuarat për pagesë për mallra e shërbime dhe shpenzimeve komunale | Drejtori me stafin e DSHPE-së | Permanent gjatë vitit | / |
| Menaxhimi dhe mbikëqyrja e projekteve kapitale dhe atyre të mirëmbajtjes në fushat e përgjegjësive të DSHPE-së | Përcjellja e punimeve në teren dhe përgatitja e raporteve të pranimit për projektet e realizuara në teren dhe kompletimi i lëndëve për procedura të mëtutjeshme për pagesë | Shefat e sektorëve dhe menaxheret e projekteve | | / |
| 2.Sektori Emergjencave | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Kërkesat e adresuara në DSHPE përkatësisht sektorit të Emergjencave i klasifikon dhe ju jep prioritetet e duhura sipas gjendjes në teren. | Plotësimi planeve për Vlerësimin e rrezikut dhe Reagimeve Emergjente sipas legjislacionit në fuqi në koordinim me zyrtar nga Agjencia e menaxhimit të Emergjencave. | Shefat dhe Zyrtaret kompetent | Gjatë vitit 2022 | Subvencionet nga DSHPE në vlerë prej 90,000.00€ |
| Parandalimi i rreziqeve duke bërë identifikimin e zonave të rrezikut në teren me qellim të intervenimit në situata emergjente | Bënë implementimin e Planit të vlerësimit të rrezikut dhe reagimit emergjent sipas standardeve dhe marrja e masave konform situatave të krijuara<br>-Hartimi i paramasës për intervenime emergjente | Shefat e sektorëve, zyrtari dhe Komisioni i caktuar me vendim të Kryetarit të Komunës, për hartimin e planit të Vlerësimit të Rrezikut për Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera | Gjatë muajit mars –Qershor-2022 | Buxheti i DSHPE-së |
| Bashkëpunon me institucionet e sigurisë se përgjithshme Agjencionin për Emergjenca Policinë, Zjarrfikësit, Forcat e Sigurisë së Kosovës,<br><br>Angazhimi i Shtabit | Shkëmbimi i raporteve zyrtare lidhur me çështje të interesit të përgjithshëm. Dalja në teren e komisioneve të autorizuara me qellim te vlerësimit te dëmeve të shkaktuara për | Drejtori dhe shefat e sektorëve dhe zyrtaret kompetent<br><br>Kryetari i komunës dhe anëtaret e Shtabit Emergjent | Permanent gjatë vitit 2022<br><br>Permanent gjatë vitit 2022 | /<br>Buxheti për ndarjen e ndihmave për ekonomi familjare në asistencë Sociale |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| emergjent dhe Komitetit për menaxhimin e Pandemisë Covid-19 | rastet e shkaktuara nga FNFT | | | |
| Koordinimi me akteret kryesor brenda institucionit për situata emergjente në raste të FNFT, dhe Kryetarin e Komunës dhe akteret tjerë të që mund të kontribuojnë në situata të veçanta. | Pranon kërkesat nga tereni për rastet e përfshira nga zjarri, vërshimet dhe FNFT<br><br>Harton raportet e vlerësimit të dëmeve e të shkaktuara në rastet e FNFT dhe Propozim vendimet për kompensimet e dëmeve nga komuna ose institucionet gjegjëse | Kryetari, Drejtori, Shefat e sektorëve dhe zyrtari për emergjenca<br><br>Komisioni i vlerësimit të dëmeve | Gjatë ter vitit 2022 | / |
| 3.Mirëmbajtjen e kanalizimeve, ujësjellësit dhe trajtimi i mbeturinave | | | | |
| Rritja i cilësisë me furnizimit me ujë për banoret që kanë qasje në rrjetin e ujësjellësit në territorin e komunës së Drenasit Koordinohet me njësitin e ujësjellësit "KUR ", "Prishtina" rreth gjendjes se furnizimit në periudha të ndryshme | Në bashkëpunim me KRU,, Prishtina " koordinohen me orarin e reduktimeve dhe bënë publik në ueb faqen zyrtare<br><br>Po ashtu edhe në koordinim me SHZSH-në do të furnizohen | Zyrtari për Ujë dhe Mbeturinave, dhe zyrtari i KUR "Prishtina"<br><br>Drejtori, Shefi i Zjarrfikësve dhe zyrtari për Ujë dhe mbeturina | Gjatë ter vitit 2022 | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| kohore dhe shkaktaret e ndërprerjes se ujit. Po ashtu duhet edhe koordinim me SHZSH, që të ndihmoj me furnizim me ujë për familjet me mungesë të ujit higjienik,<br><br>Mirëmbajtja e kanalizimit atmosferik, fekale dhe gropave septike | rastet kur familjet që kanë mungesë të ujit higjienik<br><br>Përmbushja e kërkesave të qytetarëve në debllokimin e kanalizimeve fekale dhe atij atmosferik në qendër të qytetit dhe vendbanimet e komunës | Shefi i sektorit dhe zyrtari për UM | Gjatë tërë vitit 2022 | Buxheti i DSHPE-së, për mirëmbajte të kanalizimit është 40,000.00€ |
| Mbulueshmëria e të gjitha ekonomive familjare/Bizneseve/ me ofrimin e shërbimit të mbeturinave. Koordinimi me të gjitha drejtorit relevante për këtë projekt, konkretisht me Drejtorin e inspeksionit. | Implementimi i planit për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Drenasit. | Zyrtari për mbeturina ne bashkëpunim me shefat, inspektorin e Mjedisit, Menaxherin e projektit dhe Kompaninë “Pastrimi” | Gjatë tërë vitit 2022 | Buxheti i DSHPE-së, 20,000.00€, për blerje të kontejnerëve |
| Rishikimi i Planit Komunal për menaxhimin e Mbeturinave-2021-2026, si dhe Rishikimi i Rregullores për menaxhimin e mbeturinave, dhe miratimi i tyre në Kuvend, pas | Hartimi i planit Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave dhe i rregullores për mbeturina, se bashku edhe me GIZ-in | Komisioni komunal i caktuar me Vendim të kryetarit të komunës, Shefi i sektorit dhe zyrtari për Mbeturina. | Janar- shtator | Buxheti i DSHPE-së |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| debatit me qytetar | | | | |
| Zbatimi i skemës për ndarje të mbeturinave në burim | Furnizimi i ekonomive familjare me kontejner, për ndarje të mbeturinave. | Kompania “Pastrimi” dhe zyrtari kompetent i DSHPE-së, dhe inspektori i mjedisit | Gjatë vitit 2022 | |
| Trajtimi i deponive ilegale të mbeturinave dhe Mirëmbajta e deponisë për mbeturinat ndërtimore | Identifikimi i deponive ilegale dhe largimi i mbeturinave Hartimi i paramases dhe parallogarisë për këtë projekt | Zyrtari për UM se bashku me Shefin e sektorit | Gjatë muajt Mars- shtator | Buxheti i DSHPE-së 30,000.00€ dhe 20,000.00€ për mirëmbajte të Deponisë Inerte |
| Bashkëpunimi me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Aktivitetet e ndryshme të pastrimit ambientit për ditët e caktuara mjedisore që janë në kalendarin mjedisor | Përgatitja e raporteve për dërgim në MMPH, veçanërisht për Grandin e fazës se tretë<br><br>Aksionet e pastrimit, Mbjellja e drunjve dekorativë, mirëmbajta e hapësirave gjelbëruese | Drejtori dhe Shefi i sektorit dhe zyrtari për menaxhim të mbeturinave<br><br>Drejtoria EDSHPE-së, dhe Drejtoria e Urbanizmit, Zyrtari për Mjedis | Gjatë muajt Mars- Maj | Buxheti shfrytëzohet nga kategoria për Mallra dhe Shpenzime, dhe nga buxheti për mirëmbajte të Sheshit dhe hapësirave publike. |
| Bashkëpunimi me organizatën GIZ, për menaxhimin e mbeturinave dhe donatoret tjerë të mundshëm me qellim të thithjes se donacioneve, lidhur me menaxhimin e mbeturinave | Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm dhe raporteve që kërkohen nga donatoret. | Drejtoria me zyrtaret e DSHPE-së | Shkurt- Qershor | / |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| sidomos të komposterve | | | | |
| 4.Punët e Transportit publik | | | | |
| Menaxhimi i punëve të Transport publik dhe përcjellja e funksionimit të autotaxive | Rritja e cilësisë në transportin publik të udhëtareve<br><br>Caktimin e rendeve të udhëtimit për kompanitë e transportit publik të udhëtarëve dhe respektimi i tyre | Zyrtari për shërbime të transportit lokal. | Janar –Dhjetor 2022 | / |
| Menaxhimi me Stacionin e Autobusëve- deri sa të merret në menaxhim nga kompania e formuar nga Kuvendi i komunës.<br><br>Hartimi i rregullores se re për Transport rrugor | Mbikëqyrja e punëtorëve në realizimin e detyrave të punës gjatë operimit të kompanive të transportit publik të udhëtarëve | Drejtori, Zyrtari për shërbime të transportit lokal.<br><br>Komisioni i caktuar në nivel komunal nga kryetari | Janar –Dhejtor-2022<br><br>Janar-qershor | |
| Mirëmbajtja dhe zgjerimi i vend ndaljeve për autobus dhe mbulimi i tyre | Hartimi i paramasës dhe implementimi i projekti për vend ndaljet e autobusëve | Shefat e sektorëve | Prill -shtator | Buxheti i DSHPE-së, janë të paraparë; 30,000.00€ |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Shenjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve lokale dhe vendkalimeve hekurudhore | Implentimi i projektit për vendosjen e shenjave horizontale dhe vertikale ne rrugët lokale të komunës dhe vendkalimet për hekurudha, shenjëzimi i parkingjeve | Drejtori- Zyrtari për shërbime të transportit lokal. | Gjatë tërë vitit 2022 | Buxheti i DSHPE-së, janë të paraparë; 22,500.00€ |
| 5.Mirëmbatja e hapësirave publike. | | | | |
| Rritja e cilësisë në mirëmbajtjen e hapësirave publike . Mirëmbajtja sipërfaqeve gjelbëruese gjelbërimit dhe rregullimi i Sheshit, Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonit të verës | Harton planin për mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe implementimi i kontratave,<br><br>Pastrimi dhe larja e rrugëve | Zyrtari për hapësira publike .<br><br>Zyrtarët e autorizuar Menaxheri i projektit | Gjatë vitit 2022<br><br>Mars-Nëntor | Buxheti;23,000.00€<br><br>Buxheti;40.000.00€ |
| Mirëmbajtja e rrugëve gjatë Dimrit. | Pastrimi i rrugëve, trotuareve, parkingjeve nga bora dhe akull | Menaxheri i projektit dhe Zyrtarët e autorizuar | Dhjetor-Mars 2021/2022 | Buxheti;90,000.00€ |
| Mirëmbajtja dhe rregullimi i varrezave, | Rregullimi i rrethojave të vorrezave | Menaxheri i projektit dhe Zyrtarët e autorizuar | Prill- Tetor | Buxheti;40,000.00€ |
| Mirëmbajta e rrugëve të asfaltuara | Caktimi i lokacioneve të rrugëve të asfaltuara të dëmtuara dhe renovimi i tyre | Menaxheri i projektit dhe organi mbikëqyrës | Mars- Nëntor | Buxheti;32,100.00€ |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | dhe hartimi i raporteve lidhur më këto renovime, | | | |
| Mirëmbajta e rrugëve të rendit të IV, me zhavor | Caktimi i rrugëve në bazë të kërkesave të cilat kanë nevojë për mirëmbajte të gropave me zhavor dhe hartimi i raporteve për punët e kryera. | Menaxheri i projektit dhe organi mbikëqyrës | Mars-Nëntor | Buxheti;15,000.00€ |
| Zgjerimi dhe Mirëmbajta e kamerave në qytetin e Drenasit | Incizimi i gjendjes në teren ku janë të vendosura kamerat, dhe hartimi i paramases lidhur më këtë projekt, dhe fillimi i implementimit të projektit | Menaxheri i projektit dhe organi mbikëqyrës | Janar-Dhjetor | Buxheti;5,000.00 € |
| Bashkëfinancim të projekteve | Hartimi i paramasës dhe parallogarisë lidhur më këtë projekt dhe implementimi i tij.<br>Do të hartohet paramasat për projektet të cilat do të bashkëfinancohen nga komuna dhe donatoret | Shefi i sektorit dhe zyrtari i autorizuar | Gjatë vitit 2022 | Buxheti; 10,000.00€ |
| | | | | |

| 6.Mirëmbajtja e Ndriçimit Publik | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Mbikëqyrja dhe mirëmbajtja e Ndriçimit publik | Hartimi i paramasës dhe parallogarisë për mirëmbajtje të ndriçimit publik dhe implementimi i këtij projekti. Përcjellja e gjendjes në teren dhe hartimi i raporteve lidhur me punët e kryera gjatë mirëmbajtjes së ndriçimit. Hartimi i kërkesave dhe pagesave për faturat e shërbimeve komunale | Menaxheri komunal i energjisë dhe Zyrtari i ndriçimit publik | Janar – Dhjetor | 30,000.00€ |
| Mirëmbajtja e sistemit të ENMASOFT, lidhur me Efiçiencën e energjisë dhe bashkëpunimi me Fondin e Mijëvjeçarit për Kosovë | Azhurimi i të dhënave për shpenzimet e krijuara në objektet e sektorit publik, Arsimit. Shëndetësisë dhe Administratës - Monitorimi dhe raportimi lidhur me përmbushjen e Planit të Veprimit për EE, dhe raportimi në AKEE-s | Shefi i sektorit ( menaxheri komunal për Energji) | Janar- Qershor dhe Qershor - Dhjetor | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Hartimi i Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë | Komisioni Komunal në bashkëpunim me Gizin | Drejtori, Shefi I sektorit, Komisioni komunal/ Giz-i | Janar- Shtator | Buxheti është me bashfinancim nga Komuna dhe Giz-i ku 10,000.00 nga Giz-i dhe pjesa tjetër nga DSHPE-ja |
| 7.Shërbimet tjera | | | | |
| Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë kryen edhe shërbime të vazhdueshme në asistim me drejtoritë tjera . | Azhurimi i punëve dhe hartimi i planit të punës, menaxhimi dhe kontrollimi i punës se përditshme të shërbimeve komunale, stafit, punëve në teren, pranimi dhe kompletimi dhe dorëzimi i lëndëve, pagesave, punët në vlerësim të ofertave dhe vlerësimi në hapje e ofertuesve, për zyrën e prokurimit publik etj, | Shefi i sektorit ne bashkëpunim me drejtorin<br><br>Anëtarët e caktuar nga zyra e prokurimit | Gjatë vitit 2022 | Janë pjesë e vazhdueshme e shpenzimit në mallra dhe shërbime. |
| Projekti i Intervenimeve emergjente (dezinfektimi dhe diskutimi i hapësirave publike, bartja dhe groposja e kafshëve të ngordhura etj.) | Hartimi i paramasave dhe implementimi i projektit | Menaxheri i kontratës- shefi i sektorit | Gjatë vitit 2022 | Buxheti i paraparë për vitin 2022;10,000.00€ |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Trajnimi i qenve endacak | Caktimi i Menaxherit të projektit dhe OM, si dhe hartimi i raporteve gjatë implementimit të projektit të Trajtimit të qenve endacak | Zyrtaret kompetent të caktuar me vendim të kryetarit. | Gjatë tërë vitit 2022 | Deri këtë vit ka qenë projekt i implementuar nga MBZHR, ndërsa për vitin 2022,janë paraparë 15,000.00€ |
| Shërbimet e varrimit për qytetaret e komunës se Drenasit | Hartimi i raportit për pagesa për këtë shërbim. | Menaxheri i autorizuar | Gjatë tërë vitit 2022 | Buxheti; 80,000.00€ |
| Menaxhimi dhe koordinimi me SHZSH i cili operon vazhdimisht është në shërbim të qytetarëve . | Përcjellë ecurinë e punës të këtij njësiti dhe raporton në AME dhe DSHPE | Shefi i sektorit në bashkëpunim me shefin e zjarrfikësve | Gjatë tërë vitit 2022 | |

## 3.11. INFRASTRUKTURA PUBLIKE

Zyrtarët nga Drejtoria për Infrastrukturë Lokale, detyrat e punës i kanë kryer duke u bazuar në plan programin e punës, duke u mbështetur në Ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës, si dhe në bazë të detyrave e obligimeve të përcaktuara me Statutin e Komunës së Drenasit. Në bazë të detyrave që janë realizuar gjatë vitit 2021 zyrtarët e drejtorisë kanë përgatitur këtë:

**RAPORT TË PUNËS PËR VITIN 2021**

Drejtoria për Infrastrukturë Lokale për realizimin e punëve të planifikuara mbartin mbi vete shumë aktivitete në sektorin e Infrastrukture lokale dhe sektorin e projekteve, duke filluar me hartimin e projekteve zhvillimore, investimet kapitale. Në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë paraqesim raportin e punës për vitin 2021 sipas sektorëve:

**SEKTORI I INFRASTRUKTURES LOKALE**

Në sektorin e Infrastrukturës jemi angazhuar si drejtori në përmirësimin e procedurave për aplikimin e lejeve, kërkesave të qytetarëve, investitorëve dhe përkrahjen e iniciativave për të pasur një planifikim të qëndrueshëm dhe realizim te projekteve kapitale. Gjithashtu janë shqyrtuar edhe

kërkesa dhe ankesa tjera të palëve brenda afatit ligjor dhe me kohë i'u kemi përgjigjur dhe njoftuar palët për vendimet e marra në harmoni me ligjet ekzistuese .
Tabela e përgjithshme e lëndëve gjatë vitit :

| Nr | **Emërtimi i kërkesave dhe shërbimeve** | **Pranuara** | **Aprovuara** | **Te anuluara** | **Refuzuara** | **Në Proces** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1<br>2 | Leje ndërtimi-projekte infrastrukturore(KEDS) | 32 | 32 | | x | X |
| 3 | Pëlqime (për Infrastrukturë) | 8 | 8 | | x | x |
| 4 | Njoftime për lëndë të ndryshme(kërkesa) | 833 | 741 | 10 | 6 | 76 |
| | Totali: | **873** | **781** | **10** | **6** | **76** |

Gjithashtu janë trajtuar kërkesat për infrastrukturë rreth problemeve infrastrukturore etj. Klasifikimi, renditja dhe regjistrimi i lëndëve dhe projekteve të drejtorisë (të gjitha me numër dhe emër në databazën elektronike të krijuar në kuadër të drejtorisë).
-Kontrollimi i projekteve ideore dhe zbatuese në aspektin teknik profesional dhe dhënia e pëlqimit për hartimin e projektit zbatues.
-Hartimi i pëlqimeve të ndryshme për shfrytëzimin e objekteve infrastrukturore
-Hartimi i pëlqimeve të ndryshme për kompani publike dhe private (Kompaninë e Ujësjellësit dhe Kanalizimit, Kompaninë e Pastrimit, Keds-in, Ipko-n ,Posta dhe Telekomi i Kosovës).
-Hartimi i aktvendimeve të ndryshme për mbikëqyrje dhe menaxhim të kontratës, pranime teknike të projekteve kapitale, përgatitja e raporteve të ndryshme për mbikëqyrje dhe pranimin teknik të projekteve kapitale në Komunën e Drenasit. Gjatë realizimit të projekteve kapitale që janë paraparë për realizim gjatë vitit 2021 nga buxheti komunal, grantet dhe donacionet e ndryshme, ne si drejtori jemi angazhuar me tërë stafin që të realizojmë projektet kapitale dhe hartimin e planeve të nevojshme komunale. Janë kryer një numër i konsiderueshëm i projekteve zbatuese në konsultim me kompaninë projektuese. Projektet kapitale si: rrugët, trotuaret, ujësjellësit, kanalizimet, ndërtimi i objekteve të reja shkollore, ura, mure mbrojtëse, gropa septike, renovime, kanale kulluese, ndriçim publik, pastrim i lumit etj, që janë realizuar gjatë këtij viti janë kryer sipas kontratave të nënshkruara. Në të njëjtën kohë kemi qenë të fokusuar edhe në rritjen e cilësisë së punës dhe në përgjithësi është e kënaqshme. Jemi angazhuar si drejtori që të kemi një performancë edhe më të mirë brenda mundësive dhe kapaciteteve profesionale që i kemi në dispozicion.

**PROJEKTET KAPITALE QË JANË REALIZUAR GJATË VITIT 2021**

Po japim tabelën e projekteve të realizuara gjatë vitit 2021:

| LISTA E PROJEKTEVE TË REALIZUARA PËR VITIN 2021 | | |
|---|---|---|
| | | |
| RRUGËT ME ASFALT DHE KUBËZA BETONI | | |
| Nr | Emërtimi i Projektit | Gjatësia e rrugëve të realizuara në m' |
| | Totali i përgjithshëm për Asfalt në m’ | 30,751.00m’ |
| | Totali i përgjithshëm për zhavor në m’ | 7,500.00m’ |
| | TROTUARET | |
| | Totali i përgjithshëm për Kubëza në m’ | 5800m’ |
| | | |
| | KANALIZIMET ne Km’ | 33.6km’ |
| | Total i përgjithshëm për Kanalizim nëm' | Gjatësia e kanalizimeve të realizuara në m' |
| | | 33,600.00 m’ |
| | Rehabilitim i kanalizimeve kontrata të lidhura | 24,000.00m’ |
| | Kolektorët ne Km’ | 3 km’ |
| | Total i përgjithshëm për Kolektorëve në m' | Gjatësia e kolektorëve të realizuara në m' |
| | | 3000m’ |
| | UJËSJELLËS | |
| | Totali i përgjithshëm për ujësjellës në m’ | Gjatësia e ujësjellësit të realizuara në m' |
| | | 11,175 m’ |
| | NDRIÇIM PUBLIK | |
| | Totali i përgjithshëm për ndriçim në m’ | Gjatësia e rrjetit të ndriçimit publik të realizuara në m' |
| | | 48,000.00m’ |
| | | |
| | Rregullim i shtratit te lumit dhe pastrim I tyre | Gjatësia e rregullimit dhe pastrimit te Lumit, përroskave realizuara në m' |
| | | 3,000.00m’ |
| | Pastrimi dhe rregullimi i kanaleve kulluese m’ | |
| | | 10,000.00m’ |
| | Rregullimi i urës, tombinave dhe mure mbrojtëse | 2 Urë ; 5 tombinave dhe 4 mure mbrojtëse |

-Hartimi i projekteve zbatuese

-Gjithashtu kemi përgatitur me kohë listën me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve për investime kapitale për vitin 2021, kemi pranuar me shkrim kërkesat e administratorëve të fshatrave për

investime dhe i kemi paraqitur në kornizën afatmesme për planifikimin e buxhetit për vitet 2021-2024 para Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit Komunal. Jemi munduar ti japim prioritet projekteve të mbetura gjysmë dhe disa projekte që kanë qenë të domosdoshme. Në prioritet kemi vënë një numër të madh kanalizimesh, rrugëve, trotuareve dhe ndriçim publik në krahasim me vitin që lamë pas sepse ishin edhe kërkesat e qytetarëve.

## PROJEKTET KAPITALE TË PËRFITUARA NGA DONACIONET ME BASHKËFINANCIM ME KOMUNËN E DRENASIT

Përveç projekteve që janë financuar me buxhetin e Komunës sonë me angazhimin e stafit të drejtorisë dhe me mbështetjen e kryetarit të Komunës kemi arritur që te përfitojmë edhe projekte të cilat i financojmë me ndihmën e granteve të qeverisë dhe nga donatorët e ndryshëm, me seriozitet dhe profesionalizëm kemi arritur që t'i bindim këta donator që këto mjete t'i investojnë në Komunën e Drenasit.
-Projektet që janë financuar në Komunën tonë me ndihmën e granteve dhe donatorëve janë :
–Asfaltimi i rrugëve nga memorandume te bashkëpunimit në periudhë 2 dhe 3 vjeçare të financuara nga niveli qendror:
- Asfaltimi i rrugës Terdec-Vuçak- ne proces
- Asfaltimi i rrugës Kroi i Mbretit deri tek Liqeni i Vasilevës- ne proces
- Asfaltimi i rrugës Tranzit Kroi i Mbretit-Drenas- ne proces
- Asfaltimi i rrugës Gradicë-Zhilivodë-vazhdim - ne proces

-**Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në vlerë prej 517,430.00** Euro
**(Granti i performancës-të shpenzuara ne keto projekte)**
1. **Rehabilitimi dhe Rikonstruimi i rrugëve të asfaltuar në Drenas** -
2. **Ndërtimi i urave dhe tombinave dhe mureve mbrojtëse -**
3. **Rehabilitimi dhe Rikonstruimi i rrjetit te kanalizimeve ne Komunën e Drenasit**-
4. **Ndërtimi i infrastrukturës (Asfaltim dhe kubezim) Drenas I II III dhe IV**-

--Kolektorët për grumbullimin e ujërave të zeza në Komunën e Drenasit
- **Memorandum bashkëpunimi me OJQ "Jetimat e Ballkani" për këtë vit**
-Rregullimi i 24 shtëpive për skamnor
**AKTIVITETET**

- Përgatitja dhe dorëzimi i projekteve kapitale të komunës në Ministritë e Infrastrukturës, MMPH, MAPL dhe donatorët ;
-Përgatitja e paramasave dhe parallogarive për projekte kapitale;
- Përgatitja e dokumentacionit për tenderim të projekteve, deklarata e nevojave, kërkesave për të gjitha projektet e Drejtoria për DIL.
- Mbikëqyrja e punimeve gjatë realizimit të projekteve në teren;
- Hapja dhe vlerësimi i tenderëve për projekte kapitale;
- Hartimet e planeve të menaxhimit të kontratave, raporteve të kërkuara për pagesa nga mbikëqyrësit e projekteve kapitale ;

-Përgatitja e platformës digjitale online të dhënave hapësinor në infrastrukturë( rrugë me asfallt dhe kubëza betoni, kanalizime, ujësjellësi, trotuare, ndriçim publik, hapje e kanaleve kulluese, rehabilitim i kanalizimeve, rregullimi dhe pastrimi i shtratit të lumit).
- Përgatitja e detyrave projektuese për hartimin e projekteve zbatuese për projekte kapitale

-Njoftime të ndryshme për palë rreth kompletimit të lëndëve;
-Takime me përfaqësuesit e Ministrive të ndryshme që lidhen me punët e drejtoratit ;
- Puna në komisione të ndryshme të caktuara nga Kryetari I Komunës dhe drejtorët e drejtorateve tjera si(komisioni për performancë komunale, komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga të reshurat atmosferike, komisioni për efiçiencë të energjisë, komisione te pranimeve teknike te projekteve etj).
- Takimi me përfaqësuesit e Ujësjellësit Rajonal, CDI zvicerane në Prishtinë dhe punëkryesit për fillimin e punëve në rrjetin e ujësjellësit për fshatrat të komunës sonë.
-Takimi me përfaqësuesit te Ujësjellësit rajonal Prishtina-KRU Prishtina se bashku me Kryetarin ne lidhje me zgjedhjen e problemit te rrjetit nga rezervuari i Feronikelit deri tek STP dhe rezervuari ne Kamenicë, ku pas kësaj paramasen për projektin qe do te realizohet ne vitet 2021-2022 e kane bere zyrtaret e ujësjellësit KRU Prishtina.
-Fillimi i punëve ne rrjetin e ujësjellësit ne qendër te qytetit nga CDI dhe nga Drenasi ne Komoran, po ashtu edhe ndërtimi i STP tek xhamia e qytetit ne Drenas.
- Përgatitja e raporteve të ndryshme për nevoja të drejtorisë sonë dhe drejtorive tjera të Komunës

## PENGESAT DHE VËSHTIRËSITË

Zyrtarët e drejtorisë për Infrastrukturë Lokale i kryejnë punët dhe detyrat tjera në bazë të ligjeve në fuqi, përshkrimit të vendeve të punës si dhe planit vjetor të punës. Duhet të theksohet që gjatë realizimit të mbikëqyrjes së projekteve në teren, po ashtu edhe punëve në zyrë jemi ballafaquar me vështirësi të natyrave të ndryshme, kemi pasur shumë pengesa nga banorët e zonave të ndryshme duke filluar nga uzurpimet e pronave dhe ngushtimi i rrugëve, moslejimi i realizimit të projekteve në pronat publike e private e deri te pengimi i realizimit të projekteve, si dhe në disa raste kanë ndikuar edhe në procedurat e prokurimit të stërzgjatura (vlerësimet e ofertave si dhe publikimi i kontratave). Gjithashtu duhet theksuar se gjatë vitit 2021 pengesa kryesore ishte Pandemia COVID-19 e cila shkaktoi vonesa edhe në realizimin e projekteve. Problem është mungesa e punëtorëve, reduktim i stafit për shkak të gjendjes se krijuar nga Pandemia COVID-19 sepse me këtë numër kaq të vogël të punëtorëve që ka drejtoria kemi vështirësi të shumta në realizimin e të gjitha këtyre projekteve kapitale sepse vëllimi i punëve është mjaft i madh. Zyrtarët e drejtorisë tone është dashur të marrin pjesë në çdo hapje dhe vlerësim të ofertave si dhe menaxhimin e mbikëqyrjen e punimeve në teren. Po ashtu kemi mungesë të veturave për dalje në teren për menaxhim të projekteve, takime dhe trajnime të ndryshme, sepse shumë herë kemi humbur ato për mungesë të veturës.

Problem tjetër është edhe mbikëqyrja e punimeve gjatë vikendeve nga ana e zyrtarëve të drejtoria në mënyrë që të rritet cilësia në realizim të projekteve. Vlen të ceket edhe rrezikshmëria gjatë menaxhimit të kontratave sipas rregullores 33/2012 Për shtesat në page dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil.

**PROPOZIMET**

Drejtoria për Infrastrukturë Lokale në fokusin e saj përmirësimin e infrastrukturës për jetesë më të mirë për banorët e Komunës sonë dhe kjo do të arrihet duke pasur një planifikim të qëndrueshëm dhe realizimit të projekteve kapitale të cilat lidhen drejtpërdrejtë me infrastrukturën. Për të përmbushur misionin dhe vizionin e saj drejtoria tonë mendojmë se duhet të krijohen edhe disa parakushte për zyrtarët komunal dhe së pari të rritet numri i punëtorëve profesional në këtë drejtori sepse kemi mungesë të inxhinierëve të lëmive profesionale.

## 3.12. DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Drenasit, gjatë vitit 2021, në kuadër të fushëveprimtarisë ka ofruar këto punë/shërbime zyrtare të bazuar në Statutin e Komunës, në harmoni me ligjet e Kuvendit të Kosovës, aktet tjera nënligjore, Rregulloret e miratuara nga Kuvendi Komunal i Drenasit, dokumenteve strategjike dhe planin e punës për vitin 2021. Punës/shërbimet e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik fokus të veçantë i është kushtuar hartimi dhe realizimit të politikave zhvillimore, marrja e masave sa më të përshtatshme për të nxituar më tutje zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të komunës së Drenasit, krijimin e kushteve sa më favorshme, infrastrukturë dhe mjedisi sa më të përshtatshëm për zhvillim të ndërmarrjeve të vogla, mesme për një zhvillim sa më të qëndrueshëm. Fokus të veçantë vazhdon t'i kushtohet promovimit të zhvillimit ekonomik, turizmit, zbutjes së papunësisë, duke mundësuar gjenerimin e vendeve të reja të punës. Pra, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik vazhdon me intensifikimin e angazhimeve të saj drejt përmirësimi të klimës së të bërit biznes, promovimin e komunës së Drenasit si një Komunë atraktive, për investitorët strategjik për të investuar dhe për tu vizituar, gjithmonë e hapur ndaj ideve inovative dhe projekteve të reja smart, gjithmonë duke ofruar shërbime/konsulenca profesionale.

**PËRMBLEDHJE:**

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtori:

- Regjistrimi i bizneseve fillestare (të gjitha bizneset individuale B.I shoqëritë aksionare, ortakëri e përgjithshme, ortakëri e kufizuar, shoqëria e huaj tregtare, ndërmarrjet shoqërore dhe kooperativat bujqësore;
- Regjistrimi i ndryshimeve në biznes;
- Pajisje me certifikata të reja me Numër Unifikues;
- Pajisja me informata shtesë për biznes;
- Protokollimi i të gjitha lëndëve që kanë të bëjnë me biznes;
- Raportet javore dhe mujore pranë MTI;
- Vërtetime për persona fizik që nuk ushtrojnë veprimtari biznesore;
- Vërtetime që nuk posedojnë obligime të taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste biznesore;
- Lirimi nga Taksa në Biznese për vitin 2021 për shkak të pandemisë, i propozuar nga Kryetari i Komunës dhe i miratuar në Kuvendin Komunal;
- Shqyrtimi i lëndëve: kërkesave, ankesave dhe të ngjashme;

- Bartja e të dhënave në mënyrë manuale nga programi i vjetër i taksës komunale në programin e ri E-Taksa.
- Ngarkesa e taksës komunale për biznese;
- Inkasimi i taksës komunale për biznese (pagesat);
- Konsulenca me palët/bizneset si dhe
- Punë dhe angazhime tjera në komisione.

Biznese të regjistruara nga data 01.01.2021 deri me datën 31.12.2021 janë të regjistruara 246 biznese të reja, krahasuar me vitin paraprak të njëjtës periudhë që ishin regjistruar 180 biznese ose shprehur në përqindje **36.66 %** më shumë se në vitin e kaluar, të cilat biznese në bazë të deklarimeve të tyre punësojnë **290** punëtorë. Bizneset fillestare brenda ditës pajisen me çertifikatën e biznesit me Numër Unifikes të biznesit, si dhe jepen konsulenca të ndryshme të kësaj natyre për ta krijuar një ambient sa me të volitshëm për regjistrim si dhe të gjitha ndryshimet e nevojshme në biznes. Shikuar në bazë të kësaj periudhe ky numër i bizneseve të regjistruara duket si vijon:

***I. Tabela e klasifikimit të bizneseve të punësuarve regjistruara në periudhën: 01.01.2021 – 31.12.2021***

| **Klasifikimi sipas madhësisë** | **Numri i punëtorëve** | **Numri i bizneseve** | **Përqindja në total** |
|---|---|---|---|
| **Të vogla** | 1-5 | 145 | 58.95% |
| **Të mesme** | 5 – 60 (Sh.p.k.) | 101 | 41.05% |
| **Të mëdha** | 60 - e më tepër | - | - |
| **Gjithsejtë:** | | **246** | **100.00%** |




***II. Nga tabela e paraqitur më lartë vërehet se të gjitha bizneset e regjistruara në periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021 i takojnë ekskluzivisht kategorisë së bizneseve të vogla (58.95%).***

| Nr . | Bizneset kryesisht janë të përqendruara në këto veprimtari: | Shpërndarja e bizn. Sipas veprimtarive | Përqindja |
|---|---|---|---|
| 1. | Ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore | 30 | 12.19 % |
| 2. | Aktivitetet shërbyese të pijeve. | 26 | 10.6 % |
| 3. | Sallonet e floktarisë dhe trajtimet e tjera të bukurisë. | 24 | 9.75 % |
| 4. | Aktivitetet e tjera të specializuara ndërtimi p.k.t | 21 | 8.53 % |
| 5. | Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve | 20 | 8.13 % |
| 6. | Punime për veshjen e dyshemeve dhe mureve | 19 | 7.72 % |
| 7. | Punime suvatimi | 19 | 7.72 % |
| 8. | Përfundimi dhe finalizimi i punëve të tjera të ndërtesave | 19 | 7.72 % |
| 9. | Punimet e kulmit (çatisë) | 15 | 6.1 % |
| 10. | Restorantet dhe aktivitetet shërbyese lëvizëse të ushqimit | 15 | 6.1 % |
| 11. | Aktivitetet tjera... | 38 | 15.44 % |
| | **Gjithsejtë.................** | **246** | **100 %** |




**III-Bizneset e regjistruara në Komunën e Drenasit sipas llojit të pronësisë në periudhën**

**01.01.2021 – 31.12.2021**

| Nr. | Lloji i pronësisë | Numri i bizneseve | Përqindja |
|---|---|---|---|
| 1 | Biznes individual | 145 | **58.95%** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 2 | Ortakëri e përgjithshme | | |
| 3 | Ortakëri e kufizuar | | |
| 4 | Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar | 101 | **41.05%** |
| 5 | Shoqëri Aksionare | | |
| 6 | Ndërmarrje në pronësi të huaj | | |
| 7 | Ndërmarrje publike | | |
| 8 | Kooperativë bujqësore | | |
| | TOTALI | 246 | **100.00%** |




Të dhënat e QKB të paraqitura në tabelën e mësipërme ofrojnë informata në lidhje me strukturën pronësore të bizneseve të regjistruara me 01.01.2021 – 31.12.2021 në Komunën e Drenasit, Bizneset individuale gjatë kësaj periudhe ekskluzivisht dominojnë strukturën pronësore bizneset individuale me 58.95% dhe 41.05% Shoqëri me përgjegjësi të Kufizuar, regjistrimi i tipit të biznesit SHPK. Edhe këtë këtë periudhë ka treguar një rritje të konsiderueshme krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gjatë periudhës 01.01.2021 – 31.12.2021, në vijim me kërkesën e pronarëve të bizneseve janë regjistruar gjithsejtë: 121 ndryshime të bizneseve ekzistuese, në periudhën paraprake të vitit të kaluar bizneset që patën ndryshime ishte 126 biznese ose 4.0% ma pak se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar dhe sipas muajve dukën kështu:

IV- Ndryshimet në biznes sipas muajve

| Muajt. | Janar-Dhjetor | **I** | **II** | **III** | **IV** | **V** | **VI** | **VII** | **VIII** | **IX** | **X** | **XI** | XII |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Ndryshimet në biznese | 10 | 8 | 16 | 15 | 4 | 7 | 11 | 8 | 8 | 10 | 13 | 11 |




***Punë/ shërbime tjera, gjatë periudhës: 01.01.2021 – 31.12.2021;***

| Nr. | Shërbimi/Lënda | Totali: |
|---|---|---|
| 1 | Shuarje të bizneseve | 28 |
| 2 | Çertifikata të reja për biznese fillestare | 246 |
| 3 | Ndryshime ne biznes | 121 |
| 4 | Çertifikata të ripërtërira | 87 |
| 5 | Çertifikata duplikat | 7 |
| 6 | Vërtetime për persona fizik që nuk ushtrojnë veprimtari biznesore. | 25 |
| 7 | Vërtetima për përsona fizik që ushtrojnë veprimtari biznesore. | 2 |
| 8 | Pagesa të Taksës për Biznes sipas faturimit. | 4,422.00 € |




***Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve që ofron kjo drejtori kanë marrë pjesë stafi sipas kërkesës në:***

- Pjesëmarrja në seminarin e organizuar në mënyrë virtuale me temë: " Analiza për investime Kapitale e realizuar sipas rajoneve Zhvillimore e organizuar Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale(KLGI) dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal;
- Pjesëmarrja në takimin/punëtorinë e organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës në bashkëpunim me RCDN "Principi i punës së Impianteve për trajtimin e Ujërave të Zeza në Kosovë. Korniza Ligjore dhe skema e proceseve të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza;
- Pjesëmarrja ne tryezën Ndikimi i COVID-19 në Turizmin në Kosovë, organizuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë'
- Pjesëmarrje në punëtori "Rrjeti Rajonal për Ngritje të Kapaciteteve" e organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës;
- Pjesëmarrja në trajnimin "Lidershipi dhe Menaxhimi i Administratës Lokale" të organizuar nga IKAP.
- Pjesëmarrja në tryezën -Ngritja e bashkëpunimit dhe koordinimi për projektet dhe aktivitetet në turizëm, organizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;

***U realizuan takime me përfaqësuesit institucioneve të nivelit qendror, organizatave vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të arritjen se marrëveshjes/bashkëpunimit për të gjetur mundësin e përkrahjes/financimit e projekteve zhvillimore, të cilat do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të komunës së Drenasit dhe sektorit privat/ bizneseve të cilat operojnë në territorin e komunës së Drenasit;***

- Takim i Kolegjiumit për Zhvillim Ekonomik Lokal organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës për vitin 2021 me qëllim diskutimin e temave aktuale në kuadër të zhvillimit të veprimtarisë të Kolegjiumit, në harmonizimin e veprimtarisë dhe koordinimin e aktiviteteve të strukturave të AKK-së për vitin 2021;
- Takim me përfaqësuesit e WOMEN 4 WOMEN, mundësia e bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve të tyre me Komunën e Drenasit për përkrahjen e grave në bujqësi dhe hortikulturë;
- Janë realizuar takime me përfaqësuesit e bizneseve ku janë diskutuar për sfidat, pengesat, mundësitë dhe planet zhvillimore;
- Janë realizuar takime me përfaqësuesit e shoqatave dhe organizatave joqeveritare, me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në nivelin lokal, të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e jetës ekonomike, sociale të Komunës së Drenasit;
- Takim me udhëheqësen e Departamentit për Zhvillimin e Politikave Industriale në kuadër të Divizionit për Politika Industriale në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe vizitë tek bizneset prodhuese.
- Takim me Drejtorin e Socio-Projekt Kosova, Valentin Hoxha për mundësinë e bashkëpunimit.
- Pjesëmarrjen në punëtorin për "Bashkërendimin e skemave të ndihmës shtetërore në zonat e veçanta ekonomike me kërkesat e ligjit për ndihmën shtetërore".
- Pjesëmarrja ne eventin "Dialogu Publiko-Privat" ne kuadër te projektit "Studimi i Konkurrues mërisë së Kosovës", i cili bashkë-financohet nga Agjencioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA) dhe Fondacioni MDA.

- Takim me përfaqësuesit e BSC, njoftim rreth projektit te Bankës Botërore ku do të implentohet në 10 komuna pjesë e këtij projekti edhe komuna e Drenasit.

- Pjesëmarrja në punëtorinë, ku u prezantohet ”Draft Analiza tri (3) vjeçare për Investimet Kapitale të realizuara sipas rajoneve zhvillimore në Kosovë 2018-2020’’ nga Ministria Rajonale.

- Pjesëmarrja ne tryezën e organizuar nga MINT -Departamenti i Turizmit - të arriturat, projektet dhe aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2021 dhe planet për vitin 2022 në fushën e turizmit. Pjesë e tryezës publikimi i atraksioneve turistike në 15 komuna të Kosovës ku përfshihet komuna e jonë.

- Pjesëmarrja në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, projekti regjional “Fuqizimi dhe aftësimi i të rinjve përmes mundësive të reja – YEEP”
  ***Arritja e marrëveshjeve/bashkëpunimeve të cilat do të ndikojnë në përmirësimin dhe ngritjen e kapaciteteve të NMV***

- Marrëveshje bashkëpunimi me AZHER-Qender
  ***Projektet të cilat janë duke u implementuar :***

- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Women 4 Women në projektin “Mundësitë e përmirësuara të vetë-punësimit dhe punësimit” I SEE që financohet nga Agjencioni Austriak për Zhvillim (ADA) me fondet e Korporatës Austriake për Zhvillim (ADC), parasheh që për bizneset e grave të ndajë grante me shumë deri në 3,500.00€.
- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në kuadër te marrëveshjes se bashkëpunimit me Agjencinë për Zhvillim Rajonal Qendër (AZHRQ). ka lansuar skema e granteve “Përkrahja dhe fuqizimi i grave në agrikulturë”.
- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik (DZHE) në kuadër të programit "Participimi tek Ndërmarrjet mikro (0-9 punëtor) dhe Start Up" ka mbështetur me mjete financiare duke iu dhënë prioritet më shumë, zeje tradicionale, aksesore, bizneseve inovative dhe start up, ideve në fushën e turizmit, ideve që ofrojnë me shumë punësim.
  ***Projektet të cilat janë implementuar***

- Shpërndarja e pajisjeve për përfituesit e skemës së Garantëve “Përkrahja dhe fuqizimi i grave në agrikulturë” në bashkëpunim me AZHR ku kanë përfituar 13 gra fermerë.
- Shpërndarja e pajisjeve për përfituesit te fundit nga projekti me Organizatën Help.

***Informimi me kohë në platformën online dhe informim në zyre të drejtorisë lidhur me gjetjen dhe mundësin e aplikimit në grande, projekte dhe subvencione adresuar: sektor privatë/bizneseve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit si;***

- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, ka njoftuar të gjitha subjektet biznesore (barnatoret), se DZHE ka hartuar orarin për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës për ditët e punës, të dielave dhe festave zyrtare, për subjektet afariste që janë furnizues të përditshëm për qytetarët me barëra;

- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka vizituar bizneset prodhuese;
- Drejtoria për Zhvillimit Ekonomik/Drejtoresha ka vizituar disa nga bizneset të cilat janë dëmtuar nga vërshimet ne disa zona ku për pasojë ata janë dëmtuar në masë të konsiderueshme në produktet e tyre;
- Thirrje për aplikim për subvencionim me mjete financiare për NMVM lansuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA);
- Thirrje për aplikim për skemën grate ndërmarrëse lidhur me programin për grante - Gratë Ndërmarrëse në Energji (ËEE) thirrje për aplikim nga Fondacioni Mileniumit i Kosovës (MFK);
- Thirrjen për trajnime online për biznese në fushën e menaxhimit të financave nga MZHR dhe BERZH;
- Thirrje për aplikim nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) me qëllim të zvogëlimit të deficitit tregtar dhe përmirësimit të kapaciteteve prodhuese të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), rritjen e investimeve, të eksportit, konkurrueshmërisë dhe hapjen e vendeve të reja të punës, do të mbështes në subvencionim me mjete financiare ndërmarrjet NMVM sipas kategorive të tyre;
- Thirrje për aplikim për skemën e garantëve nga Programi i Zhvillimit Rajonal të Balancuar PZHRB 2021" (lot 1 Start –up dhe lot 1 biznes ekzistues) si dhe "Skemën e Garantëve Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike 2021", Masa 15 (lot II dhe lot III );
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, në bashkëpunim me Agjencia për Zhvillim Rajonal Qendër (AZHR) ka mbajte trajnim për nxënësit, studentët dhe gjithë të interesuarit në kuadër të projektit "Trajnimi profesional dhe angazhimi në punësim" "Trajnim për Orientimin në Karrierë / Trajnim për aftësi të buta" të organizuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- Trajnimi për bujqesi dhe hortikultur në kuader te projektit te përbashkët Komune- Women 4 Women "Mundësitë e përmirësuara të vetë-punësimit dhe punësimit" I SEE.
- Thirrje për aplikim - Digjitalizo biznesin përmes Iniciativës për Fuqizim Digjital (IFD lansuar nga Ministria e Industrisë, Nermarrësisë dhe Tregtisë(MINT) përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA).
- Thirrje për aplikim nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik (DZHE) e shpallur në kuadër të programit "Participimi tek Ndërmarrjet mikro (0-9 punëtor) dhe Start Up" ka shpallë konkurs për mbështetje financiare duke iu dhënë prioritet më shumë, zeje tradicionale, aksesore, bizneseve inovative dhe start up, ideve në fushën e turizmit, ideve që ofrojnë me shumë punësim.

**Zhvillimi dhe promovimi i turizmit**

Me qëllim të mundësisë për promovim dhe zhvillim të turizmit të komunës së Drenasit është duke u bërë identifikimi i monumenteve historike në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës;

- Përzgjedhja e atraksioneve turistike ne bashkëpunim me DRKS - atraksion turistik është një vend për të cilin interesohen turistët, zakonisht për vlerën natyrore ose kulturore, rëndësinë historike, bukurinë natyrore ose të ndërtuar, duke ofruar kohë të lirë dhe zbavitje.
- Ne kuadër të aktivitetit për promovimin e turizmit qe realizohet nga Ministria e Industrisë, Ndermarresisë dhe Tregtisë në bashkëpunim me komunat, aktivitet për promovimin e turizmit në hapësirat e Aeroportit të Prishtinës, ku do te vendosen shtande promovuse të cilët do t'i pajisim me materiale promovuese turistike, DZHE ka dorëzuar materialet ne MINT nga tridhjete kopje fizike te hartave të qytetit te Drenasit dhe Udhërrëfyes turistik.

Gjendja e pandemisë e shkaktuar nga Covid-19 ka ndikuar në shumë procese/projekte kanë mbetur pa u implementuar gjatë periudhës së parë të këtij viti në mungesë donacioneve (01.01.2021-31.12.2021).

**KRYETARI I KOMUNËS**

**Ramiz Lladrovci**